

Manual!

**“Kodi i Drejtësisë
Penale për të Mitur
dhe programet e
drejtësisë
restauruese e të
ndërmjetësimit”**

Manual!

“Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur dhe programet e drejtësisë restauruese e të ndërmjetësimit”

Autorë

Prof. dr. Arta Mandro - Balili
Prof. dr. Mariana Semini - Tutulani

Tiranë, 2020



Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian



Ky botim u bë i mundur në bashkëpunim
me Shkollën e Magjistraturës



Recenca e librit me titull "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur dhe programet e drejtësisë restauruese e të ndërmjetësimi", u realizua nga pedagogët e Shkollës së Magjistraturës:

Arben Rakipi - Drejtor i Shkollës së Magjistraturës

Dr. Sokol Berberi - Përgjegjës i Programit të trajnimit vazhdues

Tabela e Lëndës

Hyrje	2
Drejtësia Restauruese – Njohuri dhe praktikë për gjyqtarët e prokurorët në çështjet me të mitur në konflikt me ligjin	2
Drejtësia restauruese – Njohuri dhe praktikë për gjyqtarët e prokurorët në çështjet me të mitur në konflikt me ligjin	2
Shkurtime	4
Struktura dhe ngarkesa mësimore e modulit	5
Objektivat mësimore	7
MODULI 1: Kuadri ligjor për fëmijët / të rinjtë në konflikt me ligjin	5
1. Një vështrim i shkurtër mbi kuadrin normativ lidhur me shmangien dhe zbatimin e programeve të drejtësisë restauruese e ndërmjetësimit për të miturit	10
1. Legjislacioni vendas	10
2. Instrumentet ndërkombëtare	12
2. Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur. Parimet kryesore	16
3. Standardet ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve në përgjithësi dhe për fëmijët / të rinjtë në konflikt me ligjin	22
1. Parimet e drejtësisë miqësore për të miturit	22
2. Standardet e OKB-së lidhur me drejtësinë për të mitur	24
3. Standardet e Këshillit të Evropës	28
4. Standardet e Bashkimit Evropian	31
MODULI 2: Drejtësia restauruese dhe ndërmjetësimi në drejtësinë penale për të mitur	58
1. “Kuptimi i drejtësisë restauruese dhe i ndërmjetësimit. Vendi i tyre në Kodin e Drejtësisë Penale për të mitur”	63
2. Drejtësia restauruese si koncept dhe parimet e saj	65
3. Koncepti i ndërmjetësimit. Raporti i tij me drejtësinë restauruese	67
4. Qëllimi kryesor i ndërmjetësimit midis viktimës dhe të akuzuarit	70
5. Roli i ndërmjetësit dhe hapat e procesit të ndërmjetësimit viktimë-i akuzuar	74
6. Arritja e marrëveshjes	77
7. Ndërmjetësimi dhe Kodi i Procedurës Penale	82
MODULI 3: Shmangia e të miturve nga ndjekja penale dhe aktorët e përfshirë në këtë proces. Zbatimi i programeve të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit	84
Objektivat mësimore	84
1. Parimet e drejtësisë penale për të mitur si një drejtësi miqësore	85
2. Burgimi si alternativa e fundit dhe teoritë bashkëkohore që lidhen me të	86
3. Kuptimi i shmangies	87
4. Kriteret dhe kushtet për zbatimin e masës së shmangies nga ndjekja penale	88
5. Vlerësimi i kushteve të shmangies dhe përshtatshmërisë së masës lidhur me veçoritë e çdo rasti dhe çdo të mituri	90
6. Kushtet kur zbatohet programi i drejtësisë restauruese	93
7. Shmangia nga ndjekja penale përmes ndërmjetësimit familjar dhe ndërmjetësimit në grup	99
Studime rastesh nga praktika ndërkombëtare	104
Bibliografi	111

HYRJE

Qëllimi i këtij botimi është përgatitja e një manuali me tre module si literaturë e kursit të lëndës “Ndërmjetësimi dhe Arbitrazhi” në Programin e Formimit Fillestar të magjistratëve në Shkollën e Magjistraturës.

Manuali me këto module do të përdoret si pjesë e kurikulës së lëndës ku synohet identifikimi i trajtimeve, koncepteve, kriterëve ligjore dhe hapave proceduralë që lidhen me Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur dhe ligjin “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”. Po ashtu, në material gjejnë vend edhe problematikat e evidentuara në praktikën gjyqësore që lidhet me ndërmjetësimin dhe drejtësinë restauruese në rastet e konflikteve penale ku përfshihen të miturit në konflikt me ligjin.

Manuali është edhe një material i mundshëm për t’u përdorur në formimin vazhdues të gjyqtarëve dhe prokurorëve që hetojnë raste dhe analizojnë mundësitë e shmangies nga ndjekja penale të të miturve dhe të rinjve përmes programeve rehabilituese dhe riedukuese me natyrë restauruese.

Miratimi i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur solli me vete edhe këndvështrime të reja mbi drejtësinë restauruese dhe ndërmjetësimin në rastin e të miturve në konflikt me ligjin. Prirja e drejtësisë dhe e politikave sociale në rang ndërkombëtar është që gjithmonë e më shpesh t’i kthejnë sytë nga alternativa e zgjidhjes së konflikteve me natyrë sociale dhe juridike me marrëveshje, sepse ndihet që këto metoda, shërbime apo zgjidhje sjellin shmangien e të miturve nga rruga e kriminalitetit. Në këto kushte, alternativa ndërmjetësuese po forcohet duke sjellë me vete edhe fuqizimin e ndjenjës së stabilitetit dhe harmonisë në shoqëri.

Përgatitja e magjistratëve të rinj me këtë botëkuptim të ri, me ndërgjegjësimin e plotë juridik, psikologjik dhe social për të zbatuar parimin që dënimi me burg të jetë alternativa e fundit, shënon një kthesë të fortë larg paragjykimëve se dënimi i ashpër të riedukon më mirë.

Ky botim rrit aftësimin dhe plotëson dijet e magjistratëve të rinj dhe të magjistratëve në detyrë.

Botimi i paraqitur mbi drejtësinë restauruese dhe ndërmjetësimin në drejtësinë penale për të mitur na jep konkluzione të rëndësishme të shprehura si përgjigje të pyetjeve kërkimore të ngritura nga ekspertet, të cilat faqe pas faqeje dhe trajtim pas trajtimi marrin formën e analizës ligjore, të interpretimeve dhe shpjegimeve të kornizës ligjore. Gjuha dhe logjika e përdorur në këtë botim dëshmon për një qartësi në seleksionimin e analizimin e çështjeve dhe pyetjeve për diskutim të shtruar nga praktika juridike gjyqësore. Po ashtu, materiali lehtëson përmes këshillave praktike dhe udhëzimeve ndjekjen me rigorozitet të procedurave dhe vlerësimin e parimit të një drejtësie sa më miqësore me të miturit.

Botimi na prezanton një material të gjerë dhe kompleks që dëshmon për një punë të gjatë dhe hulumtuese. Në këtë kontekst, realizimi i disa moduleve të parashikuara në programin e lëndës së ndërmjetësimit dhe arbitrazhit dëshmon për një punë serioze dhe shkencore në përmbushje të nevojave dhe kërkesave të Shkollës së Magjistraturës.

Për kryerjen e këtij studimi shkencor janë përdorur disa metoda kërkimi, si: analitike, historike, logjike, krahasuese, shpjeguese dhe parashikuese. Në themel të punës kërkimore ka qenë hulumtimi dhe studimi i legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar në këtë fushë, si dhe studimi i praktikave të mira me natyrë rehabilituese dhe restauruese.

Botimi ndalon edhe në teoritë bashkëkohore të lidhura me raportet midis vuajtjes së dënimit me burgim dhe riedukimit. Duke analizuar teorinë e realitetit të parëndësisë, teorinë e zhvillimit të arsytimit të krimit, teorinë e etiketimit, teorinë që nisat nga efekti i kostos në rritje, teorinë e shkollave të krimit, teorinë e zgjerimit të rrjetit dhe teorinë radikale të mosndërhyrjes i jep kandidatëve për magjistratë njohuri më të plota me natyrë kriminologjike dhe penalogjike.

Masa alternative e shmangies i shërben më mirë qëllimeve të rishoqërizimit, rehabilitimit të të miturit dhe parandalimit të shkeljeve të ligjit përkundrejt vendosjes së tij nën përgjegjësinë penale dhe zbatimit të dënimit penal.

Stili i të shkruarit dhe i përgatitjes së materialit për botim, analizimi i situatës aktuale dhe në mënyrë të veçantë shkrimi ligjor dëshmon për profesionalizëm e qartësi. Materiali vjen edhe në kuadrin e një studimi krahasues të legjislacioneve të vendeve perëndimore për elementet e drejtësisë restauruese në fushën penale. Edhe nga ana formale, në botim janë respektuar të gjitha kërkesat dhe rregullat e shkrimit ligjor dhe shkencor.

Materiali është i pajisur me objektivat e trajnimit dhe synimet mësimore e pedagogjike për arritjen e kompetencave të kandidatëve për magjistratë.

Duke qenë se ndërmjetësimi është një procedurë me natyrë sa juridike, ashtu edhe sociale e psikologjike, autoret janë përpjekur të analizojnë kompleksitetin e gjithë këtyre elementeve në procedurat gjyqësore dhe hetimore. Kjo për faktin se KDPM-ja synon ta kryqëzojë procedurën e ndërmjetësimit me procedurën e hetimit nga prokurori apo të gjyqimit nga gjyqtari duke lënë hapësirën e pezullimit të procesit hetimor/gjyqësor në rast të kalimit drejt një procedure ndërmjetësimi.

Trajtimi është i gjerë dhe i plotë, ka hulumtim shkencor dhe analizë shkencore, shtrohen probleme e diskutime dhe jepen komentet dhe opinionet e eksperteve të shoqëruara edhe me këshilla dhe ilustrime praktike, me praktikë gjyqësore, ushtrime dhe pyetje për debat juridik.

Manuali me tre module për ndërmjetësimin dhe drejtësinë restauruese në drejtësinë penale për të mitur përgatitur nga prof. Arta Mandro dhe prof. Mariana Semini-Tutulani në kuadrin e bashkëpunimit të Shkollës së Magjistraturës me Terre des Hommes i plotëson maksimalisht të gjitha pritshmëritë dhe objektivat e parashtruara nga autoret në fillim të punimit dhe përmbush kërkesat dhe nevojat e Shkollës.

Arben RAKIPI

Drejtor i Shkollës së Magjistraturës

Shkurtime

BE	Bashkimi Evropian
GJED	Gjykata Evropiane e Drejtësisë
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
KEDNJ	Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut
KDF	“Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës” miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989, ratifikuar me ligjin nr.7531, datë 11.12.1991
KDPM	“Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur” miratuar me ligjin nr.37/2017, hyrë në fuqi më 1 janar 2018
KE	Këshilli i Evropës
KPrP	Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara

MODULI 1:

Kuadri ligjor për fëmijët / të rinjtë në konflikt me ligjin

Struktura dhe ngarkesa mësimore e modulit

Dita 1	
30 minuta	Prezantimi me temë: Kuadri ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar për fëmijët/të rinjtë në konflikt me ligjin.
30 minuta	Aktiviteti 1: Ndahemi në dy grupe dhe ndjekim dy ilustrime të ndryshme, të cilat më pas i komentojmë. Ilustrimi 1: Për të kuptuar më mirë fantazinë e fëmijëve dhe nëse dalloni një gënjeshtër ose jo të tyre ndiqni këtë video ilustruese marrë nga Ted Talks: “A mundet që ju të kuptoni nëse një fëmijë po gënjen (Can you really tell if a kid is lying?) Çfarë rëndësie ka kjo në çështjet me të mitur? https://www.ted.com/talks/kang_lee_can_you_really_tell_if_a_kid_is_lying/footnotes?referrer=playlist-5_talks_on_the_truth_about_lyi#t-5141 Ilustrimi 2: Përse fëmijët janë të gatshëm të pranojnë një krim që nuk e kanë bërë vetë? Pse kulturalisht fëmijët janë të gatshëm të thonë po? (Why teens confess to crimes they didn't commit?) Këtë video ilustruese shkëputur nga Ted Talks e gjeni në: https://www.ted.com/talks/lindsay_malloy_why_teens_confess_to_crimes_they_didn_t_commit/transcript?language=en
30 minuta	Aktiviteti 2: Pjesa e parë Ku mund ta gjeni një përmbledhje të përditësuar të bazës ligjore për të miturit në konflikt me ligjin? Pse ka rëndësi për rolin tuaj si gjyqtarë e prokurorë? A ka platforma në kuadrin e Këshillit të Evropës me të cilat mund të konsultoheni dhe përditësoheni me zhvillimet?

	<p>Pjesa e dytë</p> <p>Debat me temë: Si ta kuptojmë drejtësinë miqësore për të miturit në fushën e drejtësisë penale?</p> <p>Bëhet ndarja e auditorit në 3 – 4 grupe në varësi të numrit të pjesëmarrësve, ku në secilin grup janë 4 kandidatë për magjistratë. Çdo grup analizon me kujdes temën e debatit dhe përgatit konkluzionet me shkrim.</p> <p>Grupi zgjedh një prezantues, i cili do të prezantojë përpara auditorit konkluzionin e arritur.</p> <p>Prezantimi i konkluzioneve për Aktivitetin 1:</p> <p>Çdo grup paraqet konkluzionet e diskutimit: Pedagogu bën një rezymë të konkluzioneve të temës dhe të diskutimit.</p>
Dita 2	
30 minuta	<p>Prezantimi me temë: Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur dhe parimet e tij në mbrojtje të të drejtave të të miturve në procesin penal.</p>
60 minuta	<p>Aktiviteti 3:</p> <p>Debat:</p> <p>Si ta kuptojmë parimin e interesit më të lartë të të miturit të zbatuar në procesin penal?</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hartoni një listë kontrolli. - Çfarë vështirësish paraqiten? - Si gjendet i analizuar ky parim në praktikën gjyqësore? <p>Bëhet ndarja e auditorit në 3 – 4 grupe në varësi të numrit të pjesëmarrësve, ku në secilin grup janë 4 kandidatë për magjistratë. Çdo grup analizon me kujdes temën e debatit dhe përgatit konkluzionet me shkrim.</p> <p>Grupi zgjedh një prezantues që do të prezantojë përpara auditorit konkluzionin e arritur.</p>
30 minuta	<p>Prezantimi i konkluzioneve për Aktivitetin 2:</p> <p>Çdo grup paraqet konkluzionet e diskutimit. Pedagogu bën një rezymë të konkluzioneve të temës dhe të diskutimit.</p>

Objektivat mësimore

Pas përfundimit të këtij moduli, kandidatët për magjistratë do të jenë në gjendje:

- të njohin kuadrin ligjor kombëtar për drejtësinë penale për të mitur dhe drejtësinë restauruese e ndërmjetësimin;
- të aftësohen në zbatimin e parimeve të KDPM-së në proceset gjyqësore dhe hetimore që do të menaxhojnë në punën e tyre si gjyqtarë dhe prokurorë;
- të aftësohen në kuptimin e koncepteve që lidhen me drejtësinë miqësore, me interesin më të lartë të të miturit etj.;
- të njohin konceptet dhe pikëprerjet e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur me ligjin “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve” dhe Kodin e Procedurës Penale;
- të njohin kuadrin ligjor ndërkombëtar në nivelin e akteve të OKB-së, të BE-së, të KE-së etj., lidhur me drejtësinë penale për të mitur dhe drejtësinë restauruese.

“Drejtësia për të mitur” është një çështje me rëndësi që bazohet në dispozita që gjenden si në legjisllacionin kombëtar, ashtu dhe në normat e standardet ndërkombëtare. Janë dispozita materiale dhe procedurale që zbatohen hap pas hapi nga mekanizma/institucione, duke vendosur në qendër të vëmendjes të miturin. Këto norma janë specifike për të miturit në konflikt me ligjin penal. Sipas Konventës së OKB-së “Për të drejtat e fëmijës” (KDF): “Shtetet palë i njohin çdo fëmije të dyshuar, të akuzuar ose të cilësuar se ka kryer shkelje të ligjit penal, të drejtën e një trajtimi në pajtueshmëri me *zhvillimin e ndjenjës së dinjitetit dhe vlerës së fëmijës*, që përforcon tek ai respektin *për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve* dhe që merr parasysh moshën e fëmijës, si dhe dëshirën *për të nxitur riintegrimin e tij në shoqëri* dhe marrjen e një roli konstruktiv në të” (neni 40, pika 1 e KDF-së). Thënë në një mënyrë kaq sintetike, këto parime e qëllime janë në fokusin e drejtësisë restauruese dhe arrihen më shpejt përmes saj.

Vini re! Ka disa parime thelbësore në sistemin e drejtësisë për të mitur. Këto parime nevojitet të jenë në vëmendje të kandidatëve për magjistratë, por edhe të të gjithë autoriteteve të këtij sistemi. Ato përfshijnë:

- **Trajtimi njerëzor i fëmijëve:**

Sa fëmijë janë në kontakt me drejtësinë penale? Cili është trajtimi i tyre nga ky sistem? A janë këto procese stresuese dhe shkaktojnë të traumës te fëmijët?

Konventa për të Drejtat e Fëmijës ndalon qartë torturën, dënimin me vdekje dhe burgimin e përjetshëm pa mundësinë e lirisë, për të gjithë personat nën 18 vjeç. Në të kufizohet përdorimi i privimit të lirisë duke u konsideruar “si masë e fundit - kur të gjitha zgjidhjet e tjera alternative nuk duken të mundshme ose të

përshtatshme". Në rastet kur kërkohet heqja e lirisë, kjo duhet të jepet vetëm për periudhën më të shkurtër të mundshme. Për më shumë, kandidatët shohin tekstin e KDF-së në tërësi dhe veçanërisht nenin 37 të saj.

Kujdes! Nga praktikat e studiuara, jo domosdoshmërisht të vendit tonë por edhe të vendit tonë, të cilat nuk kanë qenë dhe aq të rralla përpara hyrjes në fuqi të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, fëmijëve shpesh u mohohet liria për shkelje të vogla jo të dhunshme ose edhe pa kryer një shkelje.

Kujdes! Fëmijët janë më të gatshëm të pranojnë një faj që nuk e kanë kryer vetë! Kulturalisht fëmijët i edukojnë të thonë "Po!". Komentoni një situatë kur fëmija kundërshton prindin e vet. A ju ka ndodhur që më së shumti keni vënë re se prindi nuk e toleron që fëmija ta kundërshtojë apo të pranojë kundërshtimin?

- **Vendosja e fëmijës në qendër të vëmendjes:**

Pra, të ndërtohet një sistem që vendos në qendër të tij fëmijën. Fëmija nuk mund të injorohet. Çdo fëmijë gëzon gjithë "paketën e të drejtave" të njohura ndërkombëtarisht. Sistemi, cilado pjesë e tij, nëse ka të bëjë me fëmijët, duhet të jetë i përqendruar te fëmija. Për sistemin, fëmija është subjekt i të drejtave dhe lirive themelore. Autoritetet kompetente duhet të sigurojnë që të gjitha veprimet në lidhje me fëmijën të udhëhiqen nga interesi më i lartë i fëmijës.

- **Specializimi i posaçëm i personave të përfshirë në drejtësinë për të miturit:**

Kjo do të mundësojë që sistemi i drejtësisë penale ta trajtojë fëmijën në përshtatje me moshën dhe nivelin e pjekurisë. Çdo pjesë e këtij sistemi duhet të zhvillohet dhe skicohet për të arritur këtë qëllim. Duke thënë "çdo pjesë" nënkuptojmë se ka hallka të shumëfishta e të ndërlydhura ku efektet e njëres dhe defektet e saj pasohen te tjetra. Sistemi dhe aktorët e tij duhet të kenë formimin e duhur profesional. Kjo përjasje nuk duhet të jetë e copëzuar, por të ofrohet duke e parë sistemin e drejtësisë për të miturit si "një i tërë", duke marrë në konsideratë rolin e veçantë të çdo hallke.

Vini re! Ka *tri çështje kyçe* me rëndësi për t'u mbajtur në vëmendje nga autoritetet në rastet me të mitur, të cilat janë:

- **Të bëhen të gjitha përpjekjet për të parandaluar përfshirjen e të miturit në veprimtari delinkuente:**

Duke parandaluar bëhet e mundur që të miturit të mos e shkelin ligjin dhe të mos vijnë në kontakt me sistemin formal të drejtësisë penale. Nuk ka asnjë dyshim se është më mirë të parandalosh!

- **Të nxitet shmangia dhe drejtësia restauruese:**

Kështu synohet që të miturit të kenë mundësi, në të gjitha fazat e mundshme të procesit, të largohen nga

sistemi formal i drejtësisë dhe t'iu drejtohen proceseve të bazuara në komunitet dhe në restaurimin e tyre. Kjo mënyrë veprimi përqendrohet në mënyrë efektive në shkaqet e sjelljeve të tyre duke i riparuar ato.

- **Të mbahet në vëmendje mbrojtja e fëmijëve:**

Nëse një fëmijë është në konflikt me ligjin, atij t'iu garantohen të gjitha të drejtat e njeriut dhe të drejtat si i mitur, duke u përqendruar në zhvillimin e tyre me qëllim që të eliminohet viktimizimi dhe riviktimizimi i tyre dhe viktimizimi dytësor dhe të promovohet rehabilitimi i tyre.

Aktiviteti 1:

Ndahemi në dy grupe dhe ndjekim dy ilustrime të ndryshme të cilat më pas i komentojmë.

Ilustrimi 1: Për të kuptuar më mirë fantazinë e fëmijëve dhe nëse dalloni një gënjeshtër ose jo të tyre ndiqni këtë video ilustruese marrë nga Ted Talks: "A mundet që ju të kuptoni nëse një fëmijë po gënjen (Can you really tell if a kid is lying?)"

https://www.ted.com/talks/kang_lee_can_you_really_tell_if_a_kid_is_lying/footnotes?referrer=playlist-5_talks_on_the_truth_about_lyi#t-5141

Ilustrimi 2: Përse fëmijët janë të gatshëm të pranojnë një krim që nuk e kanë bërë vetë? (Why teens confess to crimes they didn't commit?) Këtë video ilustruese shkëputur nga Ted Talks e gjeni në:

https://www.ted.com/talks/lindsay_malloy_why_teens_confess_to_crimes_they_didn_t_commit/transcript?language=en

1. Një vështrim i shkurtër mbi kuadrin normativ lidhur me shmangien dhe zbatimin e programeve të drejtësisë restauruese e ndërmjetësimit për të miturit

1.1 Legjislacioni vendas

Ndonëse nuk ka një dispozitë specifike lidhur me shmangien ose drejtësinë restauruese, **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**, nënvizon se fëmijët gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti (neni 54, pika 1) dhe se liria e të miturit nuk mund të kufizohet, përveçse për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent (neni 27, pika 1 dhe 27, pika 2/ç).

Rregullime më të detajuara gjenden në:

- Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur: Kjo paketë e re normative me rëndësi ka hyrë në fuqi më 1 janar 2018 dhe është miratuar me ligjin nr. 37/2017. Në KDPM ka një kre të veçantë, kreu VII me titull: “Shmangia nga ndjekja penale dhe nga dënimi përmes masave alternative”, në të cilin përcaktohen kushtet dhe kriteret për zbatimin e masës së shmangies dhe procedura për zbatimin e saj nga prokurori dhe gjyqtari etj. Trajtime të hollësishme gjenden në vijim të këtij manuali.
- Kodin e Procedurës Penale, i ndryshuar: edhe ky Kod ka një sërë nenesh me rëndësi ku veçojmë nenet 59, 284, 338. Mes KPP-së dhe KDPM-së ka një lidhje organike dhe natyrore sa edhe të qartë ndarëse. Në nenin 5 të KDPM-së nënvizohet se: *“Dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe të ligjeve të tjera, zbatohen në procesin e drejtësisë penale për të mitur vetëm për çështje që nuk janë të rregulluara nga ky Kod ose nëse përmbajnë rregullime më të favorshme për të miturit”*.
- Kodin Penal, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, i ndryshuar. Rregullimi i nenit 5 të KDPM-së vlen edhe në raportet me këtë Kod.
- Ligjin nr. 10385, datë 24.2.2011, “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, i ndryshuar ka potencialin të bëjë rregullimet specifike që lidhen me ndërmjetësimin dhe si i tillë ka lidhje me KDPM-në.
- Ligjin nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” është një ligj me rëndësi të veçantë që nevojitet të mbahet në vëmendje sa herë kemi të bëjmë me subjekte në moshë të mitur. Në këtë ligj paketa e të drejtëve të fëmijëve dhe mekanizmat janë të domosdoshëm në punën e gjykatës dhe prokurorisë për të mbajtur në qendër fëmijën në çdo vendimmarrje.

- Ligjin nr. 10279/20.5.2010, “Për kundravajtjet administrative” përcakton rregullat për konstatimin dhe shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative, i cili përcakton procedurat dhe afatet e ankimit ndaj akteve të organeve të administratës publike që vendosin dënime administrative, si dhe procedurat e ekzekutimit të sanksioneve administrative. Ky ligj zbatohet për të gjitha vendimet e organeve të administratës publike, që parashikojnë dënime administrative e që krijojnë pasoja juridike në raste individuale. Procedurat e parashikuara në dispozitat e veçanta të këtij ligji, për vënien në ekzekutim të vendimeve për kundërvajtjen administrative, zbatohen rast pas rasti, në përputhje me natyrën e organeve të administratës publike që i kanë nxjerrë dhe me llojin e dënimit të parashikuar në akt.
- Ligjin nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”. Sipas këtij ligji, në nenin 11 të tij përcaktohen “Kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike”, të cilët e përfitojnë atë pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së tyre, si: a) viktimave të dhunës në familje; b) viktimave të abuzuar seksualisht dhe viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, në çdo fazë të procedimit penal; c) viktimave të mitur dhe të miturve në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal; ç) fëmijëve, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore; d) fëmijëve nën kujdestari, të cilët kërkojnë të nisnin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor... (shih për më shumë nenin 11 të këtij ligji si dhe format e ndihmës juridike). Lidhur me avokatët që ofrojnë ndihmë juridike dytësore nenin 24/ç kërkohet të jenë *“të specializuar në fusha të së drejtës, kur specializimi është i nevojshëm, si në rastin e përfaqësimit të të miturve, të viktimave dhe në raste të tjera të parashikuara me ligj”*.
- Kodin e Familjes të vitit 2003, veçanërisht pjesa e parë e tij mbi “Parimet” dhe pjesa e tretë e tij me titull “Fëmijët”. Me rëndësi është edhe pjesa e dytë që përcakton rregullime për “Bashkëshortët” në të cilën gjenden rregullime të marrëdhënieve mes tyre e fëmijëve.
- Ligjin nr. 9669/18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar.
- Ligjin nr. 10221/2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
- Rregullimet përfshijnë edhe ligje të tjera e akte nënligjore. Pas hyrjes në fuqi të KDPM-së një sërë aktesh nënligjore janë miratuar dhe këto kanë rëndësi njohëse.

1.2 Instrumentet ndërkombëtare

Ekzistojnë disa standarde ndërkombëtare të cilat nxisin praktikat më të mira që sistemi i drejtësisë për të mitur të jetë: i drejtë, efikas dhe efektiv.

1. Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës

Neni 40, pika 3, germa "b" e saj siguron bazën ligjore për programet e shmangies të bazuar në të drejta për fëmijët në konflikt me ligjin. Në të parashikohet detyrimi i shteteve që të marrin masa, sa herë që është e nevojshme dhe e dëshirueshme, për t'i trajtuar këta fëmijë pa iu drejtuar procedurës gjyqësore, me kusht që të respektohen plotësisht të drejtat e njeriut dhe garancitë ligjore. *Neni 40, pika 1 e KDF-së* përshkruan synimin e përgjithshëm të sistemit të drejtësisë për të mitur. Ky nen inkurajon që fëmijët të marrin përgjegjësi për veprimet e tyre dhe sistemi i drejtësisë të mbajë në vëmendje riintegrimin e fëmijës. Shmangia dhe alternativat, veçanërisht kur ato miratohen si pjesë e përqasjes së drejtësisë restauruese, janë më në përputhje me këto qëllime sesa heqja e lirisë.

2. Komenti i përgjithshëm nr. 10 (2007) i Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve

Komenti nr. 10, "Të drejtat e fëmijëve në drejtësinë për të mitur", thekson se shmangia dhe drejtësia restauruese janë pjesë përbërëse e sistemeve efektive të drejtësisë për të mitur, të bazuara në të drejtat e fëmijëve dhe me pikësynime afatshkurtra dhe afatgjata si për fëmijën ashtu edhe për shoqërinë. Interpretimi i Komitetit për zbatimin e parimit të "interesit më të lartë" (parimi i nenit 3 të KDF-së) nënkupton promovimin e metodave të rehabilitimit, më shumë se sa drejtësinë ndëshkuese. Në këtë koment nënvizohet përdorimi i shmangies sa më shumë që është e mundur, nisur edhe nga fakti se veprat penale të të miturve janë të lehta.

Në vijim do të citojmë disa paragrafë me rëndësi të këtij dokumenti:

- Pjesa I – "Hyrje". **Paragrafi 3:** Drejtësia për të miturit e administruar në përputhje me KDF-në: "... duhet të promovojë, ndër të tjera, përdorimin e masave alternative si shmangia dhe drejtësia restauruese, do t'iu japë shteteve palë mundësinë për t'iu përgjigjur fëmijëve në konflikt me ligjin në mënyrë efektive duke përmbushur jo vetëm interesin më të lartë të këtyre fëmijëve, por edhe interesin afatshkurtër dhe afatgjatë të shoqërisë në përgjithësi".
- Pjesa III – "Drejtësia për të mitur: parimet kryesore të një politike gjithëpërfshirëse". **Paragrafi 10:** "Mbrotjta e interesave më të larta të fëmijës do të thotë, për shembull, që objektivat tradicionale të drejtësisë penale, si represioni/ndëshkimi, duhet t'i hapin rrugë objektivave të rehabilitimit dhe drejtësisë restauruese në trajtimin e kundërvajtësve të mitur".

- Pjesa IV – “Drejtësia për të mitur: elementet kryesore të një politike gjithëpërfshirëse”. B. Ndërhyrjet / shmangia – Ndërhyrjet pa përdorur procedurat gjyqësore. **Paragrafi 24:** “Sipas nenit 40, pika 3 të KDF-së, shtetet palë do të përpiqen të promovojnë masat për trajtimin e fëmijëve që dyshohen, akuzohen ose që cilësohen se kanë shkelur ligjin penal, pa u mbështetur në procedimet penale, çdo herë që është e përshtatshme dhe e dëshirueshme. Duke pasur parasysh faktin se shumica e shkelësve fëmijë kryejnë vetëm kundërvajtje penale, një sërë masash që përfshijnë shmangien nga procedimi penal/ procedimi penal për të mitur dhe referimin në shërbime alternative (sociale) (domethënë shmangien), duhet të kthehen në një praktikë të konsoliduar që mund dhe duhet të përdoret në shumicën e rasteve.
- **Paragrafi 25:** “Sipas mendimit të Komitetit, ... mospërdorimi i procedimeve penale zbatohet, por sigurisht që nuk kufizohet vetëm te fëmijët që kryejnë kundërvajtje të lehta, siç janë vjedhjet e dyqaneve ose kundërvajtje të tjera të lehta me dëm të vogël kundër pronës, dhe te të miturit që shkelin ligjin për herë të parë. Statistikat në shumë shtete tregojnë se, një pjesë e madhe dhe shpesh shumica e veprave penale të kryera nga fëmijët përfshihen në këto kategori. Trajtimi i këtyre rasteve jashtë procedimit penal në gjykatë është në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 40, pika 1 të KDF-së. Përveç shmangies së stigmatizimit, kjo përjasje ka rezultate të mira për fëmijët dhe është në interes të sigurisë publike, si dhe ka provuar të jetë më ekonomike”.
- **Paragrafi 26.** Shtetet palë duhet të marrin masa që ndaj fëmijëve në konflikt me ligjin të mos i përdorin procedimet penale si pjesë përbërëse të sistemit të tyre të drejtësisë për të mitur dhe të sigurojnë kështu respektimin dhe mbrojtjen e plotë të të drejtave të njeriut dhe sigurisë ligjore të fëmijëve (neni 40, pika 3, germa “b”).
- **Paragrafi 27:** Ky paragraf thekson gamën e mundësive të shmangies dhe ekzistencën e një eksperience të gjerë të disa shteteve, e cila është e nevojshme të njihet për zbatimin e shmangies pa anashkaluar masat mbrojtëse ligjore të nevojshme. “... në bazë të informacionit të dhënë në raportet e disa shteteve palë, është e qartë se janë zhvilluar një sërë programesh të bazuara në komunitet, siç është shërbimi në komunitet, mbikëqyrja dhe udhëzimi nga punonjësit socialë ose oficerët e shërbimit të provës, konferenca familjare dhe forma të tjera të drejtësisë restauruese duke përfshirë dëmshpërblimin dhe kompensimin e viktimave. Shtetet e tjera duhet të përfitojnë nga këto përvoja. Sa i përket respektimit të plotë të të drejtave të njeriut dhe sigurisë ligjore, Komiteti i referohet rregullave relevante të nenit 40 të KDF-së dhe thekson si në vijim: shmangia (p.sh. masat për trajtimin e fëmijëve, që dyshohen, akuzohen ose që cilësohen se kanë shkelur ligjin penal pa përdorur procedimin penal) duhet të përdoret vetëm kur ka prova bindëse se fëmija ka kryer veprën e pretenduar, kur ai/ajo pranon lirisht dhe vullnetarisht përgjegjësinë, dhe kur asnjë kërcënim ose presion nuk është përdorur për të siguruar pranimin e fajësisë dhe, më në fund, se pranimi i fajësisë nuk do të përdoret kundër tij në asnjë procedim penal të mëvonshëm. Fëmija duhet të japë lirisht

dhe vullnetarisht pëlqimin me shkrim për shmangien, një pëlqim që duhet të bazohet në informacionin konkret dhe të duhur mbi natyrën, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e masës dhe për pasojat e mungesës së bashkëpunimit, moskryerjes dhe mosplotësimit të masës. Me synimin për të forcuar përfshirjen e prindërve, shtetet palë gjithashtu, mund të marrin në konsideratë kërkesën për marrjen e pëlqimit të prindërve, veçanërisht kur fëmija është nën moshën 16 vjeç. Ligji duhet të përmbajë dispozita specifike që tregojnë se në cilat raste është e mundur shmangia dhe duhet të rregullohen dhe rishikohen kompetencat e policisë, prokurorëve dhe / ose agjencive të tjera për të marrë vendime në këtë drejtim, veçanërisht për të mbrojtur fëmijën nga diskriminimi. Fëmijës duhet t'i jepet mundësia të kërkojë ndihmë juridike ose çdo ndihmë tjetër të nevojshme mbi përshtatshmërinë dhe dëshirueshmërinë e shmangies së ofruar nga autoritetet kompetente dhe mundësinë e rishikimit të masës. Përfundimi i shmangies nga fëmija duhet të sjellë si pasojë mbylljen e plotë dhe përfundimtare të çështjes. Megjithatë mund të mbahen të dhëna konfidenciale mbi shmangien për qëllime administrative dhe kontrolli, ato nuk duhet të konsiderohen si "të dhëna mbi gjendjen penale" dhe një fëmijë që është shmangur nuk duhet të konsiderohet si i dënuar më parë. Nëse bëhet ndonjë regjistrim të dhënash për çështjen, aksesimi në këtë informacion duhet t'i jepet në mënyrë ekskluzive dhe për një periudhë të kufizuar kohe, p.sh. maksimumi për një vit, autoriteteve kompetente të autorizuara për të punuar me fëmijët në konflikt me ligjin.

3. Komenti i përgjithshëm nr. 12 (2009) i Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve

Komenti mbi "të drejtën e fëmijës për t'u dëgjuar" thekson rëndësinë e të drejtës së fëmijës për t'u dëgjuar. Komenti përmban referenca specifike mbi shmangien. Pjesa e tretë e këtij komenti në paragrafin 59, përfshin garancitë ligjore dhe dispozitat mbi shmangien të cilat janë përshkruar në paragrafin 27 të komentit të përgjithshëm nr. 10 dhe në Rregullat e Pekinit (11.3) dhe të drejtën e fëmijës për t'u dëgjuar në procedimin penal.

Paragrafi 59: "Në rastin e shmangies, duke përfshirë ndërmjetësimin, fëmija duhet të ketë mundësinë për të dhënë pëlqimin e lirë dhe vullnetar dhe atij duhet t'i jepet mundësia për të marrë këshilla dhe ndihmë juridike por jo vetëm, për të përcaktuar përshtatshmërinë dhe dëshirueshmërinë e shmangies së propozuar".

4. Komenti i përgjithshëm nr. 9 (2006) i Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve

Komenti trajton "të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara". Përveç komenteve të përgjithshme nr. 10 dhe nr. 12 të sipërpërmendura, të cilat zbatohen për të gjithë fëmijët në konflikt me ligjin, Komiteti për të Drejtat e Fëmijës ka përgatitur gjithashtu, komente të përgjithshme të cilat kanë rëndësi për grupe të veçanta të fëmijëve në konflikt me ligjin. Komenti i përgjithshëm nr. 9 i kushtohet në mënyrë të veçantë fëmijëve me aftësi të kufizuara. Me interes për këtë manual është paragrafi 74, germa "b" e tij, në të cilën këshillohet që shmangies nga sistemet formale të drejtësisë, t'i jepet prioritet për fëmijët me aftësi të kufizuara në konflikt me ligjin.

Pjesa IX – “Masat e posaçme të mbrojtjes” A. Sistemi i drejtësisë për të mitur: **“paragrafi 74, germa “b”**: “Qeveritë duhet të zhvillojnë dhe zbatojnë masa alternative, të shumëllojshme dhe fleksible, që lejojnë përshtatjen e masës me aftësitë dhe mundësitë individuale të fëmijës, në mënyrë që të shmangët përdorimi i procedimeve penale. Fëmijët me aftësi të kufizuara në konflikt me ligjin, duhet të trajtohen sa më shumë që të jetë e mundur pa shfrytëzuar procedurat formale/ligjore. Këto procedura do të përdoren vetëm kur është e nevojshme dhe në interes të rendit publik. Në këto raste duhet të bëhen përpjekje të veçanta për të informuar fëmijën lidhur me procedurën e drejtësisë për të mitur dhe të drejtat e tij ose saj”.

Aktiviteti 2:

Pjesa e parë

- Ku gjendet përmbledhja e përditësuar e bazës ligjore për të miturit në konflikt me ligjin? Pse ka rëndësi për rolin tuaj si gjyqtarë e prokurorë?
- A ka platforma në kuadrin e Këshillit të Evropës me të cilat mund të konsultoheni dhe përditësoheni me zhvillimet?

Pjesa e dytë

Debat me temë: Si ta kuptojmë drejtësinë miqësore për të miturit në fushën e drejtësisë penale?

Bëhet ndarja e auditorit në 3-4 grupe në varësi të numrit të pjesëmarrësve, ku në secilin grup janë 4 kandidatë për magjistratë. Çdo grup analizon me kujdes temën e debatit dhe përgatit konkluzionet me shkrim.

Grupi zgjedh një prezantues që do të prezantojë përpara auditorit konkluzionin e arritur.

Prezantimi i konkluzioneve për Aktivitetin 1:

Çdo grup paraqet konkluzionet e diskutimit.

Pedagogu bën një rezymë të konkluzioneve të temës dhe të diskutimit.

2. Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur. Parimet kryesore

Të drejtat e fëmijëve në kontekstin e procedimeve të drejtësisë për të mitur ose në kontakt me drejtësinë penale në KDPM lidhen me këto dy situata:

- ◇ kur fëmijët janë të dyshuar, të akuzuar ose të dënuar për kryerje të veprave penale; dhe
- ◇ kur fëmijët janë në kontakt me sistemin e drejtësisë si viktima dhe/ose dëshmitarë.

Në vijim po rendisim parimet themelore që duhet të mbahen parasysh nga çdo autoritet që përfshihet në administrimin e drejtësisë për të mitur. Këto parime përfshijnë:

- *Garantimin e një procesi të drejtë/ të rregullt gjyqësor* duke përfshirë pjesëmarrjen efektive dhe të drejtën për një mbrojtës/avokat: e drejta për një proces të drejtë është shtylla bazë e një shoqërie demokratike. Fëmijët në konflikt me ligjin janë më të rrezikuar dhe kërkojnë një mbrojtje të veçantë.
- E drejta e fëmijëve për të pasur *akses në një avokat* nga fillimi i procedimit penal duke përfshirë qysh marrjen e parë në pyetje nga policia.
- *Privimi nga liria si mundësia e fundit dhe për një kohë sa më të shkurtër.*

Zgjidhja pa vonesë e çështjeve është thelbësore edhe për të kufizuar ndikimin negativ psikologjik të procedurave ligjore të fëmijët. Kur nuk shmanget dot privimi nga liria, fëmijët duhet, si rregull, të mbahen veç nga të rriturit. Në të gjitha rastet, fëmijët duhet të ndalohen në mjedise të përshtatshme për nevojat e tyre. Duke pasur parasysh ndjeshmërinë e fëmijëve të privuar nga liria, rëndësinë e lidhjeve familjare dhe promovimin e riintegritimit në shoqëri, autoritetet kompetente duhet të sigurojnë respektimin e tyre dhe të mbështesin në mënyrë aktive plotësimin e të drejtave të fëmijës. Aplikimi i Shërbimit të Provës dhe dënimeve të tjera alternative ndikon në uljen e përqindjes së rasteve të fëmijëve që dënohen me burgim.

- *Procedurat, mjedisi dhe komunikimi me fëmijët të jetë miqësor.*

Fëmijët, sipas standardeve, në të gjitha procedurat, trajtohen duke respektuar moshën, nevojat e tyre të veçanta, pjekurinë dhe nivelin e të kuptuarit dhe duke pasur parasysh çdo vështirësi të mundshme në komunikim. Para se të fillojë procedura, fëmijët duhet të njihen me konceptin e gjykatës dhe rolin e administratës gjyqësore. Gjuha duhet të përshtatet me moshën dhe nivelin e zhvillimit të fëmijëve. Gjithashtu, gjyqtarët dhe/ose prokurorët duhet të kenë kujdes jo vetëm që informacioni të jetë i përshtatshëm për ta, por edhe për mënyrën e komunikimit. Gjatë procesit hetimor dhe gjyqësor fëmijët duhet të jenë të shoqëruar nga prindërit dhe kur pjesëmarrja e prindërve nuk është e mundur, nga një i rritur i zgjedhur nga vetë fëmija.

Në rastin e fëmijëve duhet që thëniet e regjistruara në video dhe audio të lejohen të kenë vlerën e dëshmisë. Fëmijët duhet të mbrohen, sa më shumë të jetë e mundur, ndaj imazheve ose informacioneve që mund të jenë

të dëmshme për mirëqenien e tyre. Në rast se gjyqtari çmon se një informacion ose imazh i dëmshëm duhet t'i bëhet i ditur fëmijës, për hir të procesit, ai mund ta bëjë këtë vetëm pas konsultimit me psikologun ose punonjësën social. Gjyqtarët dhe prokuroria duhet t'i kushtojnë vëmendje edhe ritmit dhe kohëzgjatjes së proceseve, pasi fëmijët nuk mund të përqendrohen për një kohë të gjatë. Ndërkohë, nevojitet të shihet mundësia që edhe sallat e pritjes si dhe salla gjyqësore të jenë "miqësore" për fëmijët.

- *Kujdes dhe vëmendje ndaj rasteve të përdorimit të paraburgimit si masë sigurimi. KDPM-ja ka në vëmendje politikat dhe masat lidhur me minimizimin e kohës së qëndrimit në paraburgim.*

Në vitin 2012, Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve¹ ka shprehur shqetësimin për Shqipërinë lidhur me "përdorimin e vazhdueshëm të paraburgimit të fëmijëve, të cilët mund të kalojnë muaj në paraburgim pa iu krijuar mundësia e arsimimit, e mbështetjes psikologjike dhe masave të riintegritit". Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve parashikon se procedurat nuk mund të zgjasin më shumë se 6 muaj çka ndikon edhe në afatet e paraburgimit.² Neni 323, i Kodit të Procedurës Penale të Shqipërisë përcakton afatin e hetimeve paraprake. Kjo dispozitë ka pësuar ndryshime në vitin 2017. Në të përcaktohet se hetimi duhet të përfundojë brenda një afati tremujor nga data e regjistrimit të çështjes penale (neni 323, paragrafi 2) ose gjashtë muaj për veprat penale të parashikuara nga shkronjat "a" dhe "b" të nenit 75/a të KPP-së. Por, pavarësisht kësaj, ekziston mundësia e zgjatjes së këtij afati (shih nenin 324 të KPP-së). Kjo zgjatje afati bie në kundërshtim me parimet dhe standardet e parashikuara nga Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve, të cilat kërkojnë që një fëmijë nuk mund të qëndrojë në paraburgim më shumë se 6 muaj. Në rastin kur në një proces gjyqësor janë përfshirë fëmijët, gjykatat dhe prokuroria duhet të zbatojnë parimin e urgjencës në mënyrë që të sigurojnë një gjykim sa më të shpejtë dhe të mbrojnë interesin më të lartë të fëmijëve, në përputhje me standardet e shtetit të së drejtës. Ky parim gjen vend në nenin 17 të KDPM-së me titull: "Shqyrtimi pa vonesë dhe me përparësi" dhe në disa nene të tjera. Pra, në çështjet me të mitur gjyqtarët e prokurorët mbajnë në vëmendje se dispozitat e KPP-së duhen zbatuar në harmoni me KDPM-në.

- *Nxitja e përdorimit të dënimeve alternative për të miturit.*

◊ *Dënimet për fëmijët dhe për veprat penale kundër fëmijëve.*

Ndryshimet në Kodin Penal kanë përfshirë parashikime të reja të disa figurave të veprave penale ndaj fëmijëve. Dokumenti Analitik mbi "Analizën e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri"³ (në vijim Dokumenti Analitik), konstaton faktin e nevojës së rishikimit të legjislacionit në mënyrë që të krijohet qartësi dhe unifikim

¹ Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve, sesioni 61, datë 17 shtator – 5 tetor 2012.

² KDF në mënyrë eksplicite kërkon që një proces nuk mund të zgjasë më shumë se 6 muaj, duke reduktuar në këtë mënyrë edhe periudhën e paraburgimit në maksimumi 6 muaj.

³ Përgatitur nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë dhe botuar në qershor 2015. Qëllimi i këtij dokumenti është analizimi i gjendjes aktuale të sistemit të drejtësisë duke marrë si pikënisje miratimin e Kushtetutës së RSH-së më 1998.

i politikës penale. Në këtë drejtim, u vlerësua e nevojshme që i gjithë procesi i rishikimit, për pjesët kur viktimat janë fëmijët ose për vepra penale kundër tyre, duhet të udhëhiqet nga 5 parimet bazë të të drejtave të fëmijëve si:

- ◇ interesi më i lartë i fëmijëve;
- ◇ pjesëmarrja;
- ◇ zhvillimi dhe mirëqenia;
- ◇ mosdiskriminimi dhe
- ◇ shteti i së drejtës.

Në lidhje me masat edukuese për fëmijët nën 14 vjeç në konflikt me ligjin, Dokumenti Analitik vetëm konstaton se masat edukuese për vendosjen e të miturve në një institucion kanë mbetur të pazbatuara pasi nuk është ngritur një i tillë. Rekomandohet që edhe këtu, theksi të vihet te fakti se vendosja e të miturit në një institucion mbetet një kufizim i lirisë së të miturit, ndërsa mund të jetë pikërisht mjedisi i tij, familjar ose shoqëror a në komunitet, i njohur për të, që mund të jetë më i miri për të trajtuar sjelljen problematike të të miturit. Pra, duhet shkuar gjithnjë e më shumë drejt shërbimeve në komunitet për fëmijët e duke e përdorur institucionalizimin aty ku nuk ka alternativë tjetër. KDPM-ja dhe gjithë kuadri ligjor që lidhet me të miturit ka marrë në konsideratë shqetësimet e mësipërme duke sjellë një kuadër ligjor të përshtatur me standardet ndërkombëtare mbi drejtësinë miqësore për të miturit. Në vijim të këtij manuali do të njiheni me detaje.

- *Ndërmarrja e politikave për uljen e recidivizmit.*

Për shumë kohë në vendin tonë shtrohej problemi i shtimit të numrit të fëmijëve autorë të veprave penale dhe recidivistë. Ka disa arsye që janë shkaktare të kësaj pasoje (rritja në nivelin pothuaj 40% të recidivistëve është shenjë alarmi). Ndër të tjera recidivizmi lidhet me dy fenomene. Së pari, duket se nuk janë zbatuar masat e duhura të dënimit të cilat për rrjedhojë nuk kanë sjellë pasojë “korigjuese” te fëmijët. Së dyti, kjo është sinjalizuese për të nxjerrë në pah mungesën e ndërveprimit ndërmjet institucioneve të mbrojtjes sociale dhe punës që ata duhet të bëjnë me fëmijët që kanë qenë në konflikt me ligjin. Pra, ndërhyrjet kërkonin një ndërlidhje më e mirë mes sistemit të drejtësisë me atë të arsimit e mbrojtjes sociale, si për parandalimin, ashtu edhe për riintegrimin e të miturve në konflikt me ligjin. Bashkëveprimi ndërmjet këtyre institucioneve nuk duhet të kufizohet vetëm për t’u siguruar të miturve mësues, gjatë kohës së vuajtjes së dënimit. U vu re se pas vuajtjes së dënimit, nuk kishte asnjë program mbështetjeje sociale për këta fëmijë, i cili nga njëra anë të sigurojë mbështetjen e nevojshme për integrimin e fëmijëve në shoqëri, por nga ana tjetër, të bëjë analizën e ecurisë së fëmijëve pas vuajtjes së dënimit duke bërë parandalimin e hershëm të mundësive për të qenë recidivist.

Detyrë në grup

Analizoni se si janë plotësuar këto mangësi në kuadrin ligjor ekzistues. A ka vend për përmirësim? Në cilat drejtime? A ka mundësi që përmirësimet të lidhen me rolin tuaj si gjyqtarë e prokurorë të ardhshëm apo kërkojnë detyrimisht ndërhyrje të tjera që nuk varen nga ju?

- *Fëmijët viktima*

Si është statusi i fëmijëve viktima të veprave penale në kuadrin ligjor vendas? A janë përfshirë në këto rregullime standardet ndërkombëtare? Vini re se çfarë përmban kuadri rregullator i OKB-së edhe ato të BE-së e të Këshillit të Evropës. Për shembull, Direktiva 2012/29/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 25 tetor 2012 për përcaktimin e standardeve minimale *për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit* përcakton: “Viktimat të trajtohen me respekt; policia, prokurorët dhe gjyqtarët të jenë të trajnuar në ndjeshmërinë ndaj viktimës; viktimat kanë të drejtë që të mbahen të informuar për rastin e tyre, në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme për ta; duhet të ngrihet një shërbim i caktuar për mbështetjen e viktimave; viktimat mund të marrin pjesë në proces dhe duhet të ndihmohen për të marrë pjesë në gjykim; shtetet duhet të identifikojnë viktimat e rrezikuara, siç janë viktimat e sulmeve seksuale, viktimat me aftësi të kufizuara apo fëmijët, dhe t’i mbrojnë në mënyrën e duhur; shtetet duhet të sigurojnë mbrojtjen e viktimave, gjatë kohës që policia heton krimin si dhe gjatë procedurave gjyqësore.” ***A ka një qëndrim të ri ligjor lidhur me statusin e të miturit viktimë? Analizojeni këtë.***

- *Aksesi në gjykatë dhe në procesin gjyqësor*

Bazuar në të drejtat e tyre, fëmijët duhet të kenë akses te mjetet juridike dhe mekanizmat ligjore. Neni 58 i Kodit të Procedurës Penale (KPP) parashikon se personat e dëmtuar nga disa vepra penale (koncepti i të dëmtuarit akuzues) kanë të drejtë të kërkojnë procedimin penal ndaj fajtorit. Ushtrimi i kësaj të drejte është i lidhur ngushtësisht me zotësinë për të vepruar. Neni 58, pika 2 e KPP-së, kërkon që i dëmtuari akuzues të ketë zotësinë për të vepruar për të ushtruar drejtpërdrejt këtë të drejtë. Në rast se nuk ka zotësi për të vepruar, atëherë Kodi parashikon që kjo e drejtë mund të ushtrohet nëpërmjet përfaqësuesit ligjor. Ky parashikim e kufizon drejtpërdrejt dhe e përjashton të drejtën e fëmijës për t’u ankuar, në rast se është dëmtuar nga veprat penale parashikuara në Kodin Penal, të tilla si: rrahja (dëmtime të tjera me dashje, neni 90 i Kodit Penal), plagosja e rëndë dhe e lehtë nga pakujdesia (neni 91 dhe 92) etj. E njëjta linjë arsyetimi mbi njohjen e të dëmtuarit akuzues dhe mosngritjen e akuzës për çështjet e përcaktuara në nenet 58 – 59 të KPP-së, jepet edhe në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 3/6.2.2008 (V-3/08).

- *E drejta për t’u dëgjuar dhe për t’u shprehur*

Asnjë fëmijë nuk duhet të përjashtohet nga dëgjimi vetëm për shkak të moshës. Çdo institucion i sistemit të drejtësisë duhet të respektojë iniciativën që ndërmerr fëmija viktimë për t’u dëgjuar për çështjet që e prekin, me përjashtim të rastit kur çmohet se nuk është në interesin më të mirë të fëmijës. Fëmijët duhet të informohen se si të përdorin në mënyrë efektive të drejtën për t’u dëgjuar. Nga ana tjetër, gjyqtarët dhe avokatët duhet t’iu shpjegojnë fëmijëve se e drejta e tyre për t’u dëgjuar dhe për të shprehur pikëpamjet, jo domosdoshmërisht mund të përcaktojë vendimin përfundimtar. Vendimet e gjykatave që prekin fëmijët duhet të jenë të arsyetuara në një gjuhë që mund të kuptohet nga fëmijët, dhe në to të jepen sqarime, sidomos për pjesën e mendimeve të shprehura nga fëmijët që nuk janë marrë në konsideratë nga gjykata.

- *Vonesat në proces*

Garantimi i përfundimit të një procesi gjyqësor brenda një periudhe sa më të shkurtër është i rëndësishëm edhe kur fëmijët janë viktimë. Vonesat në procedura mund të kenë një efekt negativ tek ata. Zgjidhja e rasteve pa vonesa të panevojshme është thelbësore, si për të kufizuar ndikimin negativ psikologjik të procedurave ligjore te fëmijët, por edhe për të shmangur ndryshimin e perceptimit në kohë të fëmijëve për të njëjtën çështje. Sipas udhëzuesit të Këshillit të Evropës “Për një drejtësi miqësore për fëmijët”⁴, është e rëndësishme të mbahet parasysh shtrirja në kohë nga kryerja e krimit (në çështjet penale) deri në përcaktimin e masës përkatëse ose nga shkelja apo mohimi i të drejtave (në çështje civile) deri në dhënien e vendimit ose deri në zbatimin e tij. Po sipas të njëjtit udhëzues, në qoftë se fëmija viktimë është thirrur për të dëshmuar para gjykatës së shkallës së dytë rreth tre vjet më vonë nga dëshmia në shkallën e parë, dëshmitë mund të jenë krejt të ndryshme. Kjo ndodh jo vetëm për shkak të kalimit të kohës, por se një 12-vjeçar/e ka zhvilluar ndërkohë një perceptim tjetër të ngjarjeve, krahasuar me perceptimin që kishte si një 9-vjeçar/e.

- *Shmangia e ballafaqimit me të akuzuarit*

Legjislacioni shqiptar përpara KDPM-së ka qenë tepër i kufizuar në lidhje me parashikimin e masave që sigurojnë shmangien e ballafaqimit të viktimës me të akuzuarin, sidomos kur viktimat janë fëmijë. Të vetmet raste ku ka një rregullim më specifik për këtë çështje kanë të bëjnë me rastet e dhunës në familje. Sipas një studimi të UNICEF-it ⁵, avokatët e intervistuar u shprehën se “kjo mbrojtje ndryshon rast pas rasti”. Ka më shumë parashikime në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve në rastet e dhunës ndaj tyre, kur “dhunuesi është një prind ose pjesëtar i familjes”. Në Shqipëri edhe pse ka një ligj për mbrojtjen e dëshmitarëve, duke përfshirë fëmijët të cilët janë dëshmitarë të një krimi, praktikisht nuk ka shumë për të thënë në lidhje me zbatimin e tij.

- *Dëshmitë, deklaratat e fëmijëve*

Intervistat dhe mbledhja e deklaratave nga fëmijët duhet, aq sa është e mundur, të kryhet nga profesionistë të trajnuar. Duhet të merren masa që fëmijët të japin dëshmi në mjedise të përshtatshme, duke pasur parasysh moshën e tyre, pjekurinë dhe nivelin e të kuptuarit dhe vështirësitë që mund të kenë ata në komunikim. Regjistrimi audio-vizual i dëshmimeve të fëmijëve viktimë ose dëshmitarë duhet të inkurajohet sa më shumë që është e mundur. Sigurisht, kjo nuk do të cenojë të drejtën e palëve të tjera për të kundërshtuar përmbajtjen e dëshmimeve të tilla. Kështu, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në rastin W.S kundër Polonisë sugjeroi se për testimin e besueshmërisë së fëmijës viktimë duhen realizuar disa mënyra sa më të përshtatshme dhe jo nëpërmjet pyetjeve të drejtpërdrejta. Gjykata propozoi se fëmija mund të pyetet nëpërmjet psikologut, të cilit i jepen pyetjet e shkruara më parë nga avokatët e palëve në proces, ose një

⁴ Shih: Guidelines of the Committee of Ministers of the Council of Europe on child-friendly justice adopted by the Committee of Ministers of the Council of Europe on 17 November 2010 and explanatory memorandum.

⁵ UNICEF “Children’s Equitable Access to Justice: Central and Eastern Europe and Central Asia Albania Georgia Kyrgyzstan Montenegro”, 2015.

alternativë tjetër është marrja në pyetje në një studio që mundëson që avokati të jetë i pranishëm nëpërmjet një lidhjeje me video ose përmes një pasqyre që nuk kuptohet nga fëmija.

Në rast se është e nevojshme që ndaj një fëmije viktimë të zhvillohet më shumë se një intervistë, ato duhet të kryhen mundësisht nga i njëjti person, për të siguruar koherencën në mënyrën e intervistimit, në interesin më të mirë të fëmijës. Nga ana tjetër, duhet që numri i intervistave të një fëmije të jetë sa më i kufizuar, po ashtu, dhe kohëzgjatja duhet t'i përshtatet moshës së fëmijës. Kontakti i drejtpërdrejtë, konfrontimi apo ndërveprimi mes fëmijës viktimë ose dëshmitar me të pandehurin duhet të shmanget sa më shumë që është e mundur. Në çështjet penale, fëmijët duhet të kenë mundësinë për të dhënë dëshmi pa praninë e të dyshuarit. GJEDNJ, në rastin S.N kundër Suedisë, vendosi se në çështjet penale që kanë të bëjnë me dhunën seksuale, gjykatat mund të aplikojnë procedura të veçanta, sidomos kur viktima është i mitur. Gjithashtu, po në të njëjtën çështje, gjykata sqaroi se në mënyrë që të shmangen efektet negative të pyetjeve, në proces duhet të ftohen ekspertë psikologë.

Aktiviteti 3:

Debat

- Si ta kuptojmë parimin e interesit më të lartë të të miturit të zbatuar në procesin penal?
- Cilat janë avantazhet e drejtësisë restauruese në raport me parimin e interesit më të lartë të fëmijës?
- Hartoni një listë kontrolli.
- Çfarë vështirësish paraqiten?
- Si është analizuar ky parim në praktikën gjyqësore?

Bëhet ndarja e auditorit në 3-4 grupe në varësi të numrit të pjesëmarrësve, ku në secilin grup janë 4 kandidatë për magistratë. Çdo grup analizon me kujdes temën e debatit dhe përgatit konkluzionet me shkrim.

Grupi zgjedh një prezantues, i cili do të prezantojë përpara auditorit konkluzionin e arritur.

Standardet ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve në përgjithësi dhe për fëmijët / të rinjtë në konflikt me ligjin

Pozita e fëmijëve në kontekstin e drejtësisë për të mituri rregullohet nga dispozitat e përgjithshme mbi të drejtat e njeriut, të cilat zbatohen si për të rriturit ashtu edhe për të miturit. Kuadri ligjor ndërkombëtar, përfshin edhe norma të veçanta, të cilat përcaktojnë dhe nënvizojnë parime të rëndësishme për çështjet e të miturve në kontakt me sistemin e drejtësisë. Këto norma dhe parimet që burojnë prej tyre, janë marrë parasysh në hartimin e KDPM-së.

1. Parimet e drejtësisë miqësore për të miturit

Togfjalëshi “drejtësi miqësore për fëmijët” i referohet atij sistemi drejtësie që garanton respektimin e të gjitha të drejtave të fëmijëve në qasje me sistemin e drejtësisë civile, penale apo administrative. Në kontekstin e drejtësisë penale drejtësia miqësore vendos në qendër fëmijët si viktimë, dëshmitarë apo autorë të veprës penale, duke i kushtuar vëmendjen e duhur nivelit të pjekurisë së fëmijës dhe i përshtatet e përqendrohet në nevojat dhe të drejtat e tij.

I gjithë kuadri i normave që gjenden në instrumentet ndërkombëtare synon të nënvizojë se në rastin e të miturve në konflikt me ligjin, qëllimi kryesor është mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës, integrimi social i tyre, rehabilitimi i fëmijëve në konflikt me ligjin, mbrojtja e të drejtave të fëmijëve dëshmitarë dhe viktimë, parandalimi i viktimizimit të dytë ose riviktimizimit, parandalimi i kryerjes së veprës penale dhe sigurimi i rendit publik gjatë administrimit të drejtësisë.

Fëmijët në procedimet penale kanë të drejtë të trajtohen me drejtësi dhe në një mënyrë miqësore për ta.

Drejtësia miqësore për të miturit përbëhet nga 5 parimet e nënvizuara në udhëzuesin e Këshillit të Evropës mbi “Drejtësinë miqësore për të miturit”:

- **Pjesëmarrja efektive dhe informimi:**

Në proceset që përfshijnë fëmijët ose që kanë të bëjnë me ta, duhet të respektohet e drejta e të gjithë fëmijëve për *t’u informuar* mbi të drejtat e tyre, duhet *t’u jepet akses* i duhur në drejtësi si dhe *të konsultohen e dëgjohen*. Kjo nënkupton që *opinioneve* të fëmijëve t’u jepet rëndësia e duhur, duke marrë në konsideratë *pjekurinë e tyre* dhe *çdo problematikë* që mund të ekzistojë *lidhur me komunikimin*. Fëmijët duhet të vlerësohen dhe të trajtohen si bartës të plotë të të drejtave dhe duhet të gëzojnë të drejtën e ushtrimit të të drejtave të tyre, në atë mënyrë që merr parasysh aftësitë e tyre për të formuar pikëpamjet e tyre dhe rrethanat e çështjes. Procedimet gjyqësore duhet të përshtaten me nevojat e fëmijës dhe të sigurojnë **pjesëmarrjen e tyre efektive**. Standardet ndërkombëtare lidhur me këtë të drejtë, përcaktohen në nenin 47 të Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së, në nenin 6 të KEDNJ-së dhe në Direktivën (BE) 2016/800 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 11 maj 2016 mbi sigurinë procedurale për fëmijët që janë të

dyshuar ose të akuzuar në procedimet penale, e cila përfshin të drejtën e pjesëmarrjes efektive si dhe të drejtën e përfaqësimit ligjor.

- **Interesi më i lartë:**

Interesi më i lartë i fëmijëve duhet të mbizotërojë në të gjitha çështjet që prekin fëmijët. Në vlerësimin e interesit më të lartë të fëmijëve të përfshirë ose të prekur, duhet të merren në konsideratë: a. opinionet dhe mendimet e tyre, të cilave duhet t'u jepet rëndësia e duhur; b. të gjitha të drejtat e tjera të fëmijës, të tilla si e drejta për dinjitet, liri dhe trajtim të barabartë, të cilat duhet të respektohen në çdo kohë; c. një qasje gjithëpërfshirëse duhet të ndiqet nga të gjitha autoritetet shtetërore, në mënyrë që të merren parasysh të gjitha interesat në rrezik, duke përfshirë si mirëqenien psikologjike dhe fizike ashtu dhe interesat juridike, ekonomike dhe sociale të fëmijës. Në rast konkurrimi të interesit më të lartë të dy ose më shumë fëmijëve të përfshirë në të njëjtën procedurë ose rast, ato duhet të vlerësohen veç e veç dhe të balancuara me qëllim për të pajtuar interesat e mundshme kontradiktore të fëmijëve.

- **Dinjiteti:**

Fëmijët duhet të trajtohen me kujdes, ndjeshmëri, ndershmëri dhe respekt në çdo çështje/procedurë, duke pasur në vëmendje rrethanat e tyre personale, mirëqenien dhe nevojat e veçanta, dhe në respekt të plotë për integritetin e tyre fizik dhe psikologjik. Ky trajtim duhet t'u jepet atyre, pavarësisht mënyrës se si ata kanë ardhur në kontakt me procedimet gjyqësore ose jo-gjyqësore apo ndërhyrje të tjera, pa marrë parasysh statusin e tyre ligjor dhe kapacitetet në çdo procedurë apo çështje.

- **Mbrojtja nga diskriminimi:**

Fëmijëve duhet t'u garantohen të drejtat pa diskriminim me bazë gjinie, race, ngjyre ose përkatësie etnike, moshe, gjuhe, feje, opinioni politik ose opinioni tjetër, origjine kombëtare a shoqërore, gjendjeje social-ekonomike, statusi të prindit/prindërve, përkatësie në një minoriteti kombëtar, pasurie, lindjeje, orientimi seksual, identiteti gjinor apo ndonjë statusi tjetër. Grupeve të rrezikuara, si fëmijëve emigrantë, refugjatë dhe azilkërkues, fëmijëve të pashoqëruar, me aftësi të kufizuara, fëmijëve të rrugës, romë dhe fëmijëve në institucionet rezidenciale, duhet t'u jepet mbrojtje e veçantë.

- **Shteti i së drejtës:**

Parimi i shtetit të së drejtës zbatohet plotësisht për fëmijët ashtu sikurse edhe për të rriturit. Elementet e procesit të rregullt ligjor, të tilla si parimet e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit, të prezumimit të pafajësisë, e drejta për një gjykim të drejtë, për këshillim ligjor, e drejta e aksesit në gjykata dhe ankimit, duhet të jenë të garantuara për fëmijët. Këto të drejta nuk duhen minimizuar ose mohuar nën pretekstin e interesit më të lartë të fëmijës. Kjo vlen për të gjitha procedurat gjyqësore, jashtëgjyqësore si dhe ato administrative. Fëmijët duhet të kenë të drejtën e aksesit në mekanizmat e duhura të ankesave, të pavarura dhe efektive.

2. Standardet e OKB-së lidhur me drejtësinë për të mitur

1. Konventa për të Drejtat e Fëmijës [KDF]:

Konventa për të Drejtat e Fëmijës përmban norma të rrepta, zbatimi i të cilave mbikëqyret nga Komiteti mbi të Drejtat e Fëmijës. KDF-ja është një instrument sintetik ku në mënyrë gjithëpërfshirëse përcaktohen parimet kryesore për mbrojtjen e të drejtave të të miturve në tërësi, por edhe standardet bazë për zbatimin e drejtësisë penale për të mitur. Duke qenë ndryshe, pikërisht sepse është një qenie në zhvillim e sipër, fëmija, ka ende kohë e mundësi për t'u rehabilituar, ka nevoja të ndryshme prej të rriturve dhe terapitë që sistemi do të përdorë për "shërimin" e tyre janë dhe duhet të jenë krejt të ndryshme e të veçanta prej atyre të të rriturve. Në këtë rast, prioritet kanë trajtimet ambulatorë dhe jo ato institucionale. Me çdo fëmijë duhet të merremi në mënyrë të individualizuar. Ka një interes të fortë publik për mbrojtjen e veçantë të të miturve, ku interesi parësor dhe mirëqenia e të miturve janë thelbësore.

Në këtë Konventë, me rëndësi të veçantë është neni 40, i cili i referohet drejtpërdrejtë çështjeve të drejtësisë për të mituri.

Neni 40 mbi administrimin e drejtësisë për të mitur përcakton standardet si në vijim:

- *Standardi i trajtimit të veçantë dhe dinjitoz* të çdo fëmije të dyshuar, akuzuar ose të cilësuar se ka kryer shkelje të ligjit penal, me qëllim që të zhvillohen ndjenjat e dinjitetit dhe të vlerës së personit, të respektohen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, duke marrë parasysh moshën e fëmijës, si dhe dëshirën për të nxitur riintegrimin e tij në shoqëri dhe marrjen e një roli konstruktiv në të (neni 40, pika 1 e KDF-së);
- *Standardi i pasojave joprapavepruese.* Asnjë fëmijë nuk mund jetë i dyshuar, i akuzuar ose i cilësuar për shkelje të ligjit penal për arsye të veprimeve ose mosveprimeve që nuk kanë qenë të ndaluara nga e drejta e brendshme ose ndërkombëtare në momentin kur ato janë kryer (neni 40, pika 1 germa "a" e KDF-së dhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 29);
- *Garancitë procedurale* për fëmijët në procesin penal, pra për fëmijët e dyshuar ose të akuzuar për shkelje të ligjit penal sipas nenit 40 të KDF-së përfshijnë:
 - *prezumimi i pafajësisë* derisa të provohet (pa)fajësia ligjërish (në përputhje kjo edhe me nenin 30 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë);
 - *e drejta e informimit* menjëherë dhe drejtpërdrejt për akuzat e ngritura, nëse është e përshtatshme, me anë të prindërve të tij ose të përfaqësuesve ligjorë, dhe të ketë ndihmë juridike ose çdo ndihmë tjetër të duhur për përgatitjen dhe paraqitjen e mbrojtjes së tij (neni 31 i Kushtetutës

së Republikës së Shqipërisë);

– *shqyrtimi pa vonesë* i çështjes nga një autoritet ose organ gjyqësor kompetent, i pavarur dhe i paanshëm, sipas një procedure të drejtë ligjore, në praninë e ndihmës juridike ose të një ndihme tjetër të përshtatshme, dhe, përveç kur gjykohet se kjo nuk është në interesin më të mirë të fëmijës, sidomos për arsye të moshës ose gjendjes së tij, të prindërve ose përfaqësuesve të tij ligjorë,

– *Trajtimi i fëmijëve në përputhje me mirëqenien e tyre* dhe në raport me gjendjen e tyre dhe me shkeljen e ligjit;

– *Fëmija të mos detyrohet të dëshmojë ose të deklarojë veten fajtor;*

– *Të drejtën të pyesë ose të bëjë të pyeten dëshmitarët e akuzës;*

– *E drejta e ankimit;*

– *E drejta për një përkthyes falas;*

– *Shmangia nga procesi gjyqësor dhe procedurat gjyqësore;*

– *Respektimi i jetës private.*

Neni 40, nuk duhet të shikohet në mënyrë të izoluar. Ky nen ka një ndërvarësi me nene të tjera. Të tilla janë nenet që lidhen me parimet e përgjithshme të KDF-së të cilat janë bërë pjesë e KDPM-së, të tilla si:

- neni 2: parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit,
- neni 3, pika 1: parimi i interesit më të lartë të fëmijës,
- neni 6: e drejta e jetës dhe e mbijetesës,
- neni 12: respektimi i pikëpamjeve dhe e drejta e dëgjimit të fëmijës në çdo procedurë gjyqësore ose administrative, që ka të bëjë me të, qoftë drejtpërdrejt, qoftë nëpërmjet një përfaqësuesi ose një organi të përshtatshëm.

Gjithashtu neni 40 ka lidhje me nene të tjera të KDF-së ndër të cilat, kujdes i është kushtuar:

- të drejtës për jetë private, neni 16 i KDF-së;
- mbrojtja nga të gjitha format e dhunës: neni 19 i KDF-së;
- përkujdesja alternative: neni 20 i KDF-së;
- rishikimi periodik i masës/trajtimit: neni 25 i KDF-së;
- ndalimi i dënimit me vdekje dhe burgim të përjetshëm, kufizime në privimin e lirisë etj.: neni 37 i KDF-së;
- rehabilitimi i viktimave: neni 39 i KDF-së.

Neni 37 i KDF-së përmban ndalimin e torturës dhe trajtimit mizor, poshtërues e çnjerëzor. Nuk duhet të ketë *as dënim me vdekje dhe as burgim të përjetshëm për fëmijët; arrestimi, ndalimi ose burgimi i një fëmije* duhet të jetë në përputhje me ligjin dhe *të përdoret vetëm si masë e fundit dhe për një kohë sa më të shkurtër*, çdo fëmijë i privuar nga liria *duhet të trajtohet në mënyrë njerëzore*, duhet të jetë i veçuar nga të rriturit dhe duhet të jetë gjithnjë *në kontakt me familjen e tij*; fëmijët e privuar nga liria kanë të drejtë për *ndihmë juridike* dhe të drejtë për të *kundërshtuar* privimin e lirisë dhe të merret një *vendim i shpejtë* në lidhje me çështjen etj. Dispozitat e mësipërme, por jo vetëm, formësojnë disa prej standardeve themelore lidhur me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, të përfshira në nenet përkatëse të KDPM-së.

2. Instrumente të tjera në kuadrin e OKB-së

- **Pakti ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike** (miratuar në vitin 1966 dhe hyrë në fuqi më 1976-ën, ratifikuar prej vendit tonë).

Sipas këtij dokumenti, të miturit e burgosur duhet të ndahen prej të rriturve dhe çështja duhet të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur (neni 10, pika 2, germa "b"). Procedura që zbatohet për të miturit, të cilët nuk kanë mbushur moshën madhore duhet të marrë parasysh moshën dhe interesin që paraqet riedukimi i tyre (neni 14, pika 4). Fëmija ka të drejtë të mbrohet pa asnjë dallim bazuar në racë, ngjyrë etj. Ai ka të drejtën për të pasur një emër, shtetësi, pa asnjë lloj diskriminimi dhe në rast divorci të prindërve duhet t'i sigurohet mbrojtja e nevojshme (nenet 23 e 24).

- **Konventa kundër torturës dhe vuajtjeve të tjera ose trajtimit mizor, jonjerëzor a degradues** (Ligji nr. 7727, datë 30.6.1993) dhe Protokollin shtesë i Konventës kundër torturës dhe vuajtjeve të tjera ose trajtimit mizor, jonjerëzor a degradues.

- **Rregullat dhe udhëzimet e OKB-së lidhur me drejtësinë për të mitur, standardet e të cilave janë përfshirë në KDPM**

Rregullat standarde minimale të Kombeve të Bashkuara për administrimin e drejtësisë për të mitur (Rregullat e Pekinit, 1985); Rregullat e Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e të rinjve të cilëve u është hequr liria (Rregullat e Havanës, 1990); Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për parandalimin e kriminalitetit të të rinjve (Udhëzimet e Riadit, 1990); Rregullat standarde minimale të Kombeve të Bashkuara për masat alternative të dënimit me burgim (Rregullat e Tokios, 1990); Udhëzimet e Vjenës për veprimin për fëmijët në sistemin e drejtësisë penale dhe mbi administrimin e drejtësisë për të rinjtë.⁶

Në mënyrë të përmbledhur këto instrumente nënvizojnë standardet në vijim:

- Mirëqenien e të miturit, duke siguruar që çdo reagim ndaj të miturve të dënuar të jetë gjithmonë në përputhje me rrethanat e të dënuarit dhe të veprës penale;
- Nxisin riintegrimin e të miturit dhe rifitimim e një roli konstruktiv të tij në shoqëri;
- Zhvillojnë alternativa ndaj trajtimit me burgim ose të kujdesit institucional (edhe në rastet kur çështja është në gjykim e sipër) për të parandaluar kryerjen dhe përsëritjen e krimit, dhe që të dënuarit e mitur të trajtohen sipas të drejtave që gëzojnë;
- Sigurojnë që të miturit të trajtohen në komunitetin e tyre sa më shumë të jetë e mundur. Në rastet kur ata mbahen në paraburgim, të miturit duhet të veçohen nga të rriturit; duhet të ndërmerren të gjitha masat dhe mjetet për të siguruar që ata të mbajnë lidhje me familjet e tyre; duhet të merren të gjitha masat për të përgatitur riintegrimin e tyre dhe që kur ata të rikthehen në komunitetin e tyre t'u sigurohet ndihma dhe përkrahja e duhur;
- Domosdoshmërinë e një stafi të kualifikuar dhe të trajnuar në të gjithë pjesët dhe komponentët e sistemit;
- Nënvizojnë se parandalimi i kriminalitetit të të miturit kërkon përpjekje nga e gjithë shoqëria (familja dhe komuniteti). Mirëqenia e të rinjve, që nga fëmijëria e tyre e hershme, duhet të jetë në vëmendjen e çdo programi parandalimi. Duhet të hartohen programe dhe shërbime të orientuara drejt komunitetit për të parandaluar kriminalitetin të të miturit.

• **Protokolli shtesë i Konventës për të Drejtat e Fëmijës, datë 18 janar 2002 lidhur me shitjen e fëmijëve, prostitucionin e fëmijëve dhe pornografinë e fëmijëve**

• **Deklarata mbi të Drejtat e Fëmijës**

3. Standardet e Këshillit të Evropës

1. Konventa Evropiane e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe GJEDNJ-së

KEDNJ-ja përmban norma ligjore të rrepta të cilat mbikëqyren nga GJEDNJ-ja. KEDNJ-ja garanton gjykimin e drejtë në nenin 6. Ky nen ka gjeneruar një jurisprudencë të gjerë të GJEDNJ-së. Neni 6, pika 1 e KEDNJ-së përfshin shprehimisht disa garanci të gjyimit të drejtë të cilat janë marrë parasysh nga KDPM-ja. Të tilla janë:

- gjykimi i drejtë publik, (me përjashtim të rasteve kur kjo është në kundërshtim, veç të tjerash me interesat e të miturit);
- gjykimi brenda një afati të arsyeshëm;
- gjykimi nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.
- e drejta e menjëhershme e informimit mbi akuzën në një gjuhë të kuptueshme për të (neni 6, pika 3, germa "a" e KEDNJ-së);
- e drejta për të pasur kohë dhe lehtësi për të përgatitur mbrojtjen (neni 6, pika 3, germa "b" e KEDNJ-së);
- e drejta e ndihmës ligjore sipas zgjedhjes së tij (neni 6, pika 3, germa "c" e KEDNJ-së).

Vini re! GJEDNJ-ja e konsideron të drejtën (aksesin) e një avokati si një element thelbësor të procesit të rregullt gjyqësor [GJEDNJ, *Salduz kundër Turqisë GC*, nr. 36391/02, 27 nëntor 2008, parag. 51]. Personat që dyshohen/akuzohen penalisht kanë të drejtën e një avokati që në fazat e hershme të hetimit policor. Kjo e drejtë mund të kufizohet veçse në raste përjashtimore duke siguruar që kufizimi nuk paragjykon në mënyrë të padrejtë të drejtat e të akuzuarit. GJEDNJ-ja ka konstatuar se kjo mund të ndodhë nëse pohimet e bëra pa praninë e avokatit janë përdorur për dënimin [GJEDNJ, *Salduz kundër Turqisë [GC]*, nr. 36391/02, 27 nëntor 2008, parag. 62]. Jurisprudenca e GJEDNJ-së është shumë strikte lidhur me efektivitetin e pranisë së avokatit në rastin kur një fëmijë është i përfshirë në çështje.

- e drejta të marrë në pyetje ose të kërkojë marrjen në pyetje të dëshmitarëve (neni 6, pika 3, germa "d" e KEDNJ-së);
- e drejta për të pasur ndihmën e një përkthyesi falas (neni 6, pika 3, germa "e" e KEDNJ-së).

Brenda koncepteve të gjyimit të drejtë, GJEDNJ-ja ka zhvilluar garanci të cilat zbatohen si për të rriturit ashtu edhe për të miturit, të tilla si: barazia e mjeteve dhe procesi kontradiktor; e drejta për të mos folur; aksesin në një avokat; pjesëmarrja efektive; prezenca në gjykim dhe vendimi i arsyetuar. Gjithashtu, me rëndësi është edhe parimi i prezumimit të pafajësisë deri sa kjo të provohet sipas ligjit (neni 6, pika 2 e KEDNJ-së).

Detyrë në grup:

Analizoni vendimet e GJEDNJ-së dhe evidentoni se çfarë duhet të jetë në vëmendje të magistratëve sa i përket rasteve me të mitur:

- *T kundër Mbretërisë së Bashkuar [GC], nr. 24724/94, 1999.*
- *Panovits kundër Qipros, nr. 4268/04, 2008.*
- *Nortier kundër Holandës, nr. 13924/88, 24 gusht 1993.*
- *Adamkiewicz kundër Polonisë, nr. 54729/00, 2 mars 2010.*

2. Standardet e drejtësisë miqësore

Çfarë është dhe si zbatohet “drejtësia miqësore për fëmijët”? Cilat janë alternativat e dënimit për fëmijët në konflikt me ligjin dhe si përdoret shmangia? Si qëndron situata e riintegrit të tyre përmes edukimit, trajnimit dhe punësimit?

Drejtësia miqësore për fëmijët nënkupton garantimin e respektimit dhe efektivitetin e zbatimit të të gjitha të drejtave të fëmijëve, në nivelin më të lartë të arritshëm, në sistemin e drejtësisë së një vendi. Për këtë, në veçanti, kërkohet që drejtësia të jetë:

- e aksesueshme,
- e përshtatur sipas moshave,
- e shpejtë,
- e fokusuar në nevojat dhe të drejtat e fëmijëve.

Drejtësia miqësore për fëmijët përfshin të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të drejtën për pjesëmarrje dhe për të kuptuar procedurat, të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare, si dhe të integritetit dhe dinjitetit.

Drejtësia miqësore për fëmijët ka në thelb të saj, garantimin e respektimit dhe efektivitetin e zbatimit të të gjitha të drejtave të fëmijëve, në nivelin më të lartë të mundshëm. Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur parashikon norma specifike procedurale për organet përgjegjëse gjatë procedurës së administrimit të drejtësisë; norma specifike procedurale që duhet të respektohen në procedimet penale që ndikojnë te fëmijët, si dhe rregulla të posaçme për ekzekutimin e vendimeve dhe masave të tjera.

KDPM-ja garanton që sistemi penal në Shqipëri të shikohet në mënyrë integrale dhe shumëdisiplinore. Shërbimet sociale, arsimore, policia e shtetit, shërbimi i provës e prokuroria duhet të bashkëpunojnë jo vetëm

në parandalimin, por edhe në përcaktimin e masave restauruese më të përshtatshme për fëmijët në konflikt me ligjin dhe sidomos për rehabilitimin e tyre.

KDPM-ja parashikon parimet e përgjithshme të drejtësisë për fëmijë si: heqja e lirisë si alternativa e fundit e dënimit; e drejta e pjesëmarrjes së fëmijës; afati i përfundimit të procedurës; e drejta e jetës private; të drejtat procedurale etj. Në vijim, kuptimi dhe pozita e palës në procedurën e drejtësisë për fëmijët; kualifikimi, gjykimi i çështjeve, specializimi; fëmijët viktime dhe dëshmitarë; masat për mbrojtjen e fëmijëve dëshmitarë, janë çështje që rregullohen gjithashtu nga KDPM-ja. KDPM-ja parashikon rregulla të përgjithshme procedurale për drejtësinë për fëmijë dhe jep kuptimin e termit “fëmijë” për qëllimet e këtij ligji.

Ky ligj për herë të parë, jep kuptimin e drejtë të përjashtimit nga përgjegjësia penale dhe procedurat paragjyqësore përmes institutit të shmangies etj.

4. Standardet e Bashkimit Evropian

1. Karta e të Drejtave Themelore të BE-së⁷

Karta e të Drejtave Themelore të BE-së⁸ rregullon të drejtat bazë të aksesit në drejtësi duke theksuar garancitë e procesit të rregullt. Kështu, *neni 47* i saj ka të bëjë me mjetet efektive dhe procesin e rregullt duke përcaktuar kërkesa të veçanta për fëmijët, të tilla si afati i arsyeshëm i një gjykimi të drejtë dhe publik dhe e drejta e mbrojtjes, përfaqësimit dhe këshillimit si edhe ndihma ligjore. *Neni 48* ka të bëjë me prezumimin e pafajësisë dhe të drejtën e mbrojtjes. Në mënyrë të ngjashme, parimet e legjitimitetit dhe proporcionalitetit të veprave penale me dënimet, të vendosura në *nenin 49*, kanë rëndësi të veçantë për fëmijët. Në mënyrë të veçantë *Karta e të Drejtave Themelore të BE-së* përmban norma që i kushtohen parimeve të të drejtave të fëmijëve, të tilla si ato të përfshira kryesisht, por jo vetëm, në *nenin 24* të saj. Ky nen nënvizon si parime themelore lidhur me të drejtat e fëmijëve:

- të drejtën për të shprehur lirisht pikëpamjet e tyre në përputhje me moshën dhe pjekurinë, *neni 24*, pika 1;
- të drejtën që në çdo vendimmarrje lidhur me fëmijët, interesi më i lartë i fëmijës të jetë në qendër të vëmendjes, *neni 24*, pika 2;
- të drejtën e fëmijës që të ketë një marrëdhënie personale sistematike dhe kontakt të drejtpërdrejtë me të dy prindërit, përveçse kur kjo bie ndesh me interesat e tij ose të saj, *neni 24*, pika 3.

2. Traktati i Bashkimit Evropian dhe Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian

Pas ndryshimeve të bëra nga Traktati i Lisbonës, i cili ka hyrë në fuqi më 1 dhjetor 2009⁹, vihen re përmirësime të rëndësishme, të cilat kanë rritur potencialin e BE-së për të zhvilluar më tej të drejtat e fëmijëve, duke identifikuar “mbrojtjen e të drejtave të fëmijës” dhe nxitjen e kësaj mbrojtjeje, si një objektiv të përgjithshëm të deklaruar të BE-së (*neni 3*, pika 3 e TBE-së), dhe si një aspekt të rëndësishëm të politikës së jashtme të BE-së (*neni 3*, pika 5 të TBE-së). Referencat më specifike për fëmijët janë të përfshira në kuadër të TFBE-së, duke bërë të mundur që BE-ja të miratojë masa legjislative që synojnë luftën kundër shfrytëzimit seksual dhe trafikimit të qenieve njerëzore (*neni 79*, pika 2, germa “d” dhe *neni 83*, pika 1).

⁷ EU (2012), Charter of Fundamental Rights of the European Union, OJ 2012 C 326.

⁸ Në linkun (https://www.mei-ks.net/repository/docs/Traktati_i_Lisbonës_-_Verzioni_i_Konsoliduar.pdf) do të gjeni në versionin shqip versionet e konsoliduara të Traktatit të Bashkimit Evropian dhe të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, së bashku me shtojcat dhe protokollet respektive, pas shtesave dhe ndryshimeve që u janë bërë atyre nga Traktati i Lisbonës, i cili u nënshkrua më 13 dhjetor 2007 në Lisbonë dhe hyri në fuqi më 1 dhjetor 2009.

⁹ EU (2007), Treaty of Lisbon amending the Treaty on European Union and the Treaty establishing the European Community, signed at Lisbon, OJ 2007 C 306, pp. 1–271.

3. Direktiva me rëndësi të BE-së

Direktiva të ndryshme të BE-së theksojnë garancitë lidhur me gjykimin e drejtë në procesin penal. Me rëndësi janë:

- **Direktiva 2012/29/BE** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 25 tetor 2012 që përcakton standardet minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit, e cila në mënyrë të ngjashme i kushton shumë prej dispozitave të saj të drejtave të fëmijëve;
- **Direktiva 2011/93/BE** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 dhjetor 2011 për luftën kundër abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë me fëmijë;
- **Direktiva 2011/36/BE** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 5 prill 2011 për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij, ku trajtohen nevojat specifike të fëmijëve viktimë.;
- **Direktiva 2010/64/BE** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 tetor 2010 mbi të drejtën e përkthimit me shkrim dhe me gojë në procedimet penale;
- **Direktiva 2012/13/BE** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 22 maj 2012 mbi të drejtën e informimit në procedimet penale;
- **Direktiva 2013/48/BE** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 22 tetor 2013, e cila ka hyrë në fuqi më 27 nëntor 2016, mbi të drejtën e aksesit në një avokat në procedimet penale dhe në procedimet e Urdhrit Evropian të Arrestit dhe mbi të drejtën për të informuar palët e treta gjatë privimit të lirisë dhe për të komunikuar me palët e treta dhe me autoritetet konsullore gjatë privimit të lirisë, OJ L 294, 6.11.2013, fq. 1–12. Kjo Direktivë i referohet në mënyrë të drejtpërdrejtë të drejtave të fëmijëve përkatësisht në pikat nr. 52 dhe 55 të preambulës së saj, si edhe në nenin 5, përkatësisht pikat 2 dhe 4 të tij. Sipas pikës 55 të preambulës¹⁰ dhe nenit 5, pika 2¹¹ të Direktivës, nëse një fëmijë është i privuar nga liria, ushtruesi i përgjegjesisë prindërore

¹⁰ Pika 55 e preambulës: 'Kjo Direktivë promovon të drejtat e fëmijëve dhe merr parasysh Udhëzimet e Këshillit të Evropës mbi drejtësinë miqësore ndaj fëmijëve, veçanërisht dispozitat e këtij udhëzimi mbi informacionin dhe këshillat që duhet t'u jepen fëmijëve. Kjo Direktivë siguron që personave të dyshuar dhe të akuzuar, përfshirë fëmijët, t'u sigurohet informacioni i duhur për të kuptuar pasojat e heqjes dorë nga një e drejtë sipas kësaj Direktive dhe që çdo heqje dorë bëhet vullnetarisht dhe pa mëdyshje. Nëse personi i dyshuar ose i akuzuar është një fëmijë, mbajtësi i përgjegjesisë prindërore duhet të njoftohet sa më shpejt që të jetë e mundur pas heqjes së lirisë së fëmijës dhe duhet t'i jepen arsyet për këtë. Nëse dhënia e një informacioni të tillë mbajtësit të përgjegjesisë prindërore është në kundërshtim me interesin më të mirë të fëmijës, në vend të kësaj duhet të informohet një i rritur tjetër i përshtatshëm, siç është një i afërm. Kjo duhet të jetë pa paragjykuar dispozitat e legjislacionit kombëtar që kërkon që çdo autoritet, institucion ose person i specifikuar, veçanërisht ata që janë përgjegjës për mbrojtjen ose mirëqenien e fëmijëve, duhet të informohen për heqjen e lirisë së një fëmije. Shtetet Anëtare duhet të përmbahen nga kufizimi ose shtyrja e ushtrimit të së drejtës për të komunikuar me një palë të tretë në lidhje me të dyshuarit ose personat e akuzuar që janë fëmijë dhe që janë të privuar nga liria, përveç në rrethanat më të jashtëzakonshme. Kur zbatohet një shtyrje, fëmija nuk duhet të mbahet pa u njoftuar dhe duhet të lejohet të komunikojë, për shembull me një institucion ose një individ përgjegjës për mbrojtjen ose mirëqenien e fëmijëve'.

¹¹ Neni 5, pika 2: "Nëse personi i dyshuar ose i akuzuar është një fëmijë, Shtetet Anëtare sigurojnë që mbajtësi i përgjegjesisë prindërore të fëmijës të informohet sa më shpejt që të jetë e mundur për heqjen e lirisë dhe për arsyet lidhur me të përveç nëse do të ishte në kundërshtim me interesat më të mira të fëmijës, në këtë rast do të informohet një i rritur tjetër i përshtatshëm. Për qëllimet e këtij paragrafi, një person nën moshën 18 vjeç do të konsiderohet fëmijë'.

duhet të njoftohet dhe t'i shpjegohen arsyet e këtij privimi të lirisë, me përjashtim të rastit kur kjo është në kundërshtim me interesin më të lartë të fëmijës. Në këtë rast duhet të informohet një tjetër i rritur i përshtatshëm¹². Sipas nenit 2, Direktiva zbatohet që nga çasti kur i dyshuari ose i akuzuari vihen në dijeni të dyshimit ose të akuzës për kryerjen e veprës penale e deri në përfundimin e procesit përmes dhënies së një vendimi fajësie ose pafajësie. Për më tepër, neni 3, pika 3 nënvizon se e drejta e një avokati (aksesi në një avokat) përfshin të drejtën e të dyshuarit/akuzuarit që të takohet dhe komunikojë privatisht me avokatin, duke përfshirë realizimin e së drejtës, përpara marrjes në pyetje për herë të parë, prezencën dhe pjesëmarrjen efektive të avokatit gjatë marrjes në pyetje dhe prezencën e avokatit gjatë gjithë hetimit ose mbledhjes/marrjes së provave. Kjo Direktivë, në paragrafin 52 të preambulës nënvizon se mbështet të drejtat dhe parimet themelore të njohura nga Karta e të Drejtave Themelore të BE, duke përfshirë ndalimin e torturës dhe trajtimit çnjerëzor dhe degradues, të drejtën për liri dhe siguri, respektimin e jetës private dhe familjare, të drejtën për integritetin e personit, të drejtat e fëmijëve, integritimin personave me aftësi të kufizuara, të drejtë për një zgjidhje efektive dhe e drejta për një gjykim të drejtë, prezumimi i pafajësisë dhe të drejtat e mbrojtjes. Kjo Direktivë duhet të zbatohet në përputhje me këto të drejta dhe parime.

– **Në kuadrin e BE-së**, një vendim me rëndësi është vendimi **C-105/03** i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë. Në këtë çështje të datës 16 qershor 2005 që lidhet me procedimin penal ndaj Maria Pupino, një mësues italian (shih paragrafin 53 të vendimit) u ndoq penalisht për keqtrajtim të një nxënësi të shkollës ku jepte mësim. Sipas Kodit italian të Procedurës Penale, dëshmitarët duhet, si rregull, të dëshmojnë në gjykatë gjatë gjykimit. Sidoqoftë, në rrethana të caktuara, provat e tyre mund të merren para një gjykatësi përpara gjykimit përmes një procedure të veçantë (*incidente probatorio*). Në këtë rast, prokurori publik i kërkoi gjykatës kombëtare që të pranojë dëshmitë e fëmijëve të dhëna paraprakisht si provë, por gjykata kombëtare nuk e pranoi këtë. Për herë të parë, GJED-ja dha interpretimin e saj për disa prej dispozitave që kanë rëndësi në lidhje me fëmijët viktimë dhe dëshmitarë në procedimet penale. GJED-ja nënvizoi se Vendimi Kuadër 2001/220 / JHA kërkonte që Shtetet Anëtare të siguronin mbrojtjen specifike të viktimave vulnerabël, që do të thotë se gjykata kombëtare duhet të jetë në gjendje të autorizojë viktimat vulnerabël për të dëshmuar në një mënyrë që garanton mbrojtjen e tyre, për shembull jashtë gjykimit dhe para se të zhvillohet gjykimi. GJED-ja deklaroi: "Sidoqoftë, pavarësisht se moshë e mitur e viktimës është si rregull i përgjithshëm i mjaftueshëm për ta klasifikuar një viktimë si veçanërisht vulnerabël brenda kuptimit të Vendimit Kuadër, nuk mund të mohohet se nëse, si në këtë rast, fëmijët e vegjël pretendojnë se janë keqtrajtuar dhe për më tepër keqtrajtuar nga një mësues, këta fëmijë janë të përshtatshëm për një klasifikim të tillë, duke pasur parasysh veçanërisht moshën e tyre dhe natyrën dhe pasojat e veprave penale të cilave ata e konsiderojnë veten viktimë "(paragrafi 53 i vendimit). Për më tepër, GJED-ja vendosi që të gjitha masat në lidhje me mbrojtjen dhe parandalimin e viktimizimit dytësor duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të pandehurit t'i jepet një gjykim i drejtë (paragrafi 59 i vendimit).

¹² Sipas neni 5, pika 4: "Kur Shtetet Anëtare përkohësisht heqin dorë nga zbatimi i të drejtës së përcaktuar në paragrafin 2 (shih shënimin më sipër), ata do të sigurojnë që një autoritet përgjegjës për mbrojtjen ose mirëqenien e fëmijëve të informohet pa vonesa të paarsyeshme për heqjen e lirisë së fëmijës".



MODULI 1

Kuadri ligjor për fëmijët / të rinjtë në konflikt me ligjin

Përgatiti:

Prof. dr. Arta MANDRO



Çfarë kuptoni me 'Drejtësi miqësore për të miturit'?
Ku gjenden dhe cilat janë standardet ndërkombëtare mbi Drejtësinë për të Miturit?

Cilat janë zhvillimet në legjislacionin shqiptar dhe ato në praktikën gjyqësore?

Vendosja e fëmijës në qendër të vëmendjes:

- Të ndërtohet një sistem që vendos në qendër të tij fëmijën. Fëmija nuk mund të injorohet. Çdo fëmijë gëzon gjithë “paketën e të drejtave” të njohura ndërkombëtarisht. Sistemi, cilado pjesë e tij, nëse ka të bëjë me fëmijët, duhet të jetë i përqendruar te fëmija. Për sistemin, fëmija është subjekt i të drejtave dhe lirive themelore. Autoritetet kompetente duhet të sigurojnë që të gjitha veprimet në lidhje me fëmijën të udhëhiqen nga interesi më i lartë i fëmijës.

Specializimi i posaçëm i personave/autoriteteve të përfshira në drejtësinë për të miturit

- Kjo do të mundësojë që sistemi i drejtësisë penale ta trajtojë fëmijën në përshtatje me moshën dhe nivelin e pjekurisë. Çdo pjesë e këtij sistemi duhet të zhvillohet dhe skicohet për të arritur këtë qëllim. Duke thënë “çdo pjesë” nënkuptojmë se ka hallka të shumëfishta e të ndërlydhura ku efektet e njërës dhe defektet e saj pasohen te tjetra. Sistemi dhe aktorët e tij duhet të kenë formimin e duhur profesional. Kjo përjasje nuk duhet të jetë e copëzuar, por të ofrohet duke e parë sistemin e drejtësisë për të miturit si “një i tërë”, duke marrë në konsideratë rolin e veçantë të çdo hallke.

Vini re!

- Ka *tri çështje kyçe* me rëndësi për t'u mbajtur në vëmendje nga autoritetet në rastet me të mitur, të cilat janë:
 - Parandallo;
 - Shmang nga sistemi formal i drejtësisë;
 - Mbro!

Të bëhen të gjitha përpjekjet për të parandaluar përfshirjen e të miturit në veprimtari delinkuente:

- Duke parandaluar bëhet e mundur që të miturit të mos e shkelin ligjin dhe të mos vijnë në kontakt me sistemin formal të drejtësisë penale. Nuk ka asnjë dyshim se është më mirë të parandalosh!

Të nxitet shmangia dhe drejtësia restauruese:

- Kështu synohet që të miturit të kenë mundësi, në të gjitha fazat e mundshme të procesit, të largohen nga sistemi formal i drejtësisë dhe t'iu drejtohen proceseve të bazuara në komunitet dhe në restaurimin e tyre. Kjo mënyrë veprimi përqendrohet në mënyrë efektive në shkaqet e sjelljeve të tyre duke i riparuar ato.

Të mbahet në vëmendje mbrojtja e fëmijëve:

- Nëse një fëmijë është në konflikt me ligjin, atij t'i garantohen të gjitha të drejtat e njeriut dhe të drejtat si i mitur, duke u përqendruar në zhvillimin e tyre me qëllim që të eliminohet viktimizimi dhe riviktimizimi i tyre dhe viktimizimi dytësor dhe të promovohet rehabilitimi i tyre.

Si do të trajtohen këto raste nga sistemi i drejtësisë? Ç'bëhet me këta të mitur?

- **Rasti 1.** Një grup djemsh 12-13-vjeçarë, teksa lozin me njëri-tjetrin shohin se në kopshtin e shtëpisë pranë fushës së tyre, frutat janë pjekur. Ata janë të lodhur e të djersitur. Shkojnë fshehurazi të marrin frutat, por i dëgjon i zoti i shtëpisë i cili nxiton që t'i ndalojë. I frikësuar, njëri prej tyre e godet të zotin e shtëpisë me një dërrasë të fortë në kokë dhe ky rrëzohet përdhe pa ndjenja. Ai del nga gjendja e rëndë pas dy ditësh në spital. Policia ka identifikuar grupin e të miturve “grabitës”.
- **Rasti 2.** A.F, 17 vjeç, vjen nga një familje me vështirësi ekonomike. Teksa udhëtonte me autobus, i zë syri çantën e hapur të një të moshuare dhe telefonin e saj celular që është lehtësisht i përvetësueshëm. Pas disa hezitimesh, ai vendos ta marrë celularin. E moshuara e ndien dhe lajmëron faturinon, i cili ndalon autobusin dhe i drejtohet policit të parë që gjen për të gjetur shkaktarin. Telefoni gjendet në xhepin e të riut.

Si do të trajtohen këto raste nga sistemi i drejtësisë? Ç'bëhet me këta të mitur? Diskutim interaktiv

- **Rasti 3.** Teksa kthehen nga një festë, një grup të rinjsh 16-18-vjeçarë, pothuaj të dehur shohin një vajzë të re që nxiton në errësirë. Ata e ngacmojnë dhe e trembin. Vajza përpiqet që të largohet, por kjo i shtyn ata ta ngacmojnë edhe më shumë. Ata e marrin vajzën me forcë dhe e detyrojnë që të kryejë marrëdhënie seksuale me ta. Patrulla e policisë e gjen vajzën në gjendje të tmerrshme. Ajo mban fort në dorën e saj një zinxhir të shkëputur nga qafa e njërit prej dhunuesve në të cilin është gdhendur emri i tij.
- **Rasti 4.** I mituri A.Z akuzohet se ka kryer veprën penale të vjedhjes në bashkëpunim. Ai është kapur “në flagrancë” duke vjedhur në një dyqan çokollata, biskota, sende të tjera ushqimore, cigare etj.

Fëmija është një qenie në zhvillim

Ka një interes të fortë publik për mbrojtjen e veçantë të të miturve. Interesi parësor dhe mirëqenia e të miturve janë thelbësore.

E ardhmja e një vendi, standardi social i tij varet nga ndërgjegjësimi mbi “të mirën”, por edhe “të keqen”, varen nga edukimi, riintegrimi, mbrojtja, arsimimi, trajtimi etj., i të miturve sot.

Fëmijët nuk janë thjesht një grupmoshë. Me çdo fëmijë duhet të merresh në mënyrë të individualizuar.

Dënimet ndaj të miturve ose masat alternative kërkohet të jenë me tendencë të fortë pedagogjike.

Në funksion të drejtësisë miqësore për të mitur, KDPM-ja ka zbehur karakterin shpagues e ndëshkues duke bërë mbizotëruese qasjen rehabilituese.

Aktiviteti 1:

- **Ndahemi në dy grupe dhe ndjekim dy ilustrime të ndryshme, të cilat më pas i komentojmë.**
- **Ilustrimi 1:** Për të kuptuar më mirë fantazinë e fëmijëve dhe nëse dalloni një gënjeshtër ose jo të tyre ndiqni këtë video ilustruese marrë nga Ted Talks: “A mundet që ju të kuptoni nëse një fëmijë po gënjen (Can you really tell if a kid is lying?) Çfarë rëndësie ka kjo në çështjet me të mitur?”
- **https://www.ted.com/talks/kang_lee_can_you_really_tell_if_a_kid_is_lying/footnotes?referrer=playlist-5_talks_on_the_truth_about_lyi#t-5141**

Aktiviteti 1:

- **Ilustrimi 2:** Përse fëmijët janë të gatshëm të pranojnë një krim që nuk e kanë bërë vetë? Ndiqni këtë video ilustruese shkëputur nga Ted Talks e gjeni në:
https://www.ted.com/talks/lindsay_mallory_why_teens_confess_to_crimes_they_didn_t_commit/transcript?language=en

Kujdes!

- Fëmijët janë më të gatshëm të pranojnë një faj që nuk e kanë kryer vetë! Kulturalisht fëmijët i edukojnë të thonë “Po!”.
- Komentoni një situatë kur fëmija kundërshton prindin e vet.
- A e keni vënë re se prindi nuk e toleron që fëmija ta kundërshtojë apo të pranojë kundërshtimin?

Diskutim: a keni pranuar kur ishit të mitur gjëra që nuk i keni bërë? Përse? Sillni raste nga praktika e vendimeve penale

- A ka kohë në dispozicion sistemi që të rehabilitojë një fëmijë rebel e të zemëruar që shkel ligjin penal?
- A punojmë dot me të?

Aktiviteti 2:

- **Pjesa e parë**
- Ku mund ta gjeni një përmbledhje të përditësuar të bazës ligjore për të miturit në konflikt me ligjin? Pse ka rëndësi për rolin tuaj si gjyqtarë e prokurorë ky përditësim?
- A ka platforma në kuadrin e Këshillit të Evropës me të cilat mund të konsultoheni dhe përditësoheni me zhvillimet?

Aktiviteti 2:

- *Pjesa e dytë*
- **Debat me temë: Si ta kuptojmë drejtësinë miqësore për të miturit në fushën e drejtësisë penale?**
- Bëhet ndarja e auditorit në 3 – 4 grupe në varësi të numrit të pjesëmarrësve, ku në secilin grup janë 4 kandidatë për magistratë. Çdo grup analizon me kujdes temën e debatit dhe përgatit konkluzionet me shkrim.
- Grupi zgjedh një prezantues, i cili do të prezantojë përpara auditorit konkluzionin e arritur.

“Drejtësia për të mitur”

- ... është një çështje me rëndësi që bazohet në dispozita që gjenden si në legjislacionin kombëtar, ashtu dhe në normat e standardet ndërkombëtare.
- Janë dispozitat materiale dhe procedurale që zbatohen hap pas hapi nga mekanizma/institucione, duke vendosur në qendër të vëmendjes të miturin.
- Këto norma janë specifike për të miturit në konflikt me ligjin penal.

- Sipas Konventës së OKB-së “Për të drejtat e fëmijës” (KDF): “Shtetet palë i njohin çdo fëmije të dyshuar, të akuzuar ose të cilësuar se ka kryer shkelje të ligjit penal, të drejtën e një trajtimi në pajtueshmëri me zhvillimin e ndjenjës së dinjitetit dhe vlerës së fëmijës, që përforcon tek ai respektin për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve dhe që merr parasysh moshën e fëmijës, si dhe dëshirën për të nxitur riintegrimin e tij në shoqëri dhe marrjen e një roli konstruktiv në të”. (Neni 40, pika 1 e KDF-së).
- Thënë në një mënyrë kaq sintetike, këto parime e qëllime janë në fokusin e drejtësisë restauruese dhe arrihen më shpejt përmes saj.

KDPM dhe gjithë kuadri ligjor me fokus të miturit = Sistem normash ku fëmijët trajtohen si fëmijë

- Ligjet që kërkojnë një ndjekje ‘automatike’ të fëmijëve në gjykatë, pra, njësoj si të rriturit, nuk janë thjesht dhe vetëm **mjete jo precize projektuar** për të penguar kuptimin e delinkuencës minorile;
- këto janë kryesisht mjete **të paefektshme** sepse nuk njohin dallimet natyrore të zhvillimit të fëmijëve.

Pse?

- Pse KDPM?
 - Kishte shumë vështirësi për të kuptuar se si funksionojnë çështjet e drejtësisë për të mitur në një sistem ligjor që është projektuar nga të rriturit dhe më së shumti [historikisht] zbatohet për të rriturit.
- Pse?
 - Fëmijët janë të gatshëm të pranojnë krime të cilët ata nuk i kanë kryer? Praktika, përfshi edhe ajo ndërkombëtare, ka treguar se fëmijët e bëjnë këtë. Fëmijët janë ndryshe!
- Kërkojen njohuri të posaçme të lidhura me zhvillimin e të miturit për të dhënë drejtësi për ta. Komunikimi nuk është i lehtë.
 - Konsiderohet sugjestionues ky komunikim i autoriteti me të miturin:
 - Tregohu i sinqertë.
 - Ju thashë se kjo është e vetmja gjë që do t'ju ndihmojë në këtë rast.
 - Ne tashmë e dimë se çfarë ka ndodhur, OK?

Aktiviteti 3:

- **Debat:**
- Si ta kuptojmë parimin e interesit më të lartë të të miturit të zbatuar në procesin penal?
 - - Hartoni një listë kontrolli.
 - - Çfarë vështirësish paraqiten?
 - - Si gjendet i analizuar ky parim në praktikën gjyqësore?
- Bëhet ndarja e auditorit në 3 – 4 grupe në varësi të numrit të pjesëmarrësve, ku në secilin grup janë 4 kandidatë për magistratë. Çdo grup analizon me kujdes temën e debatit dhe përgatit konkluzionet me shkrim.
- Grupi zgjedh një prezantues që do të prezantojë përpara auditorit konkluzionin e arritur.

Vini re!

- Ka disa parime thelbësore në sistemin e drejtësisë për të mitur. Këto parime nevojitet të jenë në vëmendje të kandidatëve për magistratë, por edhe të të gjithë autoriteteve të këtij sistemi. Ato përfshijnë:

Parimet themelore që duhet të mbahen parasysh nga çdo autoritet që përfshihet në administrimin e drejtësisë për të mitur

- *Garantimin e një procesi të drejtë/ të rregullt gjyqësor*
- *E drejta e fëmijëve për të pasur akses në një avokat*
- *Privimi nga liria si mundësia e fundit dhe për një kohë sa më të shkurtër.*
- *Procedurat, mjedisi dhe komunikimi me fëmijët të jetë miqësor.*

- *Kujdes dhe vëmendje ndaj rasteve të përdorimit të paraburgimit si masë sigurimi. KDPM-ja ka në vëmendje politikat dhe masat lidhur me minimizimin e kohës së qëndrimit në paraburgim.*
- *Nxitja e përdorimit të dënimeve alternative për të miturit:*
 - = *Dënimet për fëmijët dhe për veprat penale kundër fëmijëve.*
 - = *Ndërmarrja e politikave për uljen e recidivizmit.*

Trajtimi njerëzor i fëmijëve:

- *Sa fëmijë janë në kontakt me drejtësinë penale? Cili është trajtimi i tyre nga ky sistem? A janë këto procese stresuese dhe shkaktare të traumës të fëmijët?*
- *Konventa për të Drejtat e Fëmijës ndalon qartë torturën, dënimin me vdekje dhe burgimin e përjetshëm pa mundësinë e lirimit, për të gjithë personat nën 18 vjeç. Në të kufizohet përdorimi i privimit të lirisë duke u konsideruar “si masë e fundit - kur të gjitha zgjidhjet e tjera alternative nuk duken të mundshme ose të përshtatshme”. Në rastet kur kërkohet heqja e lirisë, kjo duhet të jepet vetëm për periudhën më të shkurtër të mundshme. Për më shumë, kandidatët shohin tekstin e KDF-së në tërësi dhe veçanërisht nenin 37 të saj.*

A e dini se Amigdala është përgjegjëse për ndjenjën e frikës dhe zemërimit

Ku gjendet? Çarë funksionesh ka?

Amigdala menaxhon ndjenjën e frikës dhe agresionit. Ajo luan rol jetik në përpunimin e informacionit dhe koordinimin e sjelljes emocionale në përgjigje të stimulit shqisor. Për më tepër, ajo është integrale e stimujve emocionalë që lidhen me frikën. Roli i saj në nxitjen e reagimit të luftës ose fluturimit dhe kushtëzimit të frikës është studiuar gjerësisht.

Funksionet e Amigdalës

- Amigdala luan një rol jetësor në koordinimin e përgjigjeve tona (sjelljes, autonomisë dhe endokrinës) ndaj stimujve mjedisorë.
- Ajo luan një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në përgjigjet e sjelljes/reflekseve që janë qendrore për mbijetesën gjatë stresit.
- Ajo gjithashtu është e dobishëm në kushtëzimin e frikës, si dhe reagimin ndaj luftës ose fluturimit.
- Gjatë reagimit të luftës dhe fluturimit, impulset nga bërthama qendrore e amigdalës dërgohen te grupi qendror për të stimuluar një refleks për të ndaluar aktivitetin e rrezikshëm.
- Impulset e dërguara prej saj ndihmojnë në ngritjen e presionit të gjakut dhe rrahjeve të zemrës, në mënyrë që të përgatisin trupin për një përgjigje të shpejtë. Impulset dërgohen në nervat e fytyrës, të cilat gjenerojnë shprehje të fytyrës që pasqyrojnë zemërimin, frikën etj.

Pse na duhet ky informacion?

A e synon këtë ndryshim KDPM-ja

- Amyddala si ta ndryshojmë atë?
- **Ndiqni zhvillimin e neuroshkencës mbi mundësitë e drejtësusë restauruse**
- https://www.ted.com/talks/daniel_reis_el_the_neuroscience_of_restorative_justice#t-255096

KDPM: “Ec ‘krah për krah’ me të miturin

- “Një sistem miqësor i drejtësisë për të miturit nuk duhet të “ecë” me hap më të shpejtë se fëmija. Drejtësia nuk duhet ta lërë fëmijën mbrapa”.
- Një sistem i drejtësisë miqësore për fëmijët nuk duhet të “ecë” më ngadalë se fëmija dhe t’i lërë ata mbrapa. Pra, nuk mund të jetë drejtësi nëse parashikon vendime që nuk përputhen me nevojat e tyre tani.
- Është sistem i drejtësisë miqësore për fëmijët ai që ecën krah për krah fëmijëve duke ofruar ndihmë nga profesionistë kompetentë.

Roli i profesionistëve të sistemit të drejtësisë në rastet me të mitur në konflikt me ligjin

- Për çështjet ku përfshihen interesat e të miturve, profesionistët duhet të kenë kualifikimin dhe specializimin e duhur në këto fusha.
- Në këto situata, profesionistët: avokatët, gjyqtarët, policët, punonjësit socialë, psikologët etj., duhet të respektojnë dhe mbrojnë të drejtat e fëmijës dhe të japin drejtësi.
- Për ta bërë këtë, duhet t'u kushtohet vëmendje nevojave specifike të fëmijëve për të siguruar që pikëpamjet e tyre të merren parasysh sa më mirë.

Parimet e Drejtësisë Miqësore - a janë realitet?

- Çfarë kërkohet që të jenë realitet?
 - Garantimin e njohjes, respektit dhe efektivitetin e zbatimit të të gjithë të drejtave të fëmijëve, në nivelin më të lartë të arritshëm.
 - Garantimin e njohurive dhe të zbatimit të parimeve të aksesit në drejtësi, pra fëmija duhet të dijë se çfarë është aksesit në drejtësi, cilat janë të drejtat e tij sipas grupmoshës, por edhe përgjegjësitë.
 - Garantimin e një procesi të rregullt ligjor, të drejtën për pjesëmarrje dhe për të kuptuar procedurat, të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare, si dhe të integritetit dhe dinjitetit.

Drejtësia miqësore

- **Parimet e përgjithshme të drejtësisë për të mitur në KDPM**
 - - Interesi më i lartë i të miturit;
 - - Ndalimi i diskriminimit;
 - - E drejta për një zhvillim harmonik;
 - - Proporcionaliteti;
 - - Përparësia e mjeteve më të zbutura dhe masave alternative;
 - - Burgosja si një masë e fundit;
 - - Pjesëmarrja e një të mituri në procedurën e drejtësisë për të mitur;
 - - Ndalimi i vonesave në këtë procedurë;
 - - Dënimi i mëparshëm i të miturit;
 - - Mbrojtja e privatësisë së një të mituri;
 - - Qasja individuale;
 - - Të drejtat procedurale etj.
- **Pjesëmarrja dhe informimi:**
- **Interesi më i lartë:**
- **Dinjiteti:**
- **Mbrojtja nga diskriminimi:**
- **Shteti i së drejtës:**

Shqyrtimi pa vonesë në funksion të parimit të ILF-së

- Neni 17 i KDPM-së: Shqyrtimi pa vonesë dhe me përparësi.
- 1. Të gjitha vendimet dhe veprimet e ndërmarra në bazë të këtij Kodi, që nga fillimi i procesit penal deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor, kryen në mënyrë të shpejtë, me përparësi, pa vonesa të pajustificuara mbi bazën e interesit më të lartë të të miturit dhe duke respektuar të drejtat e tij.
- 2. Çdo organ kompetent shqyrton në mënyrë të shpejtë, brenda afateve të caktuara në këtë Kod dhe me përparësi çështjet e të miturve në konflikt me ligjin, si dhe të çështjeve me të mitur viktimë dhe dëshmitar, duke garantuar që procesi penal, në çdo fazë të tij, të mos përkeqësojë traumën e përjetuar nga i mituri dhe që sistemi i drejtësisë penale për të miturit të sigurojë, sipas rastit, gjithë ndihmën e duhur ndaj të miturit.

Pjesëmarrja dhe informimi:

- Në proceset që përfshijnë fëmijët ose që kanë të bëjnë me ta, duhet të respektohet e drejta e të gjithë fëmijëve për *t'u informuar* mbi të drejtat e tyre, duhet *t'u jepet akses i duhur në drejtësi* si dhe të konsultohen e dëgjohen.
- Kjo nënkupton që *opinioneve* të fëmijëve t'u jepet rëndësia e duhur, duke marrë në konsideratë *pjekurinë e tyre* dhe *çdo problematikë* që mund të ekzistojë *lidhur me komunikimin*. Fëmijët duhet të vlerësohen dhe të trajtohen si bartës të plotë të të drejtave dhe duhet të gëzojnë të drejtën e ushtrimit të të drejtave të tyre, në atë mënyrë që merr parasysh aftësitë e tyre për të formuar pikëpamjet e tyre dhe rrethanat e çështjes.

Praktika e GJEDNJ-së

- Çështja *V dhe T kundër Mbretërisë së Bashkuar*. Dy djem 10-vjeçarë kishin rrëmbyer dhe goditur për vdekje një 2-vjeçar.
- Ata u gjykuan si të rritur dhe nën mbulim masiv nga media/shtypi.
- GJEDNJ-ja konstatoi se gjykimi kishte qenë i pakuptueshëm dhe frikësues për fëmijët. Ata nuk ishin në gjendje të merrnin pjesë në mënyrë efektive në procedurën kundër tyre. Kjo çoi në shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së që garanton të drejtën për një gjykim të drejtë.

Praktika e GJEDNJ-së

- Në çështjen *Sahin kundër Gjermanisë*, GJEDNJ-ja gjeti shkelje thelbësore dhe dështim në zbatimin e të drejtës për të dëgjuar pikëpamjet e fëmijës dhe tregoi se gjykata kombëtare duhej të merrte hapa të konsiderueshëm për të siguruar kontakt të drejtpërdrejtë me fëmijën dhe që, vetëm me këtë mjet, mundet të konstatohet interesi i fëmijës.

Interesi më i lartë:

- Interesi më i lartë i fëmijëve duhet të mbizotërojë në të gjitha çështjet që prekin fëmijët. Në vlerësimin e interesit më të lartë të fëmijëve të përfshirë ose të prekur, duhet të merren në konsideratë: **a.** opinionet dhe mendimet e tyre, të cilave duhet t'u jepet rëndësia e duhur; **b.** të gjitha të drejtat e tjera të fëmijës, të tilla si e drejta për dinjitet, liri dhe trajtim të barabartë, të cilat duhet të respektohen në çdo kohë; **c.** një qasje gjithëpërfshirëse duhet të ndiqet nga të gjitha autoritetet shtetërore, në mënyrë që të merren parasysh të gjitha interesat në rrezik, duke përfshirë si mirëqenien psikologjike dhe fizike ashtu dhe interesat juridike, ekonomike dhe sociale të fëmijës. Në rast konkurrimi të interesit më të lartë të dy ose më shumë fëmijëve të përfshirë në të njëjtën procedurë ose rast, ato duhet të vlerësohen veç e veç dhe të balancuara me qëllim për të pajtuar interesat e mundshme kontradiktore të fëmijëve.

Dinjiteti:

- Fëmijët duhet të trajtohen me kujdes, ndjeshmëri, ndershmëri dhe respekt në çdo çështje/procedurë, duke pasur në vëmendje rrethanat e tyre personale, mirëqenien dhe nevojat e veçanta, dhe në respekt të plotë për integritetin e tyre fizik dhe psikologjik. Ky trajtim duhet t'u jepet atyre, pavarësisht mënyrës se si ata kanë ardhur në kontakt me procedimet gjyqësore ose jo-gjyqësore apo ndërhyrje të tjera, pa marrë parasysh statusin e tyre ligjor dhe kapacitetet në çdo procedurë apo çështje.

Mbrojtja nga diskriminimi:

- Fëmijëve duhet t'u garantohen të drejtat pa diskriminim me bazë gjinie, race, ngjyre ose përkatësie etnike, moshe, gjuhe, feje, opinioni politik ose opinioni tjetër, origjine kombëtare a shoqërore, gjendjeje social-ekonomike, statusi të prindit/prindërve, përkatësie në një minoriteti kombëtar, pasurie, lindjeje, orientimi seksual, identiteti gjinor apo ndonjë statusi tjetër. Grupeve të rrezikuara, si fëmijëve emigrantë, refugjatë dhe azilkërkues, fëmijëve të pashoqëruar, me aftësi të kufizuara, fëmijëve të rrugës, romë dhe fëmijëve në institucionet rezidenciale, duhet t'u jepet mbrojtje e veçantë.

Shteti i së drejtës:

- Parimi i shtetit të së drejtës zbatohet plotësisht për fëmijët ashtu sikurse edhe për të rriturit.
- Elementet e procesit të rregullt ligjor, të tilla si parimet e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit, të prezumimit të pafajësisë, e drejta për një gjykim të drejtë, për këshillim ligjor, e drejta e aksesit në gjykata dhe ankimit, duhet të jenë të garantuara për fëmijët.
- Këto të drejta nuk duhen minimizuar ose mohuar nën pretekstin e interesit më të lartë të fëmijës. Kjo vlen për të gjitha procedurat gjyqësore, jashtëgjyqësore si dhe ato administrative. Fëmijët duhet të kenë të drejtën e aksesit në mekanizmat e duhura të ankesave, të pavarura dhe efektive.

Kuadri ligjor shqiptar për të miturit

- Njohja me këtë kuadër ligjor ka rëndësi për të kuptuar në mënyrë të plotë dhe të ndërthurur se çfarë fokusi kanë në të të miturit dhe të drejtat e tyre të cilat nuk cenohen por modifikohen me qëllim realizimin e tyre në rastet e të miturve në konflikt me ligjin penal.
- **Kushtetuta e RSH-së: 54, paragrafi i parë** parashikon të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti për fëmijët dhe të rinjtë.

Kuadri ligjor shqiptar për të miturit

- **Kodi Penal**, ligji nr. 7885/27.1.1995, i ndryshuar ka parashikuar në nenet disa vepra penale për aktet kriminale të kryera kundër të miturve, si dhe ka përcaktuar rregulla të diferencuara për dënimin e të miturve të akuzuar për kryerjen e veprave penale.
 - **Neni 31** - dënimi me burgim të përjetshëm nuk jepet për të miturit; **Neni 33** - vuajtja e dënimit me burgim për të miturit; **Neni 46** - masat edukuese për të miturit; **Neni 51** - dënimi me burgim për të miturit; **Neni 52** - përjashtimi i të miturit nga dënimi;

Kuadri ligjor shqiptar për të miturit

- **Kodi i Procedurës Penale**, ligji nr. 7905/21.3.1995, i ndryshuar, ka përcaktuar rregullat për hetimin, gjykimin, dënimin dhe vuajtjen e dënimit për të miturit e proceduar penalisht.
 - **Neni 12** - mosha për përgjegjësi penale; **Nenet 13 dhe 81** seksionet për gjykimin e të miturve; **Neni 35** - ndihma juridike dhe psikologjike që i sigurohet të pandehurit të mitur; **Neni 41** - verifikimi i moshës së të pandehurit; **Neni 42** - verifikime për personalitetin e të pandehurit të mitur; **Neni 49** - ndihma e mbrojtësit për të miturin; **Neni 103** - ndalimi i publikimit të gjeneraliteteve të të miturit; **Neni 229** - caktimi i masave të sigurimit për të miturin; **Neni 230** - nuk lejohet arrestimi i të miturit për kundërvajtje penale; **Neni 255** - detyrat e prokurorit dhe të Policisë Gjyqësore kur i mituri arrestohet në flagrancë ose ndalohet; **Neni 290** - mos fillimi i procedimit penal për shkak të moshës; **Neni 340** - gjykimi me dyer të mbyllura për të miturit; **Neni 361** - pyetja e dëshmitarëve të mitur; **Neni 410** - ankimi i të pandehurit të mitur kundër vendimit të gjykatës; **Neni 464** - ekzekutimi i vendimeve me burgim dhe mbyllje në institucione edukimi

Kuadri ligjor shqiptar për të miturit

- **Kodi Civil**, ligji nr. 7850/29.7.1994; i ndryshuar, ka një sërë rregullash për statusin e të miturit dhe për përgjegjësinë civile për dëmet e shkaktuara nga të miturit dhe ndaj të miturve.
 - **Neni 2** - zotësia juridike; **Nenet 7-9** - zotësia për të vepruar; **Neni 13** – banimi; **Neni 108** -veprimi juridik i pavlefshëm kryer nga i mituri; **Neni 361** - radha e thirrjes në trashëgimi, **Neni 362/1** - të drejtat trashëgimore të fëmijëve të lindur jashtë martese; **Neni 362/2** - të drejtat trashëgimore të fëmijëve të birësuar, **Neni 373** - zotësia për të bërë testament nga i mituri; **Neni 613-614** - dëmi i shkaktuar nga të miturit; **Neni 646** - shpërblimi i dëmit ndaj të miturit;

Kuadri ligjor shqiptar për të miturit

- **Ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.**
 - Sistemi i integruar i mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve [MDF] dhe rendesia e bashkëpunimit institucional në zbatim të parimeve të KDF-së dhe të ligjit nr. 18/2017
- Cfarë përmban ligji 18/2017?
 - Terma me rëndësi
 - Parime të shtjelluara
 - Listë të të drejtave të fëmijës [të sqaruara me qëllim garantimin dhe zbatimin e tyre]
 - Mekanizmat institucional për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës Qendror dhe vendor/lokal
 - Mbrojtje të posacme për kategori të vecanta të fëmijëve [Kush/Cilët? Si?]
 - Raportimi i rasteve [Kush? Si? Cfarë??]
 - Sanksionet

Kuadri ligjor shqiptar për të miturit

- **Kodi i Procedurës Civile**, ligji nr. 8116/29.3.1996, i ndryshuar.
 - Neni 96/a - ndalimi i përfaqësimit nga i mituri;
 - Neni 131 - njoftimi i të miturit;
 - Neni 235 - i mituri dëshmitar;
 - Neni 349 - gjykimi i mosmarrëveshjeve me natyrë familjare;
 - Neni 352 - Kujdestaria e të miturit;
 - Neni 356 - mbarimi i kujdestarisë për të miturin;
- **Kodi i Punës**, ligji nr. 7961/12.7.1995, i ndryshuar.
 - Neni 5 - punët familjare;
 - Neni 98 - mosha minimale për punë;
 - Neni 99 - punët e lehta;
 - Neni 101 - ndalimi i punës së natës për të miturit;
 - Neni 103 - kontrolli mjekësor për të miturit;
 - Neni 106 - leja e birësimit; Neni 132 - përkujdesja për fëmijët në ngarkim;
 - Nenet 98-103 - mbrojtja e veçantë në punë për të miturit;

Kuadri ligjor shqiptar për të miturit

- **Kodi i Familjes**, ligji nr. 9062/8.5.2003, i ndryshuar.
 - Neni 6 - dëgjimi dhe pëlqimi i të miturit;
 - Neni 229 - heqja e përgjegjësisë prindërore;
 - nenet 232-239 - pasuria e të miturit dhe veprimet juridike me të;
 - Neni 263- 264, 266, 273, 293, 295 - kujdestaria e fëmijëve;
 - Nenet 240 - 262 - rregullat e birësimit
 - Neni 303 - parashkrimi i padisë për kujdestarinë;
 - Neni 311 - heqja e zotësisë për të vepruar;
- Ligji "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", nr. 69/2012.
- Ligjin "Për ekzekutimin e vendimeve penale".
- Ligji "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim".
- Ligji "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare".
- Ligji "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve".

MODULI 2:

Drejtësia restauruese dhe ndërmjetësimi në drejtësinë penale për të mitur

Struktura dhe ngarkesa mësimore

Dita 1	
30 minuta	<p>Prezantimi me temë:</p> <p>Prezantimi me temë: “Kuptimi i drejtësisë restauruese dhe i ndërmjetësimit. Vendi i tyre në Kodin e Drejtësisë Penale për të mitur”</p> <p>Debat:</p> <p>Videoloja si shkak i kryerjes së një vepre penale. Efekti negativ i videolojës “Balena Blu” që shkaktoi vetëvrasje, vrasje nga të miturit dhe dëmtime të shëndetit në mbarë botën.</p>
60 minuta	<p>Aktiviteti:</p> <p>Ushtrime për zbatimin e masës së shmangies në rastin e të miturve që kryejnë vepra penale të lidhura me shkeljen e rregullave të qarkullimit rrugor.</p> <p>Ndarja e auditorit në 3 – 4 grupe në varësi të numrit të pjesëmarrësve, ku në secilin grup janë 4 kandidatë për magjistratë. Çdo grup ka një situatë të ndryshme nga të tjerët. Grupet analizojnë situatën e parapërgatitur nga pedagogu dhe evidentojnë nëse plotësohen kriteret dhe kushtet për zbatimin e masës së shmangies. Sa i përshtatshëm është ndërmjetësimi apo drejtësia restauruese në situatat e analizuara prej tyre?</p>
30 minuta	<p>Prezantimi i konkluzioneve për Aktivitetin 1:</p> <p>Çdo grup paraqet konkluzionet e diskutimit: Prezantimi i listës së kushteve që duhet të analizojë prokurori/gjyqtari, evidentimi i arsyeve pse një masë është e përshtatshme, e nevojshme dhe e mundshme për t’u përmbushur nga i mituri, kushtet dhe mënyra e arritjes së marrëveshjes, hapat që ndiqen me ndërmjetësimin.</p>
Dita 2	

30 minuta	<p>Prezantimi me temë: Shmangia e të miturve nga ndjekja penale dhe zbatimi i programeve të drejtësisë restauruese e të ndërmjetësimit. Marrëveshja e shmangies dhe aktorët kryesorë të përfshirë si palë në të.</p> <p>Debat: Si vlerësohet përshtatshmëria e dhënies së masës së shmangies?</p>
60 minuta	<p>Aktiviteti 2:</p> <p>Ushtrime për zbatimin e masës së shmangies në rastin e të miturve që kryejnë veprën penale të vjedhjes.</p> <p>Ndarja e auditorit në 3-4 grupe në varësi të numrit të pjesëmarrësve, ku në secilin grup janë 4 kandidatë për magjistratë. Çdo grup ka një situatë të ndryshme nga të tjerët. Grupet analizojnë situatën e parapërgatitur nga pedagogu dhe evidentojnë nëse plotësohen kriteret dhe kushtet për zbatimin e masës së shmangies. Sa i përshtatshëm është ndërmjetësimi apo drejtësia restauruese në situatat e analizuara prej tyre?</p>
30 minuta	<p>Prezantimi i konkluzioneve për Aktivitetin 2:</p> <p>Çdo grup paraqet konkluzionet e diskutimit:</p> <p>Prezantimi i listës së kushteve që duhet të analizojë prokurori ose gjyqtari, evidentimi i arsyeve pse një masë është e përshtatshme, e nevojshme dhe e mundshme për t'u përmbushur nga i mituri, kushtet dhe mënyra e arritjes së marrëveshjes, hapat që ndiqen me ndërmjetësimin.</p>
Dita 3	
30 minuta	<p>Prezantimi me temë: Procedura e ndërmjetësimit në praktikën e drejtësisë penale për të mitur. Hapat e procesit të ndërmjetësimit dhe roli i gjyqtarëve dhe prokurorëve në të. Praktika ndërmjetësuese.</p> <p>Debat me temë: “Ndërgjegjësimi i palëve për ndërmjetësimin. Çfarë kuptoni me ndërgjegjësim të të miturit dhe të personave të përfshirë në procesin e ndërmjetësimit?”</p>
60 minuta	<p>Aktiviteti 3:</p> <p>Ushtrime për zbatimin e masës së shmangies në rastin e të miturve që kryejnë veprën penale të përdorimit dhe shpërndarjes së lëndëve narkotike, etj.</p>

	<p>Ndarja e auditorit në 3 – 4 grupe në varësi të numrit të pjesëmarrësve, ku në secilin grup janë 4 kandidatë për magjistratë. Çdo grup ka një situatë të ndryshme nga të tjerët. Grupet analizojnë situatën e parapërgatitur nga pedagogu dhe evidentojnë nëse plotësohen kriteret dhe kushtet për zbatimin e masës së shmangies. Sa i përshtatshëm është ndërmjetësimi apo drejtësia restauruese në situatat e analizuara prej tyre?</p>
<p>30 minuta</p>	<p>Prezantimi i konkluzioneve për Aktivitetin 3:</p> <p>Çdo grup paraqet konkluzionet e diskutimit: Prezantimi i listës së kushteve që duhet të analizojë prokurori/gjyqtari, evidentimi i arsyeve pse një masë është e përshtatshme, e nevojshme dhe e mundshme për t’u përmbushur nga i mituri, kushtet dhe mënyra e arritjes së marrëveshjes, hapat që ndiqen me ndërmjetësimin.</p>

Objektivat mësimore

Pas përfundimit të këtij moduli, kandidatët për magjistratë do të jenë në gjendje:

- të përshkruajnë kuptimin e drejtësisë restauruese dhe të identifikojnë vendin që zë ndërmjetësimi në të;
- të njohin konceptet dhe pikëprerjet e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur me ligjin "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve" dhe Kodin e Procedurës Penale;
- të kuptojnë dhe të aftësohen në zbatimin e programeve të drejtësisë restauruese për shmangien e të miturve nga ndjekja penale;
- të kuptojnë rolin dhe sjelljen e ndërmjetësve në procesin e zgjidhjes së një konflikti jashtëgjyqësisht si dhe mënyrën e sjelljes për arritjen e besueshmërisë në rolin e tij/saj,
- të analizojnë hapat e procesit të ndërmjetësimin dhe mënyrën e komunikimit me palët në konflikt.

Aktiviteti 4:

Debat

Organizimi i diskutimit në punë të pavarur në grupe :

A mund të jetë një videolojë si shkak i kryerjes së një veprë penale?

A keni dëgjuar për efektet negative të videolojës "Balena Blu" që në mbarë botën shkaktoi raste vetëvrasjesh, vrasjesh nga të miturit dhe dëmtime të shëndetit?

Diskutojmë për rastin praktik:

- Më 31 maj 2014, dy 12-vjeçare joshën shoqen e klasës, 12-vjeçaren Payton Leutner, për të shkuar në pyll. Anissa Weier e vuri poshtë Leutner-in dhe i kërkoi Morgan Geysler-it që ta godiste me thikën e saj. Geysler-i e goditi 9 herë.
- Ato e braktisën shoqen që ishte gati për të vdekur. Megjithatë, ajo u tërhoq përmes pyllit të izoluar dhe u ndihmua nga një çiklist që po kalonte aty pranë.
- Pasi e goditën me thikë shoqen e tyre, vajzat kërkuan në pyll për Slender Man-in, një personazh imagjinar që besonin se ishte i vërtetë. Kur u arrestuan, të dyja vajzat pretendonin se e kryen sulmin e tyre për t'u bërë ndihmëset e Slender Man-it dhe për t'i pëlqyer atij.
- Slender Man-i është një videolojë e bazuar në një legjendë urbane.

Bëhet ndarja e auditorit në 3-4 grupe në varësi të numrit të pjesëmarrësve, ku në secilin grup janë 4-5 kandidatë për magjistratë.

Çdo grup analizon me kujdes temën e debatit.

Bën hulumtimin shkencor duke grumbulluar të dhëna përmes internetit për temën në fjalë.

Pastaj çdo grup përgatit konkluzionet me shkrim.

Grupi zgjedh një prezantues, i cili do të prezantojë përpara auditorit konkluzionin e arritur.

1. “Kuptimi i drejtësisë restauruese dhe i ndërmjetësimit. Vendi i tyre në Kodin e Drejtësisë Penale për të mitur”

Miratimi i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur solli me vete edhe këndvështrime të reja mbi drejtësinë restauruese dhe ndërmjetësimin në rastin e të miturve në konflikt me ligjin. Prirja e drejtësisë dhe e politikave sociale në rang ndërkombëtar është se ato gjithmonë e më shpesh, po i kthejnë sytë nga alternativa e zgjidhjes me marrëveshje të konflikteve me natyrë sociale dhe juridike, sepse perceptohet që këto metoda, shërbime apo zgjidhje sjellin shmangien e të miturve nga rruga e kriminalitetit. Në këto kushte, alternativa ndërmjetësuese po forcohet, duke sjellë me vete edhe fuqizimin e ndjenjës së stabilitetit dhe harmonisë në shoqëri.

Në kuptimin e KDPM-së **“masë e drejtësisë restauruese”** është çdo masë, e cila lejon një të mitur në konflikt me ligjin të kuptojë përgjegjësinë dhe të korrigojë pasojat e një veprë penale, të kompensojë dëmet dhe/ose të pajtohet me viktimën/palën e dëmtuar dhe persona të tjerë të prekur nga vepra penale, ku i mituri që ka kryer veprën penale dhe pala e dëmtuar marrin pjesë së bashku në mënyrë aktive për të zgjidhur pasojat e veprës penale, zakonisht me ndihmën e një pale të tretë të pavarur.

Me anë të zgjidhjes miqësore të konflikteve, minimizohen pasojat e veprimeve keqdashëse e të paligjshme. Nga njëra anë, restaurohen individët e përfshirë, veçanërisht të miturit, në këto konflikte dhe nga ana tjetër, restaurohet e gjithë shoqëria dhe mënyra e jetesës dhe mbijetesës së saj. Një nga zhvillimet më të rëndësishme që lidhet me kriminalitetin dhe paligjshmërinë dhe që ngjall më shumë interes në fushën e minimizimit të pasojave të një veprë apo kundërvajtjeje penale është Teoria Restauruese e Drejtësisë (Restorative Justice)¹³.

Programet e drejtësisë restauruese janë programe që zhvillohen dhe ndiqen nga organet publike dhe subjektet private në kuadrin e zbatimit të masave të drejtësisë restauruese. Vetë KDPM-ja shpjegon termin **“masë e drejtësisë restauruese”** që na lehtëson kuptimin e termit **“program i drejtësisë restauruese”**. Programet e drejtësisë restauruese krijohen për zbatimin e projekteve apo aktiviteteve strategjike publike ose jopublike, për të mbështetur integrimin dhe rehabilitimin e të miturve të akuzuar për kryerjen e një veprë penale ose të miturve viktimë të një veprë penale. Këto programe mund të fillojnë si pjesë e procedurave të drejtësisë penale për të mitur, por në çdo rast ato do të zhvillohen jashtë procesit gjyqësor apo hetimor, me dëshirën dhe zgjedhjen e palëve, ose me propozim të prokurorit apo gjyqtarit, ose të ndonjë profesionisti tjetër që vihet në dijeni të një konflikti midis të miturit të akuzuar për kryerjen e veprës penale dhe viktimës. Vendi, koha dhe mënyra e zhvillimit të këtij procesi zgjidhen që ai kryhet në rrethana neutrale për të cilat bien dakord palët dhe/ose autoritetet e drejtësisë. Programet e drejtësisë restauruese nga fillimi deri në

¹³ Shih Mark. S. UMBERT, “Victim meets offender”, The impact of Restorative Justice and Mediation, Faqe 2, botuar nga Criminal Justice Press, Willow Tree Press, Inc., Monsey, New York, 1994.

përfundim, nuk kanë të bëjnë fare me procesin gjyqësor/hetimor¹⁴. Neni 63 është i lidhur ngushtë me nenin 44 të KDPM-së, ndonëse si neni 63, ashtu edhe neni 44, nuk janë dispozita që referojnë shprehimisht te njëra-tjetra, por përsëri në mënyrë indirekte, të pashprehur, të nënkuptuar, ato duhet të lexohen së bashku me njëra-tjetrën.

Ndonëse fjala restaurim ka më tepër ngjyrim teknik dhe përdoret kryesisht në fushën e ndërtimit apo në atë të arteve të bukura, huazimi i këtij termi nga këto fusha është bërë duke synuar tek analogjia figurative e të dy proceseve. Kështu, restaurimi i një ndërtese të vjetër, që nën ndikimin e kohës dhe të faktorëve atmosferikë, humbet vlerat e saj arkitektonike deri në prishje e rrëzim të plotë, nga njëra anë dhe, restaurimi i individit që kryen një vepër penale apo një veprim të paligjshëm dhe duhet restauruar që të riintegrohet në shoqëri, kanë ngjashmëritë e tyre për sa i përket synimit ku duan të arrijnë. Në procesin e parë, arkitekturore apo artistik, restaurimi ruan format, ngjyrat, projektin e ndërtesës ose ruan elementet e veprës artistike, ngjyrat, format, duke mbartur vlerat e tyre historike, ndërtimore ose artistike për brezat që vijnë në një shoqëri.

E njëjta gjë ndodh edhe tek individit i akuzuar apo i dënuar, aq më tepër kur ky është i mitur. Ai kryen një vepër penale, që është një akt i realizuar shpesh në momente inati, urrejtje, pakujdesie, vetëbesimi të tepruar dhe e vuan për tërë jetën. Në këto kushte, qëllimi i restaurimit të individit është që të ruajë entitetin e tij fizik, të ruajë ato vlera pozitive që ai mbart në vetvete dhe të punohet jo thjesht për ta ndëshkuar, por për të ndryshuar, "gdhendur" jo vetëm me daltë, çekiç, apo penel pjesët e tij negative. Kur flasim për pjesë negative, do të kemi parasysh ato sjellje që manifestohen në mjedisin rrethues, dhe që lidhen me kushtet ku është rritur njeriu, me personalitetin e tij, me karakterin e temperamentin, me fëmijërinë dhe kushtet familjare e kulturore e të tjera, dhe veçanërisht me mënyrën sesi individit menaxhon ndjenjat negative: urrejtjen, inatin, smirën, lakminë, etj, dhe me mënyrën sesi menaxhon konfliktin në të cilin ka hyrë prej tyre, dhe mënyrën se si reagon ndaj pasojave që ka shkaktuar veprimi apo mosveprimi i tij.

¹⁴ Shih nenin 14 të ligjit nr. 10835/2011, "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve". Aksesohet në: http://www.drejtësia.gov.al/files/userfiles/Komisioni_i_licensimit/Ligji_nr_10385_dt_24.02.2011.pdf

2. Drejtësia restauruese si koncept dhe parimet e saj

Çdo shoqëri njerëzore e dëshmon stadin e zhvillimit dhe të qytetarisë së saj, ndër të tjera, edhe nga mekanizmat vetërregullues të mosmarrëveshjeve e konflikteve që lindin në gjirin e saj. Bashkëjetesa paqësore e harmonike e anëtarëve të një shoqërie dhe aftësitë për të zgjidhur miqësisht çdo mosmarrëveshje, dëshmojnë për qytetari, jo thjesht në kuptimin gjeografik të fjalës, por në kuptimin social e botëkuptimor. Kur ndjenjat mbizotëruese në një bashkësi, janë të orientuara drejt mirëkuptimit, tolerancës, faljes, pajtimit dhe dashamirësisë, ato kthehen në vlera që mund dhe duhet të trashëgohen brez pas brezi. E kundërta ndodh nëse shkohet drejt inatit, urrejtjes, hakmarrjes e vetëgjyqësisë. Shoqëria shqiptare e ka gjetur veten herë pas here të lëkundur midis këtyre dy tendencave dhe karakterizohet nga kompleksiteti në gjetjen e zgjidhjes së duhur në momente krizash e konfliktesh.

Rasti i të miturve që kryejnë vepra penale dhe që marrin ndëshkimin me një nga alternativat e dënimit të parashikuara nga ligji, dëshmon se në rritjen dhe edukimin e këtyre individëve diçka nuk ka shkuar mirë, ka pasur diskriminim, nënvlerësim, fyerje, ka pasur dhunë fizike apo psikike, ka pasur probleme të mungesës së një modeli paqësor e të qytetëruar nga prindërit apo të afërmit e tjerë.

Në të njëjtën kohë, në shoqërinë moderne, ku drejtësia ka demonstruar lidhje të vogla pozitive midis shkelësit me viktimën e krimit apo shoqërinë e gjerë, nuk është e vështirë të kuptosh se teoria e premtuar e drejtësisë mbi krimin, po përqafohet gjithnjë e më tepër nga një numër në rritje komunitetesh në të gjithë botën. Sjellja kriminale e një të mituri sjell pasoja në disa drejtime, si:

- (1) një person që dhunohet (i mitur ose i rritur) dhe është viktima e parë kryesore,
- (2) një shtet ligjor që cenohet në rendin e tij juridik dhe në mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve, që është viktima e dytë dhe,
- (3) një komunitet i lënduar, që është viktima e tretë,
- (4) një i mitur, të cilin shteti, familja dhe shoqëria kanë dështuar që ta mirërrisin e miredukojnë.

Drejtësia restauruese e vendos si viktimën, ashtu edhe shkelësin nën ndikimin e zgjedhjes së problemeve, duke u fokusuar në përmirësimin e raportit midis humbjeve materiale dhe humbjeve psikologjike. Megjithëse i vështirë, dialogu dhe marrëveshja shërbejnë si elemente qendrore dhe të mundshme të restaurimit të drejtësisë. Ky është pikërisht thelbi kryesor i lehtësimit të pasojave të krimit, me gjithë rritjen e numrit të shkelësve të dhunshëm. Dhënia e një dënimi penal me burg për të akuzuarin shpesh sjell depersonalizimin e tyre dhe krijimin e një distance të pakapërcyeshme midis të dënuarit dhe shoqërisë/komunitetit . Në vend të pagimit të një detyrimi ndaj shoqërisë, shkelësi mund t'i paguajë detyrimin viktimës për t'u korrigjuar në mënyrë korrekte

¹⁵ Shih Nils Christie "Crime Control as Industry", Publikuar nga Oslo University, ROUTLEDGE, Taylor & Francis Group 1993, faqe 163-164.

Aktiviteti 5:

Debat

Organizimi i diskutimit në punë të pavarur në grupe:

- Si e kuptoni parimin: "burgimi i të miturit alternativa e fundit"?

- A keni dëgjuar për Faktorin Miller?

Diskutojmë për rastin praktik:

- Më 2003, Evan Miller 14 goditi fqinjën e tij për vdekje me një shkop bejsbolli dhe më pas e vendosi në rimorkionin e tij e i vuri zjarrin. Ai hodhi një fletë mbi kokën e tij dhe bërtiti: "Unë jam Zoti! Unë kam ardhur për të marrë jetën tuaj." Viktima vdiq nga goditjet e asfiksimit.
- Deri në 14 vjeç, Miller-i kishte tentuar të vriste veten katër herë, (e para kur ishte 6 vjeç). Ai kishte qenë në kujdestari, se njerku i tij e rrihte dhe nëna e tij abuzonte me drogë dhe alkool.
- Miller-i u dënua në vitin 2006 me burgim të përjetshëm, pa pasur mundësinë e lirimit me kusht.
- Në moshën 28-vjeçare, paraqitet para një gjykatësi të qarkut të Alabamës për një seancë dëgjimore për rigjykimin në të cilën pretendohet të merret parasysh "fajësia e zvogëluar e fëmijëve dhe rritja e ndryshimi i kapaciteteve".
- Udhëzimet vijnë nga Gjykata Supreme, që në vitin 2012, vendosi, në rastin Miller kundër Alabamës se skemat e dënimit që cenojnë të drejtën për jetën pa mundësi lirimi me kusht për të miturit janë jokushtetuese. Vendimi Miller ka vendosur se fëmijët duhet të kenë një standard tjetër nga të rriturit. Në rastin Miller Gjykata pushoi së vepruari. Një gjykatës "mund të hasë një shkelës të rrallë midis të miturve, që bën një shkelje të përvokueshme dhe rehabilitimi është i pamundur dhe burgimi është i justifikuar". Por, dënimi duhet të jetë "i pazakontë", dhe duhet të bëhet në një seancë për të peshuar atë që është bërë e njohur si faktori Miller: "perspektivat e personit për rehabilitim dhe faktin se rrethanat e moshës së tyre mund të kenë kontribuar në këtë krim.

Bëhet ndarja e auditorit në 3-4 grupe në varësi të numrit të pjesëmarrësve, ku në secilin grup janë 4-5 kandidatë për magjistratë.

Çdo grup analizon me kujdes temën e debatit.

Bën hulumtimin shkencor duke grumbulluar të dhëna përmes internetit për temën në fjalë.

Pastaj çdo grup përgatit konkluzionet me shkrim.

Grupi zgjedh një prezantues, i cili do të prezantojë përpara auditorit konkluzionin e arritur.

3. Koncepti i ndërmjetësimit. Raporti i tij me drejtësinë restauruese

Në kuptimin e KDPM-së “**ndërmjetësim**” është procesi i zgjidhjes jashtëgjyqësisht dhe përmes dialogut mes një të mituri që ka kryer veprën penale dhe viktimës. Ky proces realizohet nga ndërmjetësi dhe synon të zgjidhë mosmarrëveshjen mes tyre dhe pasojat që vijnë nga vepra penale, si dhe të përmirësojë marrëdhëniet midis tyre, pavarësisht nëse zbatohet ose jo si masë shmangieje.

Procedura e ndërmjetësimit mes të miturit të akuzuar dhe viktimës, duke qenë një procedurë me natyrë sa juridike, aq edhe sociale e psikologjike, ka disa rregulla më fleksibël krahasuar me procedurat gjyqësore dhe hetimore. Për këtë arsye, neni 64 i KDPM-së përcakton pak rregulla procedurale, që janë të detyrueshme vetëm kur i referohen parimeve të ndërmjetësimit. Të tilla janë: karakteri vullnetar i procesit të ndërmjetësimit, karakteri personal i pjesëmarrjes së palëve ose parimi i realizimit detyrimisht të procesit përmes një personi të tretë, siç është ndërmjetësi. Pjesa tjetër e procedurës së ndërmjetësimit ka natyrë fakultative. Pra, kjo procedurë ndjek rregulla që rast pas rasti janë në zgjedhjen e palëve, ose në vlerësimin e pjesëmarrësve të tjerë në proces si prokurori, e të tjerë, që diktohen nga natyra e veprës penale dhe nga karakteristikat personale të sjelljes së palëve, nga historia e të miturit, nga mundësia e rivendosjes së raporteve normale mes palëve, nga mundësia e rehabilitimit të të miturit dhe e viktimës dhe riintegrimi i tyre në shoqëri.

Ndërmjetësimi viktimë-i akuzuar dhe drejtësia restauruese janë dy elementet e pandara të një binomi, të cilët varen tërësisht nga njëri-tjetri, sepse rezultati më madhor i ndërmjetësimit të suksesshëm viktimë-i akuzuar është pikërisht restaurimi i drejtësisë, nëpërmjet “restaurimit” të individit. Për këtë arsye, më poshtë po paraqesim në mënyrë skematike synimet e drejtësisë në të kaluarën dhe evoluimin e koncepteve dhe qëllimeve të ndëshkimit në kohët e sotme moderne.

Krahas rregullave të detyrueshme, KDPM-ja synon edhe ta kryqëzojë procedurën e ndërmjetësimit me procedurën e hetimit nga prokurori apo të gjykimin nga gjyqtari, duke përcaktuar mundësinë e pezullimit të procesit hetimor/gjyqësor në rast të kalimit drejt një procedure ndërmjetësimi. Lidhur me këtë, neni 64 synon ta disiplinojë procesin e ndërmjetësimit për të qenë sa më i shpejtë, racional dhe efikas dhe këtë e realizon përmes përcaktimit të afateve kohore maksimale që shkojnë deri në 45 ditë. Gjatë këtij afati, për shkak të ndërmjetësimit jashtëgjyqësor, bëhet edhe pezullimi i procedurës gjyqësore. Kodi i të Miturve synon të përcaktojë edhe rrethin e personave që mund përfshihen në një procedurë ndërmjetësimi, duke evidentuar rolin e tyre në raport me palët dhe në raport me procesin në tërësi. Prania e tyre në procesin e ndërmjetësimit nuk është e detyrueshme, por varet nga vullneti i palëve në konflikt, (i mituri i akuzuar dhe viktimë) dhe, nga vlerësimi që bëjnë vetë pjesëmarrësit e tjerë, si: përfaqësuesi ligjor i të miturit, psikologu, punonjësi i Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, prokurori dhe/ose personat e tjerë të caktuar prej tij, në të mirë të përmirësimit të marrëdhënieve midis të miturit të akuzuar për kryerjen e veprës penale dhe viktimës.

Brenda qëllimit të nenit 64 të KDPM-së parashikohet edhe zhvillimi i një procedure ndërmjetësimi si masë shmangieje nga ndjekja penale për të miturin e akuzuar për kryerjen e veprës penale, e cila si e tillë lehtëson rehabilitimin social të të akuzuarit dhe riintegrimin e tij në shoqëri. Qëllimi i kësaj dispozite është të evidentojë raportin midis ndërmjetësimit dhe shmangies, dhe për pasojë barazinë e tyre. Nga ana tjetër, ndërmjetësimi edhe kur nuk ka efekte të tilla që sjellin shmangien nga ndjekja penale, mund të zbatohet për të përmirësuar marrëdhëniet midis viktimës dhe të akuzuarit. Pra, në konkluzion, neni 64 e shikon ndërmjetësimin në një perspektivë të gjerë dhe afatgjatë, që lidhet me ato që quhen marrëdhënie midis viktimës dhe të akuzuarit.

Ndërmjetësimi nuk është një fenomen apo nocion i panjohur edhe për shqiptarët. Në vite e shekuj shqiptarët janë përpjekur të zgjidhin me pajtim konfliktet e tyre sociale dhe juridike. Ndërmjetësimi është mënyra më e drejtë dhe më efikase që tregon se si mekanizmi “dhimbja kontrollon njerëzit” të shndërrohet në mekanizmin “si njerëzit përpiqen të kontrollojnë dhimbjen dhe ta shuajnë atë”¹⁶.

Ndërmjetësimi është përshkruar përgjithësisht, si një alternativë e zgjidhjes së konflikteve me anë të një personi të tretë dhe si një metodë jashtëgjyqësore që synon në arritjen e një marrëveshjeje midis palëve në konflikt. Ndërmjetësimi si proces, mund të realizohet si brenda procedimit gjyqësor që bën gjykata, ashtu edhe jashtë kuadrit të procesit gjyqësor.

Zgjidhja me ndërmjetësim e problemit për të ardhmen midis viktimës dhe dhunuesit, shihet si më e rëndësishme, se sa përcaktimi i fajit për shkelësin. Siguria publike ka një rëndësi kryesore dhe një ndëshkim i rreptë për shkelësin, shpesh merr më shumë rëndësi, se sa mundësitë që i japin viktimave të drejtën të kërkojnë mbylljen dhe shërimin e pasojave të veprës penale. Ato lënë gjurmë të shkelësit duke ndikuar në mënyrë humane mbi sjelljen e tyre për t'i korrigjuar dhe riedukuar, por në të njëjtën kohë bëhen shtysë edhe për rigjenerimin e viktimës.

Ndërmjetësimi është një **veprimtari jashtëgjyqësore** që nënkupton dy situata juridike:

- (1) rastin kur ndërmjetësimi zgjidhet si alternativë drejtpërsëdrejti nga palët, pa shfrytëzuar asnjë alternativë tjetër (procesin gjyqësor, arbitrazhin, etj), si dh
- (2) rastin kur mosmarrëveshja ka filluar të zgjidhet nga prokuroria ose një instancë gjyqësore, dhe palët vlerësojnë të shfrytëzojnë alternativën ndërmjetësuese. Në këtë rast, procesi tjetër pezullohet, derisa të vlerësohet nga palët nëse do të arrijnë një marrëveshje pajtuese apo jo. Kjo do të thotë, që në kuptimin e këtij neni, shërbimi i ndërmjetësimit realizohet me ndihmën e subjekteve jashtëgjyqësore që nuk janë juristë, nuk kanë autoritet gjyqësor, por janë thjesht ndërmjetës të cilët plotësojnë kushtet e këtij ligji.

Me termin "**procedurë jashtëgjyqësore**", KDPM-ja i referohet një procedure që pavarësisht se mund të fillojë me dëshirën dhe zgjedhjen e palëve, ose mund të fillojë me propozim të prokurorit apo gjyqtarit, ose të ndonjë profesionisti tjetër që vihet në dijeni të një konflikti midis të miturit të akuzuar për kryerjen e veprës penale dhe viktimës, në çdo rast do të zhvillohet jashtë procesit gjyqësor apo hetimor dhe nën drejtimin e një personi të tretë që është ndërmjetësi, i cili është subjekt që vepron si person fizik ose juridik privat i licencuar për të ofruar këtë shërbim. Vendi, koha dhe mënyra e zhvillimit të këtij procesi zgjidhen që ai kryhet në rrethana neutrale për të cilat bien dakord palët dhe/ose autoritetet e drejtësisë. Procedura e ndërmjetësimit mund të iniciohet nga gjyqtari, prokurori ose punonjësi i policisë, por këto subjekte nuk luajnë asnjë rol aktiv pasi procedura e ndërmjetësimit nga momenti kur fillon e deri në përfundim të saj, nuk ka të bëjë fare me procesin gjyqësor/hetimor. Vetëm në përfundim të procedurës së ndërmjetësimit, aktmarrëveshja e arritur nga palët i përcillet organit kompetent i cili e ka iniciuar, nëse procedura u propozua nga një organ i tillë.

Ndërmjetësimi është një veprimtari e **pavarur**. Pavarësia e këtij procesi nënkupton faktin që ndërmjetësimi ushtrohet nga subjekte private si persona, ashtu dhe nga ato që janë të organizuara si organizata jofitimprurëse apo fitimprurëse në formën e shoqatave, qendrave, fondacioneve dhe subjekteve tregtare. Ndërmjetësimi nuk realizohet nga organet publike, nga struktura, institucione apo persona që janë pjesë e strukturës së administratës publike. Ndërmjetësimi nuk realizohet nga organet e drejtësisë, të tilla si gjykatat, prokuroritë, apo organet e policisë. Ndërmjetësimi është pjesë e nismave private të subjekteve fizike e juridike për të ofruar shërbimin e lehtësimit të mosmarrëveshjes me ndihmën e një personi të tretë që është ndërmjetësi.

Ndërmjetësimi është një **alternativë e zgjidhjes** së konflikteve miqësisht, me marrëveshje, me pëlqim, me falje. Në rast se palët nuk janë të kënaqura me pasojat e ndërmjetësimit, ato mund t'i drejtohen alternativave të tjera të zgjidhjes së konflikteve, si asaj gjyqësore, arbitrazhit, ankimit administrativ, e të tjera. Sipas ligjit për ndërmjetësimin, ndërmjetësimi në fushën penale zbatohet për mosmarrëveshjet që shqyrtohen nga gjykata me kërkesën e të dëmtuarit akuzues, ose me ankim të të dëmtuarit, sipas neneve 59 dhe 284 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe në çdo rast kur ligji i veçantë e lejon atë.

Ndërmjetësimi është procedurë, teknikë, ndërsa drejtësia restauruese është një metodë, rrugë, për të arritur në zgjidhje që synojnë realizimin e objektivit për të ndërtuar një botë më të mirë, ku jetojnë e punojnë individë më të mirë dhe ku çdo e keqe korrigjohet e ndryshohet me të gjitha format. Ndërmjetësimi është metoda, drejtësia restauruese është finalizimi i kësaj metode. Të dyja janë të lidhura pazgjidhshmërisht me njëra-tjetrën, sepse janë pjesë të të njëjtit proces.

Drejtësia restauruese duhet të synojë që ndëshkimi i të akuzuarit të luajë një rol riedukues dhe rehabilitues, për ta kthyer të akuzuarin pas vuajtjes së dënimit në një pjesëtar të qytetëruar të komunitetit që nuk do t'i rikthehet krimit dhe burgut.

4. Qëllimi kryesor i ndërmjetësimit midis viktimës dhe të akuzuarit

Në shoqërinë shqiptare, por edhe në atë moderne perëndimore, nuk është e vështirë të kuptosh se teoria e premtuar e drejtësisë mbi krimin, po përqafohet gjithnjë e më tepër nga një numër në rritje i komunitetit.

Aktivizimi i shërbimit të provës si një institucion i ri, ka krijuar një hapësirë të re për ndërmjetësimin e të dënuarit me viktimën, duke e përfshirë atë në kontingjentin e personave të dënuar me masat alternative të dënimit me burgim, me kusht apo me alternativa dënimi me punë në të mirë të publikut e të tjera.

Kur dënimi i dhënë për veprën penale të kryer, është deri në një vit burgim, gjykata mund të vendosë ekzekutimin e vendimit me burgim me gjysmëliri¹⁷ ose pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimin për kryerjen e një pune me interes publik¹⁸. Gjithashtu, gjykata mund të vendosë vuajtjen e dënimit të dhënë me qëndrimin në shtëpi të të dënuarit, në një shtëpi tjetër private apo në një qendër të kujdesit dhe të shëndetit publik, kur dënimi i dhënë për veprën penale të kryer është burgim deri në dy vjet apo kur kjo është pjesë e mbetur e dënimit sipas një vendimi për një periudhë më të gjatë burgimi¹⁹.

I dënuari vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit me burgim kur rrezikshmëria e personit dhe e rrethanave të kryerjes së veprës penale është e pakët dhe dënimi i dhënë është deri në pesë vjet burgim.²⁰ Në rastet kur i dënuari ka vuajtur jo më pak se 1/2 e dënimit të dhënë për kundërvajtje penale, jo më pak se 2/3 e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi gjer në pesë vjet burgim apo jo më pak se 3/4 e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi nga pesë deri në njëzet e pesë vjet burgim, dhe me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin e vuajtur është arritur qëllimi për edukimin e tij, gjykata mund të vendosë lirim nga vuajtja e mëtejshme e dënimit. Megjithatë, lirimi me kusht nuk lejohet për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje.²¹

Në disa raste, gjykata, për shkak të detyrimeve të personit të dënuar në lidhje me punën, arsimin, kualifikimin ose aftësimin profesional, përgjegjësitë thelbësore familjare apo për nevojën për trajtim ose rehabilitim mjekësor, mund të vendosë ekzekutimin e vendimit me burgim me gjysmëliri, d.m.th. me detyrimin për personin e dënuar që të kthehet në burg, pasi të ketë kryer detyrimet jashtë burgut, brenda periudhës kohore të përcaktuar nga gjykata²². Ndërsa në raste të tjera, për shkak të rrezikshmërisë së pakët të personit dhe të rrethanave të kryerjes së veprës penale, gjykata vendos pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimin që i dënuari të përmbushë një punë me interes publik. Puna me interes publik nënkupton kryerjen

¹⁷ Neni 58, ligji nr. 10023, datë 27.11.2008, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë".

¹⁸ Neni 63 i ligjit nr. 10023, datë 27.11.2008.

¹⁹ Neni 59/a i ligjit nr. 10023, datë 27.11.2008.

²⁰ Neni 59 i ligjit nr. 10023, datë 27.11.2008.

²¹ Neni 64 i ligjit nr. 10023, datë 27.11.2008.

²² Neni 58 i ligjit nr. 10023, datë 27.11.2008.

nga i dënuari të një pune, me pëlqimin e tij dhe pa shpërblim, në favor të interesit publik apo shoqatës së caktuar në vendimin e gjykatës, për një kohë nga dyzet deri në dyqind e dyzet orë, e cila do të kryhet brenda afatit prej gjashtë muajsh.²³

Ligji nr. 10023, datë 27.11.2008, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë" solli një risi në mënyrën e vuajtjes së dënimit nga i dënuari, pasi gjykata, kur ekzistojnë rastet e parashikuara në ligj, mund të vendosë vuajtjen e dënimit të dhënë me qëndrimin në shtëpi të të dënuarit, në një shtëpi tjetër private apo në një qendër të kujdesit dhe të shëndetit publik. Kjo alternativë e vuajtjes së dënimit jepet për dënimet me burgim deri në dy vjet apo kur kjo është pjesë e mbetur e dënimit, si dhe kur ekzistojnë rrethanat e mëposhtme:²⁴

- a) Për gratë shtatzëna ose nënat me fëmijë, nën moshën 10 vjeç, që jetojnë me të.
- b) Për baballarët, që kanë përgjegjësi prindërore për fëmijën, që jeton me të, nën moshën 10 vjeç, kur nëna e tij ka vdekur apo është e pazonja për t'u kujdesur për të.
- c) Për persona, në kushte të rënda shëndetësore, që kërkojnë kujdes të vazhdueshëm nga shërbimi shëndetësor, jashtë burgut.
- ç) Për personat mbi 60 vjeç, që janë të paaftë nga ana shëndetësore.
- d) Për të rinj, nën moshën 21 vjeç, me nevoja të dokumentuara shëndetësore, studimore, të punës apo përgjegjësive familjare.

Vendimi i gjykatës për vënien në provë të të dënuarit, mund të ndryshohet në çdo kohë me ndryshimin e rrethanave që kanë çuar në vendosjen e tij.

Qëllimi më kryesor i ndërmjetësimit të viktimës dhe të akuzuarit në teorinë moderne të drejtësisë restauruese është shkallëzuar sipas klasifikimit vijues, duke u nisur nga kushtet më të rëndësishme, të cilat janë:

1. Përcaktimi dhe mbajtja e përgjegjësive individuale nga shkelësit përpara ligjit për sjelljet e tyre dhe veprimet e tyre;
2. Vendosja e kushteve për mosripërsëritjen e sjelljes kriminale;
3. Sigurimi i paprekshmërisë së viktimës;
4. Sigurimi i mundësisë për të akuzuarit që të marrin përgjegjësi për veprimet e tyre të jashtme me viktimat duke bërë kështu përmirësime;
5. Pajtimi i viktimës dhe të akuzuarit;
6. Rehabilitimi i shkelësit;
7. Gjetja e një alternative të butë dhe të pranueshme për palët në konflikt;

²³ Për hollësi lidhur me raportet midis shërbimit të provës, gjykatës, prokurorisë dhe shërbimit të ndërmjetësimit mund t'i gjeni te "Rregullorja për bashkëpunimin e Shërbimit të Provës me OJF-të dhe Shërbimin e Ndërmjetësimit", nr. 302, datë 25.3.2009.

²⁴ Neni 59/a i ligjit nr. 10023, datë 27.11.2008.

8. Dëmshpërblimi i viktimës;
9. Ndikimi i komunitetit në procesin e drejtësisë;
10. Rritja e nivelit të përvojës në drejtësi nga viktimat dhe i akuzuarit, të marrë së bashku.

Të gjitha këto qëllime konsiderohen si të rëndësishme dhe parësore, ndërkohë që qëllimi plotësues i ndëshkimit ndaj shkelësit konsiderohet relativisht i parëndësishëm. Për këtë arsye, alternativat e dënimit që praktikohen gjithnjë e më shpesh në fushën penale shkojnë drejt formave të zbutura të dënimit, të tilla si vuajtja e dënimit nëpërmjet kryerjes së punëve dhe shërbimeve të caktuara, apo vuajtja e dënimit në burgje të hapura dhe gjysmë të hapura, dënimi me kusht e të tjera. Kjo për arsyen e thjeshtë se, një numër i konsiderueshëm personash të dënuar një herë me burg i rikthehen rrugës së krimit dhe vuajtja e dënimit luan një rol ç'edukues për ta. Ky fenomen është më i dukshëm në rastin e të miturve, të cilët duhet ta vuajnë dënimin në institucione edukuese të specializuara, me qëllim që burgun të mos shërbejë si një "universitet" negativ për ta dhe të mos shtojnë radhët e përsëritësve (recidivistëve).

Lind pyetja: A është ndërmjetësimi i mundshëm në të gjitha shkallët e procedimit penal?

Ndërmjetësimi është i mundshëm në të gjitha fazat e procedimit penal. Praktika dëshmon se fazat më të hershme ofrojnë më shumë mundësi për ndërmjetësim të suksesshëm²⁵. Zgjidhja e çështjes me ndërmjetësim e ndërpret procesin penal, e pezullon atë derisa konflikti të zgjidhet me marrëveshje, ose e rikthen në prokurori apo gjykatë, nëse ndërmjetësimi rezulton i pasuksesshëm.

Aktiviteti 6:

Punë e pavarur në grup:

Diskutojmë për rastin praktik: vendimi nr. 2628, datë 10.10.2018 i GjRGGJ-së Tiranë

- I pandehuri i mitur nën 16 vjeç me një makinë tip YINGANG pa targa po kryente manovra të rrezikshme para shkollës së mesme "P.B" Burrel.
- Vepra penale: "Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt" në gjendje të dehur dhe nën efektin e lëndëve narkotike;
- Ana subjektive: VP është kryer me faj, ai e ka ditur që duhej leje qarkullimi dhe nuk e kishte një të tillë për shkak të moshës;
- Rrezikshmëria e veprës është e madhe ngaqë konsiderohet krim dhe jo kundërvajtje penale;

- I mituri shfaq pendim të thellë;
- Nga vlerësimi individual rezulton se:

- a) Sjellja mund të përmirësohet;
- b) I mituri nuk shfaq rrezik për përsëritje;
- c) Shmangia është më e përshtatshme.

Bëhet ndarja e auditorit në 3-4 grupe në varësi të numrit të pjesëmarrësve, ku në secilin grup janë 4-5 kandidatë për magjistratë.

Çdo grup analizon me kujdes temën e debatit dhe fokusohet në diskutimin e alternativave të mundshme për të shmangur dënimin me burgim të të miturit.

Pastaj çdo grup përgatit konkluzionet me shkrim.

Grupi zgjedh një prezantues, i cili do të prezantojë përpara auditorit konkluzionin e arritur.

5. Roli i ndërmjetësit dhe hapat e procesit të ndërmjetësimit viktimë-i akuzuar

Ndërmjetësimi, në literaturën juridike, në mënyrë figurative përshkruhet si “një vallëzim modern intrigues që përfshin në vetvete elemente ligjore, ekonomike dhe emocionale”²⁶. Ashtu si të gjitha vallëzimet, ndërmjetësimi ka hapa të përcaktuar që duhet të hidhen njëri pas tjetrit. Njohja e teorisë së “drejtësisë restauruese” është vetëm hapi i parë; zbatimi i saj në praktikë është hapi i dytë dhe kryesori. Hapat që duhet të ndjekë ndërmjetësi janë si më poshtë:

Së pari, ndërmjetësi duhet të synojë vendosjen e një situatë mirëbesimi mes palëve. Ai, në fillim të procesit, prezanton veten dhe procesin, duke u fokusuar në avantazhet dhe pritshmëritë e alternativës ndërmjetësuese. Sesion i ndërmjetësimit fillon me shpjegimin e rolit të tij ose të saj, duke përmendur rregullat që mund të jenë të nevojshme për t’u ndjekur nga palët. Përgjatë takimit të parë të ndërmjetësimit, vëmendja përqendrohet më tepër në faktet dhe në ndjenjat lidhur me krimin. Viktimave të krimit u jepet një mundësi jo e zakonshme për të shprehur ndjenjat e tyre ndaj personit që ushtroi dhunë mbi ta. Ata mund të marrin përgjigjen e pyetjes, si p.sh.: “Përse unë?”, “Çfarë gabimi bëra me veprimet apo fjalët e mia?” Për shumë të akuzuar nuk është e lehtë të shohin viktimën. Kjo nuk është një situatë komode për dhunuesit/shkelësit, dhe atyre u jepet e njëjta mundësi jo e zakonshme për të shfaqur pamjen më njerëzore në karakterin e tyre. Por, nga ana tjetër, edhe për viktimën është e vështirë të ulet me dhunuesin e tij dhe të flasë “sy më sy”.

Së dyti, ndërmjetësi përcakton procedurën që do të ndiqet, rregullat e të folurit, kohën në dispozicion të secilës palë, radhën e të folurit: sipas moshës, seksit, rendit alfabetik të emrit, e të tjera. Koha e të folurit duhet të jetë e barabartë për të dy palët. Në këtë proces, ndërmjetësi synon t’i edukojë palët përmes procesit, jo vetëm për të qenë më tolerantë dhe paqësorë, por edhe për të respektuar normat elementare të komunikimit dhe edukatës qytetare. Pasi ndërtohet një plan i sesionit të ndërmjetësimit, ndërmjetësi takon veçmas të dyja palët. Këto takime individuale luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e ndërmjetësimit. Ndërmjetësi, duke dëgjuar historitë e secilës palë, strukturon programin dhe inkurajon pjesëmarrjen e tyre. Së treti, ndërmjetësi është një dëgjues aktiv. Kjo do të thotë se ai lehtëson bashkëbisedimin dhe kryesisht dëgjon palët. Nuk duhet harruar se protagonistë janë palët në konflikt. Ndërmjetësi është një regjisor që drejton procesin duke qenë aktiv. Duket sikur ka një kontradiktë midis të qenit “dëgjues” dhe të qenit “aktiv”. Të jesh dëgjues në këtë proces nuk do të thotë se nuk duhet të flasësh.

Ndërmjetësi do t’i ndihmojë palët të shprehen, do t’i pyesë e do t’i fusë në dialog. Pyetjet e bëra prej ndërmjetësit duhet të kenë natyrë të hapur dhe jo sugjestionuese: “Çfarë ka ndodhur? Pse jemi sot në këtë konflikt? Më shpjegoni si e perceptoni konfliktin?” Nëse viktimë dhe i akuzuari kanë qëndrime të palëkundura dhe **japin pëlqimin e tyre** për të marrë pjesë në ndërmjetësim, ndërmjetësi më pas planifikon një takim kokë

më kokë me të dyja palët. Po ashtu, ndërmjetësi bëhet aktiv, duke e ndërprerë komunikimin mes palëve, kur sheh që palët acarohen, grinden para tij, ose dalin nga tema e diskutimit. Teknika që ai ndjek në këto raste, mund të jetë në formën e kryerjes së përmbledhjeve të herëpashershme gjatë këtyre shkëputjeve kur biseda zgjatet jashtë temës ose merr një drejtim që nuk ndihmon në arritjen e marrëveshjes.

Parimet ose rregullat që duhet të respektohen përmes dëgjimit aktiv janë: vëmendja e përqendruar, mungesa e subjektivizmit, pranimi i tërësishëm i situatës, kuptimi i simbolikës së palëve në të folur, empatia dhe vlerësimi i paanshëm i palëve, krijimi i besimit të bashkëbiseduesit, aftësia e ndërmjetësit për të kuptuar veprimet e tij. Dëgjimi aktiv ka disa pengesa të tilla si: paragjykimet, marrja e fjalës më shpesh nga sa lejohet, ndërprerja e bisedës, dhënia e këshillave, përgatitja e përgjigjes, mendimi se dikush ka të drejtë, shmangia nga biseda.

Së katërti, ndërmjetësi mban shënime gjatë gjithë kohës që palët flasin, me qëllim që të identifikojë/hulumtojë problemin. Ai, gjatë bisedës, analizon dhe vlerëson rolin e palëve, sheh mundësitë që ka për të arritur një zgjidhje miqësore. Ndërmjetësi vëren se çfarë përfaqëson secila prej palëve, çfarë temperamentesh e karakteresh kanë, ku janë lënduar, çfarë interesash kanë. Kjo seancë paraprake konsiston në mbledhjen e informacioneve rreth ngjarjes kriminale dhe në shpjegimin e programit për palët. Këto takime individuale i sigurojnë mundësinë ndërmjetësit që të ndërtojë një marrëdhënie dhe të arrijë të krijojë një atmosferë besueshmërie të ndërsjellë.

Pjesëmarrja e të akuzuarit në procesin e ndërmjetësimit është krejtësisht vullnetare. Pasi të dy palët kanë përfunduar diskutimin mbi krimin dhe mënyrën si ndiheshin ata, ndërmjetësi duhet ta orientojë bisedën drejt së ardhmes. Viktimat shohin në perspektivë, duke pasur një plan për t'i bërë gjërat mirë. Në të shumtën e rasteve, viktimat shprehen optimistë përgjatë marrëveshjeve finale të pajtimit.

Së pesti, ndërmjetësi duhet të shmanget nga gjetja e së drejtës dhe fajit. Procesi i ndërmjetësimit nuk është dhënie drejtësie. Ndërmjetësimi nuk gjen fajtorin dhe nuk evidenton fajin. Ai duhet të shmanget nga emocionet, simpatitë për palën që është viktimë, me qëllim që të ruajë paanshmërinë dhe të ndërtojë neutralitetin e nevojshëm për këtë proces. Ai siguron palët për ruajtjen e konfidencialitetit të çdo informacioni apo të dhëne që del në bashkëbisedim. Ai i njofton palët se për të dhënat që cenojnë sigurinë publike apo kombëtare, ai është i detyruar nga ligji të informojë organet përkatëse. Për çdo të dhënë tjetër, me karakter privat apo personal, ai i lë palët të zgjedhin nëse duan të bëjnë publike elementë të caktuar të saj, qoftë për njëri-tjetrin, qoftë për personat e tretë.

Së gjashti, ndërmjetësi evidenton interesat e palëve për zgjidhje, si dhe mundësitë potenciale që ata kanë për të arritur interesat në mënyrë të ndërsjellë. Ai mund të bëjë edhe takime të veçanta me palët, kur ato janë dakord, për të lehtësuar identifikimin e këtyre interesave me natyrë materiale e pasurore, por jo detyrimisht vetëm të tilla. Shpesh ndodh që një kategori çështjesh penale i janë paracaktuar një stafi të specializuar

ndërmjetësish të kualifikuar profesionistë ose ndërmjetësve vullnetarë.²⁷

Së fundmi, ndërmjetësi synon përputhjen e interesave vetjake të palëve. Ky proces bëhet vetëm **me pëlqimin e palëve**, që është një nga parimet e ndërmjetësimit. Para se të jepet pëlqimi nga pala (viktima), duhet që ajo të ketë të qartë: tablonë e fakteve, të drejtat që gëzon dhe veçanërisht të drejtën për asistencë ligjore.²⁸

²⁷ Vlen të përmendim se Norvegjia dhe Shqipëria janë ndër vendet që e kanë të rregulluar me ligj të veçantë ndërmjetësimin në fushën penale midis viktimës dhe të akuzuarit. Për më shumë detaje shih ligjin nr. 9090, të vitit 2003, "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve", i ndryshuar me ligjin nr. 81/2013 dhe ligjin nr. 26/2018, i cili në nenin 2/3 të tij i referohet neneve 59 dhe 284 të Kodit të Procedurës Penale.

²⁸ Kjo gjë parashikohet edhe nga pika 8 e Rekomandimit nr. R (99) 19 të Komitetit të Ministrave të KE-së.

6. Arritja e marrëveshjes

Çdo marrëveshje e arritur mes palëve duhet të jetë **“e arsyeshme ose e përshtatshme”**. Shprehja **“duhet të jetë e arsyeshme”** nënkupton se nëse marrja e këtij vendimi për ndërmjetësim apo ndonjë program tjetër të drejtësisë restauruese i mbron më mirë palët, kujdeset për ruajtjen e dinjitetit të të miturit, e parandalon dëmtimin e tij fizik, mendor dhe emocional, atëherë gjykata ose prokuroria ka të drejtë ta vendosë atë. Në një rast të tillë, **“e arsyeshme”** do të thotë që kjo masë merret nga gjykata atëherë kur është në dobi të të miturit dhe në interesin më të lartë e më të mirë të tij. Këtu përfshihet e drejta/detyrimi që të vlerësohet nëse ndërmjetësimi është alternativa më e mirë.

Vendimi për kalimin e çështjes penale për ndërmjetësim, si dhe vlerësimi i rezultatit të një procedure ndërmjetësimi, duhet t'u rezervohet autoriteteve të drejtësisë penale. Janë këto autoritete, pra vetëm gjyqtari ose prokurori, që brenda një procedure gjyqësore ose hetimore vendosin nëse një procedurë ndërmjetësimi jashtë procesit gjyqësor/hetimor është e dobishme që pala të korrigjojë pasojat e veprës penale. Neni 63 plotësohet nga neni 64 i KDPM-së që parashikon se në rastin e ndërmjetësimit brenda procedurës gjyqësore/hetimore, ftesa për ndërmjetësim bëhet fillimisht nga organi procedues. Nëse e çmojnë si të nevojshme për të korrigjuar pasojat e një veprë penale, prokurori/gjyqtari mund t'u propozojnë palëve ndërmjetësimin, dhe pas kësaj, nëse palët janë dakord, të vendosin pezullimin e procesit në organet e drejtësisë për të vijuar procedurën e ndërmjetësimit jashtëgjyqësisht.

Neni 64 në vijim të nenit 63, liston kushtet që duhet të vlerësojë prokurori ose gjyqtari për të vendosur nëse ndërmjetësimi është alternativa më e përshtatshme. Këto kushte duhen analizuar kundrejt interesit më të lartë të të miturit, përfshi këtu edhe kur është fjala për një të mitur viktimë. Për këtë analiza përfshin: natyrën e veprës penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, historinë e të miturit, mundësinë e kthimit të raporteve normale mes të miturit dhe palës së dëmtuar, mundësinë e zvogëlimit të dëmit të palës së dëmtuar, mundësinë e rehabilitimit të të miturit dhe riintegrimin e tij në shoqëri.

Lidhur ngushtë me termin zgjedhje e arsyeshme është edhe termi **“e përshtatshme”**. Si rregull logjik, ajo masë, ai program apo ai proces që është i arsyeshëm për t'u marrë për të miturin, duhet të jetë edhe i përshtatshëm për të, por termi “i përshtatshëm” ka një specifikë që lidhet me rastin konkret dhe të miturin konkret. Për ta analizuar termin **“e përshtatshme”** mund të nisemi nga e kundërta e tij nga termi **“e papërshtatshme”** me logjikën që çdo gjë që nuk është e papërshtatshme është e përshtatshme. Lidhur me këtë, nëse bëhet kujdes që të respektohet parimi i interesit më të lartë të fëmijës, atëherë një proces apo një masë nuk duhet të vendoset me qëllim që të shmanget kryerja e një pune të papërshtatshme, në një vend të papërshtatshëm, në një kohë të papërshtatshme, pranë personave të papërshtatshëm, me mjete apo vegla të papërshtatshme. Të papërshtatshme do të konsiderohen të gjitha ato veprime ose detyrime që nëse kryhen prej të miturit mund të shkaktojnë dëmtimin e tij fizik ose psikologjik dhe mund t'i sjellin përkeqësime gjendjes së tij shëndetësore, emocionale dhe sociale.

Ligji për ndërmjetësimin parashikon që kjo marrëveshje të bëhet në formë të shkruar dhe të nënshkruhet nga palët dhe ndërmjetësi/ndërmjetësit.

- Marrëveshja e ndërmjetësimit është e detyrueshme dhe duhet të ekzekutohet në të njëjtat afate kohore si vendimet e arbitrazhit, në përputhje me nenin 22 të ligjit “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”.
- Marrëveshja e ndërmjetësimit nënshkruhet në katër kopje origjinale, një për secilën palë, një për t’u mbajtur në Qendrën e Ndërmjetësimit dhe një e fundit për t’u dorëzuar në gjykatë.
- Për sa i përket fuqisë detyruese të aktmarrëveshjes për t’u zbatuar, ligji i ri sanksionon se kur çështja është referuar për ndërmjetësim nga gjykata, ndërmjetësi, në përfundim të procedurës së ndërmjetësimit, ose në afatin e përcaktuar prej saj, e njofton atë për zgjidhjen ose jo të mosmarrëveshjes, duke dërguar edhe aktet përkatëse.
- Në rast të zgjidhjes me marrëveshje, **organet gjyqësore** vendosin, sipas rastit, **miratimin e zgjidhjes me pajtim të çështjes civile ose pushimin e çështjes penale apo mosfillimin e procedimit penal**, përveç rasteve kur arrihet në përfundimin se vërehet pavlefshmëri.
- Kur marrëveshja ka natyrën e një kontrate me detyrime në të holla të specifikuar dhe të përcaktuara për palët atëherë ajo përbën **titull ekzekutiv** dhe, në këtë rast, ngarkohet shërbimi përmbarimor për ekzekutimin e tij.

Kur vepra penale ka sjellë dëme të karakterit ekonomik në pasurinë e një personi, në shëndetin e tij etj., atëherë pjesë e drejtësisë restauruese dhe e ndërmjetësimit është edhe detyrimi që i mituri i akuzuar për veprën penale **“t’i kompensojë dëmin e shkaktuar”** viktimës, komunitetit dhe/ose shoqërisë. Kjo shprehje i referohet pasojave të veprës penale, të cilat mund të paraqiten në disa forma:

- I. si dëm material i shkaktuar ndaj pasurisë apo të ardhurave të të miturit dhe familjes së tij ose komunitetit;
- II. si dëm material ndaj shëndetit fizik e mendor të të miturit që krijon nevojën e mjekimit, shërimit, marrjes së medikamenteve, kryerjes së terapive, e të tjera;
- III. si dëm jomaterial i shkaktuar ndaj dinjitetit, personalitetit dhe figurës së të miturit;
- IV. si dëm i shkaktuar ndaj jetës private të të miturit e të tjera. Kompensimi është llogaritja në të holla e të gjitha humbjeve me karakter pasuror dhe jopasuror të shkaktuara nga veprimi penal i të

akuzuarit. Viktima mund të kërkojë shpërblimin e dëmit në rastet kur gjendja e saj rezulton e përkeqësuar pas kryerjes së veprës penale në drejtim të shëndetit fizik, mendor e stabilitetit psikologjik. Në aspektin juridik, kërkitimi i kompensimit të dëmit bëhet me anë të padisë civile të shpërblimit të dëmit, ndërsa në rastin e ndërmjetësimit, kompensimi arrihet si pjesë e marrëveshjes së palëve.

Po ashtu, kërkitimi i faljes është një nga pikat e marrëveshjes së ndërmjetësimit. **“Falja”** është një proces ballafaqimi i palëve me njëra-tjetrën dhe nga pikëpamja formale mund të bëhet me gojë ose me shkrim. “Falja” nuk kërkon ndonjë solemnitete të caktuar, por është një proces tërësisht individual, sepse çdo person pavarësisht nëse është i mitur ose i rritur ka mënyrën e tij se si kërkon falje dhe mënyrën që preferon se si duhet që të tjerët t’i kërkojnë falje. Për këtë arsye, mjafton që falja të pranohet nga viktima në formën që kjo e fundit e kërkon për t’u realizuar.

Në rastin kur njëra nga palët e kundërshton marrëveshjen në gjykatë për arsye të ndryshme ligjore, gjykata merr parasysh mënyrën e zgjidhjes me ndërmjetësim, por, gjithashtu, nuk ka pengesë ligjore për zgjidhje tjetër, në përputhje me ligjin.

Marrëveshja përmbyll shuarjen e konfliktit. Rezultatet e konflikteve penale të ndërmjetësuarra janë:

- a) heqja dorë nga fillimi i çështjes penale në prokurori nga ana e palës së dëmtuar;
- b) kryerja e veprimeve që lidhen me faljen personale apo publike në media, apo në kolektivat ku palët jetojnë e punojnë;
- c) dhënia e dëmshpërblimit në rastet e dëmtimit të shëndetit, të pasurisë e të tjera, duke mbuluar shpenzimet e mjekimit dhe ato të parashikuara nga Kodi Civil.

Në vijim është një model marrëveshje ndërmjetësimi.

MARRËVESHJE

Sot, më datë __, __, ____, në _____, në përputhje me ligjin nr. 10385, datë 24.2.2011, “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve” dhe nenit 59 dhe 284 të Kodit të Procedurës Penale, nënshkruhet kjo marrëveshje ndërmjet:
(informacion mbi palët)

1.

2.

Përshkrimi i mosmarrëveshjes

Detyrimet dhe kushtet e vendosura nga palët:

Mënyrat dhe afatet për përmbushjen e tyre:

Me vullnetin e tyre të lirë, palët deklarojnë se do t’i përmbushin me korrektësi të gjitha detyrimet dhe kushtet reciproke të përcaktuara në marrëveshje.

Pala e parë

Pala e dytë

Ndërmjetësi

MARRËVESHJE

Sot, më datë: ___/___/___, në: _____, në përputhje me ligjin nr. 10385, datë 24.02.2011, "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve", dhe nenit 59 dhe 284 të Kodit të Procedurës Penale, nënshkruhet kjo marrëveshje ndërmjet:

(informacion mbi palët)


1. _____
2. _____

Përshkrimi i mosmarrëveshjes

Detyrimet dhe kushtet e vendosura nga palët:

Mënyrat dhe afatet për pëmbushjen e tyre:

Me vullnetin e tyre të lirë, palët deklarojnë se do t'i pëmbushin me korrektësi të gjitha detyrimet dhe kushtet reciproke të përcaktuara në marrëveshje.



Kur gjykata i referohet rasteve të ndërmjetësimi, palët në të shumtën e rasteve, nuk arrijnë në një restaurim apo rehabilitim të plotë. Në rastet në të cilat njëra palë nuk është dakord me formën e ndërmjetësimi, për dhunuesin/shkelësin realizohet një tjetër program restaurimi. Ndërmjetësit, në raste të tilla, nuk propozojnë zgjidhje restauruese. Në disa raste "kontaktet e viktimave dhe të akuzuarve" reduktohen në takime të thjeshta mes njëri-tjetrit, ose përmes letrave ku kërkohet ndjesë. Kështu, ndonëse nuk arrihet një pjesëmarrje aktive e viktimës me shkelësin në një sesion ndërmjetësimi, gjithsesi arrihet një zbutje në marrëdhëniet midis tyre. Ndërmjetësimi është një proces i rëndësishëm në fushën e konflikteve penale, sepse ato shkaktojnë një dhimbje të madhe të viktimës, por shpesh edhe të vetë i akuzuarit, i cili ndihet i penduar për sjelljen kriminale që ka kryer.

7. Ndërmjetësimi dhe Kodi i Procedurës Penale

Metoda alternative e zgjidhjes së konflikteve rregullohet nga legjislacioni shqiptar procedural penal. Sistemi gjyqësor shqiptar ka një rol të rëndësishëm në zgjidhjen me ndërmjetësim të konflikteve penale. Në traditën e këtij legjislacioni është pranuar e drejta e gjykatës si dhe detyrimi i saj, për të kryer veprime e për të bërë përpjekje në zgjidhjen me ndërmjetësim e pajtim të veprave penale të parashikuara në ligj. Kështu, gjykata mund ta bëjë këtë për vepra penale, të cilat nuk mund të fillojnë pa pasur ankim të viktimës ndaj personit dëmtues (shkelësit).

Ligji për ndërmjetësimin parashikon edhe kufijtë e zbatimit të ndërmjetësimi si alternativë për zgjidhjen jashtëgjyqësisht të konflikteve. Një nga fushat e zbatimit është ajo penale. Ligji parashikon se në rastin e mosmarrëveshjeve **në fushën penale**, kur **procedimi penal ka nisur**, gjykata **detyrimisht** fton palët për zgjidhjen me ndërmjetësim të mosmarrëveshjeve të parashikuara me rrezikshmëri të ulët shoqërore dhe të specifikuar në ligj si të mundshme për t'u zgjidhur me ndërmjetësim. Kjo gjë ndodh në dy raste kryesore:

- Duke iu referuar **nenit 59²⁹ të Kodit të Procedurës Penale**, për një kategori veprash penale, të tilla si: rrahja, plagosja e rëndë nga pakujdesia, plagosja e lehtë nga pakujdesia, dhunimi i banesës, shpifja dhe disa raste të tjera, na rezulton se i dëmtuari, (viktima) ka të drejtë të paraqesë kërkesë drejtpërdrejt në gjykatë për fillimin e çështjes penale dhe të marrë pjesë në gjykim si palë, për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit. Bazuar në Kodin e Procedurës Penale për rastet e mësipërme, gjykata fton së bashku viktimën dhe të akuzuarin dhe u propozon të zgjidhin çështjen me ndërmjetësim. Nëse i dëmtuari, viktima, bindet të tërheqë kërkesën për procedim penal dhe ai që akuzohet e pranon këtë tërheqje, gjykata vendos pushimin e çështjes dhe palët në konflikt i drejtohen ndërmjetësimi. Gjithashtu, sipas **nenit 284³⁰ të Kodit të Procedurës Penale** janë përcaktuar edhe rastet e konflikteve penale kur procedimi penal fillon nga prokuroria ose policia gjyqësore vetëm duke u bazuar në ankimin e viktimës, të dëmtuarit ndaj të akuzuarit, i cili mund të tërheqë ankimin duke iu drejtuar ndërmjetësimi në çdo fazë të procedimit. Këto raste janë plagosje e lehtë nga pakujdesia, vrasje nga pakujdesia, fyerje e shpifje për shkak të detyrës, etj.

Ligji, lidhur me procedurën për ndërmjetësim, vendosi për herë të parë disa rregullime, koncepte e terma bashkëkohorë siç është **“ftesa për ndërmjetësim”** duke parashikuar se nëse një palë në mosmarrëveshje i kërkon tjetrës, ndjekjen e procedurave të ndërmjetësimi, dhe kjo e fundit nuk përgjigjet brenda 30 ditëve nga data në të cilën është dërguar ftesa ose brenda afatit kohor të përcaktuar në të, ky mosveprim duhet të konsiderohet si **mospranim**. Ftesa për ndërmjetësim, e paraqitur nga një palë në mosmarrëveshje, nuk

²⁹ Neni 59 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se: pala e dëmtuar nga një kundërvajtje apo vepër penale e parashikuar nga nenet 90, 91, 92, 112/1, 119, 120, 121, 122, 125, 127, 148, 149, dhe 254 i Kodit Penal ka të drejtë të paraqesë një kërkesë në gjykatë dhe të kërkojë shpërblimin e dëmit.

³⁰ Neni 284 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se për çështjet penale që lidhen me nenet 89, 102/1, 105, 106, 130, 239, 240, 241, 243, 264, 275 dhe 318 të Kodit Penal procedimi penal mund të mos fillojë përveçse me kërkesën e të dëmtuarit akuzues dhe kërkesa e tij mund të tërhiqet në çdo fazë të procedimit penal. Kërkesa paraqitet në prokurori apo në polici.

pengon automatikisht këtë palë që të iniciojë fillimin e një procesi gjyqësor apo arbitrazhi në lidhje me këtë mosmarrëveshje, për shkak të kalimit të afateve të paraqitjes së padisë.

Lidhur me komunikimin e ndërmjetësit me palët, ligji parashikon në mënyrë të shprehur se ndërmjetësi mund të takohet me palët, së bashku ose veçmas me secilën prej tyre. Gjatë këtyre **diskutimeve** veçmas, ndërmjetësi, pasi njihet me rrethanat dhe të dhënat e ofruara nga njëra palë në mosmarrëveshje, **mund t'i parashtojë palës tjetër çështjet thelbësore** që rezultojnë nga këto rrethana.

MODULI 3:

Shmangia e të miturve nga ndjekja penale dhe aktorët e përfshirë në këtë proces. Zbatimi i programeve të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit

Objektivat mësimore

Pas përfundimit të këtij moduli, kandidatët për magjistratë do të jenë në gjendje:

- të evidentojnë kriteret dhe kushtet që duhet të përmbushen për të vlerësuar shmangien e ndjekjes penale nga ana e prokurorit apo e gjyqtarit;
- të dinë avantazhet e shmangies dhe ndërmjetësimit në drejtësinë penale për të mitur;
- të njohin marrëveshjen që mund të bëhet me të miturin, mbrojtësin e tij, për zbatimin e programeve të drejtësisë restauruese;
- të eksplorojnë vlerat personale të të miturve dhe të garantojnë mbrojtjen e të drejtave të tyre në procesin penal;
- të identifikojnë mënyrat për të informuar të miturin, përfaqësuesin e tij ligjor dhe/ose përfaqësuesin procedural, për rëndësinë e arritjes së një marrëveshjeje për shmangien e ndjekjes penale;
- të arrijnë të dallojnë se cilat janë aktualisht pikat e forta dhe të dobëta të procesit të vlerësimit individual të të miturit, të personalitetit dhe karakterit të tij, të mundësive për t'u riintegruar, rishoqëruar dhe rehabilituar dhe për të shmangur shndërrimin e tij në një përsëritës në kryerjen e veprave penale;
- të përmirësojnë aftësinë e tyre për të menduar në mënyrë kritike, për të analizuar koncepte të ndryshme dhe të ndërlikuara dhe për të përdorur arsyetimin, gjykimin dhe imagjinatën e tyre, për të krijuar mundësi të reja në edukimin e të miturve në konflikt me ligjin.

1. Parimet e drejtësisë penale për të mitur si një drejtësi miqësore

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur (KDPM) sanksionon parimet kryesore që duhet të udhëheqin procesin e drejtësisë penale për të mitur në konflikt me ligjin dhe për rrjedhojë çdo aspekt që lidhet me të. Këto parime janë:

- Prezumimi i pafajësisë;
- Drejtësia miqësore;
- Parimi i mbrojtjes nga diskriminimi;
- E drejta për zhvillim harmonik të të miturit;
- Dënimi me burg – alternativa e fundit. Kufizimi ose heqja e lirisë si masë e fundit;
- Parimi i interesit më të lartë të fëmijës;
- Shmangia nga ndjekja penale dhe dënimi penal;
- Parimi i proporcionalitetit;
- Shqyrtimi pa vonesë dhe me përparësi.

I mituri i përfshirë në drejtësinë penale mund të ketë statusin e të akuzuarit, të dëshmitarit ose të viktimës. Në të gjitha këto pozicione, i mituri duhet të gëzojë dhe t'i garantohet mbrojtja e të drejtave të tij procedurale të tilla si: e drejta e të miturit për jetë private; mbrojtja e të dhënave personale; e drejta për t'u informuar; e drejta për të pasur mbrojtje; ndihma ligjore dhe mbështetja psikologjike; prania e të miturit, prindit, përfaqësuesit ligjor ose procedural; vlerësimi individual; shërbimet pa pagesë.

Dënimi me burg duhet të shihet si alternativa e fundit që mund të zbatohet në rastin e një të mituri të përfshirë në drejtësinë penale, sepse organet proceduese të drejtësisë duhet të synojnë riintegrimin e të miturit, rehabilitimin dhe rishoqërimin e tij.

Organi procedues vendos për zbatimin e programit të drejtësisë restauruese, në përputhje me legjislacionin për ndërmjetësimin, me qëllim krijimin e mundësive për të miturin që të korrigjojë pasojat e veprës penale të kryer prej tij, ndaj viktimës, komunitetit dhe/ose shoqërisë.

Për zbatimin e një programi të shmangies nga ndjekja penale dhe të drejtësisë restauruese, është i nevojshëm pëlqimi nga i mituri dhe/ose prindi i tij. Kur i mituri nuk ka prindër, ose ekziston një konflikt interesi ndërmjet prindërve dhe të miturit, pëlqimin, sipas pikës 2, germa "a", e këtij neni, mund ta japë një prej përfaqësuesve proceduralë, sipas parashikimeve të nenit 3, pika 17, të këtij Kodi.

2. Burgimi si alternativa e fundit dhe teoritë bashkëkohore që lidhen me të

Një sërë konkluzionesh të nxjerra nga studimet bashkëkohore ndërkombëtare formuan besimin që të përforcohej dhe të evidentohej nevoja e zbatimit të programeve rehabilituese dhe integruese me ndihmën e punonjësve socialë për të miturit që kryenin vepra penale. Përjasjet dhe teoritë që ndeshen shpeshherë duke u diskutuar në qarqet e juristëve, psikologëve, punonjësve socialë etj., janë:

- **Teoria e realitetit të parëndësishë** – që udhëhiqet nga pohimi se shumica e veprave penale të kryera nga të miturit janë të parëndësishme dhe si të tilla duhet që të shmangim dënimin me burgim;
- **Teoria e zhvillimit të arsytimit të krimin** – që udhëhiqet nga pohimi se shumica e të miturve kryejnë vepra penale gjatë adoleshencës dhe se pjesa më e madhe nuk do të kryejnë më vepra penale, për shkak se në mënyrë natyrore do të rriten/ do të arrijnë pjekurinë, prandaj mbështetet shmangia nga ndjekja penale;
- **Teoria e etikimit** – që udhëhiqet nga pohimi se përfshirja zyrtare në sistemin e drejtësisë penale sjell pasoja negative ku të miturit etiketohen si kriminelë;
- **Teoria që nisat nga efekti i kostos në rritje** – nëse sillen para drejtësisë penale që në moshë fare të re, do të shpejtohet dënimi me burgim në të ardhmen;
- **Teoria e shkollave të krimin** – që udhëhiqet nga arsyetimi se burgimi është një shkollë edukimi negative që i ekspozon të rinjtë ndaj shkelësve më të mëdhenj në moshë;
- **Teoria e zgjerimit të rrjetit** – që rrethi i të miturve që përfshihen në drejtësinë penale për të mitur vjen duke u zgjeruar, sepse grupmoshat e reja mësojnë më shpejt nga shembulli negativ. Kjo teori pranon se programet që mbështeten në ndihmën sociale mund të sjellin më shumë të rinj para sistemit të drejtësisë penale dhe për rrjedhojë burgimi duhet të jetë alternativa e fundit;
- **Teza radikale e mosndërrhyjes** – e cila propagandon që drejtësia të merret sa më pak me të miturit, sepse më e mira është që të shmangim dëmin e mundshëm që mund të shkaktohet nga sistemi i drejtësisë penale.

3. Kuptimi i shmangies

Shmangia është masa alternative për mosfillimin, pezullimin ose pushimin e ndjekjes penale ndaj të miturit në konflikt me ligjin, sipas parashikimeve të KDPM-së. Shmangia nga ndjekja penale është një nga mjetet kryesore për të krijuar mundësinë që i mituri të rehabilitohet. Prokurori dhe/ose gjyqtari duhet të vlerësojnë si parësore mundësinë që të realizohet shmangia nga ndjekja penale. KDPM-ja parashikon edhe kushtet kur zbatohet masa e shmangies.

Aktiviteti 7:

Diskutim interaktiv:

Pyetje për debat:

Çfarë ndodh nëse i mituri e kundërshton në mënyrë kategorike masën e propozuar dhe thotë se refuzon të ulet në një tavolinë me viktimën që ka plagosur, sepse veprimi ndodhi për shkak se viktimja e diskriminonte në shkollë dhe e fyente para shokëve?

Kandidatët për magistratë diskutojnë në mënyrë interaktive se sa aktivë mund të jenë për të bindur të miturin për dobishmërinë e dhënies së masës së shmangies (nëse do të jemi në rolin e prokurorit apo të gjyqtarit në një situatë të ngjashme). Në fund të diskutimit pedagogu bën një rezymë të konkluzioneve.

Në mënyrë të veçantë masa e shmangies nga organi kompetent zbatohet nëse:

- a) ka prova të mjaftueshme për një dyshim të arsyeshëm se i mituri ka kryer një vepër penale, për të cilën parashikohet dënim me burgim deri në 5 vjet në maksimum ose me gjobë;
- b) i mituri pranon dhe shpjegon veprën penale në prani të mbrojtësit;
- c) i mituri nuk është kallëzuar për kryerjen e një vepre penale ose nuk është përsëritës;
- d) i mituri dhe, sipas rastit, përfaqësuesi i tij ligjor ose procedural japin pëlqimin me shkrim për zbatimin e shmangies;
- e) i mituri nuk ka marrë pjesë më parë në një program ku të jetë zbatuar masa e shmangies nga ndjekja penale dhe/ose e ndërmjetësimit;
- f) dënimi i të miturit për ato vepra nuk i shërben korrigjimit të sjelljes së tij;
- g) nuk ka një interes publik për fillimin e ndjekjes penale ose vazhdimin e ndjekjes penale të filluar.

4. Kriteret dhe kushtet për zbatimin e masës së shmangies nga ndjekja penale

Përparësia e masave alternative të shmangies në raport me ndjekjen penale

Masat alternative që synojnë shmangien e të miturit nga procedimi penal, ose zbatimi i masave të drejtësisë restauruese vlerësohen si mundësia e parë. Masa alternative e shmangies i shërben më mirë qëllimeve të rishoqërimit, rehabilitimit të të miturit dhe parandalimit të shkeljeve të ligjit, përkundërt vendosjes së tij nën përgjegjësinë penale dhe zbatimit të dënimit penal. Prokurori mund të vendosë zbatimin e masës së shmangies deri në momentin para se të ketë filluar shqyrtimi gjyqësor i çështjes: me iniciativën e tij ose me kërkesë të të miturit në konflikt me ligjin ose përfaqësuesit të tij.

Organi kompetent në çdo rast vlerëson paraprakisht në nivel makro:

- mundësinë e marrjes së masës së shmangies,
- interesin më të lartë të të miturit,
- rëndësinë e veprës penale të kryer dhe rrezikshmërinë e saj;
- dënimin e parashikuar për atë vepër,
- moshën e të miturit,
- shkallën e fajësisë,
- dëmin e shkaktuar,
- efektin frikësues të ndjekjes penale,
- sjelljen e të miturit pas kryerjes së veprës penale, në raport me shkallën e rrezikshmërisë së të miturit, si dhe raportin e vlerësimit individual.

Vlerësimi i masës konkrete të shmangies për të miturin nisët nga vlerësimi individual i tij dhe nga natyra e veprës penale. Masa alternative duhet të jetë:

- përshtatshme,
- e mundshme, dhe
- e nevojshme.

Aktiviteti 8:

Punë e pavarur në grup:

Si vlerësohet përshtatshmëria e dhënies së masës së shmangies?

Për të ndihmuar debatin, hidhet për diskutim një situatë praktike konkrete:

- Gjyqtari dha dënimin alternativ për A.M-në me punë në shërbim të komunitetit, duke specifikuar se i mituri duhet të shkonte për dy muaj të kujdesej 4 orë në ditë për pastrimin e lulishtes së Spitalit Rajonal;
- Pas dy javëve nga fillimi i ekzekutimit të masës alternative të shmangies, i mituri refuzon përmbushjen e masës;
- Pasi prokurori merr shpjegim nga i mituri për arsyet, ky i thotë: “Më tallin shokët pse merrem me pastrim e mbaj fshesë në dorë si gratë”;
- Për këtë arsye i mituri shprehet: “Dua dënim me burg, se burgu është për burrat.”.

Bëhet ndarja e auditorit në 3-4 grupe në varësi të numrit të pjesëmarrësve, ku në secilin grup janë 4-5 kandidatë për magjistratë.

Çdo grup analizon me kujdes temën e debatit dhe fokusohet në diskutimin e alternativave të mundshme për të shmangur dënimin me burgim të të miturit.

Pastaj çdo grup përgatit konkluzionet me shkrim.

Grupi zgjedh një prezantues, i cili do të prezantojë përpara auditorit konkluzionin e arritur.

5. Vlerësimi i kushteve të shmangies dhe përshtatshmërisë së masës lidhur me veçoritë e çdo rasti dhe çdo të mituri

Prokurori çmon nëse konkurrojnë disa kushte, si mosha e re e të miturit, rrezikshmëria e ulët e veprës penale, kryerja e veprës penale për herë të parë, mundësitë e rehabilitimit të të miturit, që të zbatohet shmangia nga ndjekja penale. Prokurori me iniciativën e tij vlerëson nëse është në interes të të miturit që ai të ndjekë një proces ndërmjetësimi për zgjidhjen e konfliktit me qëllim shmangien nga ndjekja penale. Në rastet kur masa e shmangies merret me iniciativën e prokurorit, ai i propozon të miturit në konflikt me ligjin, masën e shmangies nga ndjekja penale dhe në rast se i mituri jep pëlqimin, prokurori vendos përfundimisht zbatimin e saj. Në rast se propozimi i prokurorit për shmangien nuk pranohet nga i mituri, mbahet një procesverbal, në të cilin pasqyrohen arsyet e mospranimit të saj nga i mituri. Procesverbali nënshkruhet nga prokurori dhe i mituri ose, sipas rastit, përfaqësuesi i tij ligjor ose procedural.

Procedura për zbatimin e masës së shmangies me kërkesën e të miturit

I mituri në konflikt me ligjin ose përfaqësuesi i tij, me kërkesë të arsyetuar, i kërkon prokurorit zbatimin e masës së shmangies. Prokurori vendos për zbatimin ose jo të masës së shmangies me vendim të arsyetuar. Në rast se prokurori refuzon kërkesën, i mituri ose përfaqësuesi i tij ka të drejtë që të kërkojë në gjykatë brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit për vendimin e refuzimit, zbatimin e masës së shmangies nga ndjekja penale.

Procedura dhe zbatimi i masës së shmangies nga gjykata

Zbatimi i masës së shmangies mund të vendoset, sipas rastit, edhe nga gjykata: kryesisht ose me kërkesë të arsyetuar të palëve, punonjësit social ose psikologut. Gjykata mund të vendosë:

- ◇ kthimin e çështjes prokurorit për të proceduar me zbatimin e masës së shmangies. Para marrjes së këtij vendimi, gjykata dëgjon të miturin dhe merr pëlqimin e tij, ose,
- ◇ zbatimin e masës së shmangies në fazën e gjykimit deri para marrjes së vendimit përfundimtar.

Pasojat e zbatimit të masës së shmangies

- Zbatimi i masës së shmangies nga prokurori është rrethanë për mosfillimin e procedimit penal, nëse procedimi penal nuk ka filluar, dhe pushimin e tij nëse procedimi penal ka filluar;
- Ky vendim i njoftohet drejtuesit të prokurorisë dhe viktimës, me qëllim që ky i fundit, sipas rastit, të ketë mundësi të kërkojë dëmshpërblim;

- Ky vendim i njoftohet edhe mbrojtësit të të miturit, përfaqësuesit ligjor dhe/ose procedural të tij;
- Në rastin e vendosjes së masës së shmangies, prokurori merr vendimin për mosfillimin e çështjes penale ose pushimin e saj dhe lidh një marrëveshje me të miturin për llojin e masës së shmangies dhe/ ose ndërmjetësimin;
- Marrja e masës së shmangies nga ndjekja penale bëhet vetëm me pëlqimin me shkrim të të miturit dhe, kur është e përshtatshme, edhe nga përfaqësuesi i tij ligjor;
- Organi kompetent mund të caktojë një përfaqësues procedural, i cili mund të japë pëlqimin për masën e shmangies;
- Para marrjes së pëlqimit, të miturit i sigurohet mundësia e këshillimit dhe ndihmës ligjore;
- Gjatë negociimit të marrëveshjes për marrjen e masës së shmangies, i mituri ndihmohet nga mbrojtësi;
- Marrëveshja, nënshkruhet nga i mituri dhe nga mbrojtësi i tij.

Veprimet që kryen prokurori lidhur me shmangien

Prokurori vë në dijeni të miturin/mbrojtësin e tij dhe e ndërgjegjëson atë për përparësitë e shmangies dhe programeve të drejtësisë restauruese. Nëse i mituri e pranon shmangien me ndërmjetësim, atëherë prokurori zbardh në procesverbal pëlqimin ose mospranimin e të miturit për shmangien/ndërmjetësimin dhe njofton ndërmjetësin.

Mund të ndodhë që i mituri është njohur paraprakisht vetë, nga prindërit ose nga mbrojtësi i tij, me alternativat e shmangies së ndjekjes penale dhe mund të kërkojë vetë zbatimin e shmangies, përmes një programi të drejtësisë restauruese apo të ndërmjetësimin.

Përpara fillimit të procedurës së ndërmjetësimin, ndërmjetësi është i detyruar që të informojë palët për qëllimet dhe parimet e përgjithshme, rolin e ndërmjetësit dhe efektet e marrëveshjes së ndërmjetësimin. Palët dhe ndërmjetësi nënshkruajnë bashkërisht, me shkrim, deklaratën ose marrëveshjen për dhënien e pëlqimit për realizimin e procesit të ndërmjetësimin.

Përgatitja e palëve

Parapërgatitja e palëve vlerësohet duke u bazuar në nevojat e palëve nga ana e ndërmjetësit/ndërmjetësve. Parapërgatitja është e rekomandueshme dhe e domosdoshme veçanërisht në rastet e mosmarrëveshjeve komplekse, ku pjesëmarrës mund të jenë më shumë se dy palë. Ndërmjetësi, pas vlerësimeve të bëra sipas rastit, përgatitet dhe u propozon palëve një seancë për ndërgjegjësimin e tyre mbi procedurën e ndërmjetësimin, rregullat bazë që duhen njohur etj.

Aktiviteti 9:

Diskutim interaktiv: Ndërgjegjësimi i palëve për ndërmjetësimin. Çfarë mund të përmbajë ndërgjegjësimi për personat e përfshirë në procesin e ndërmjetësimin?

(Diskutohet për çështje të tilla, si: edukimi përmes procesit, përparësitë e ndërmjetësimin, kuptimi i dëgjimit aktiv, zgjidhja e problemeve bazuar në interesat e përbashkëta, rehabilitimi i të miturit në konflikt me ligjin etj. Rregullat bazë që duhen njohur dhe respektuar nga pjesëmarrësit në seancat e ndërmjetësimin. Komunikimi). Në mbyllje të debatit pedagogu bën një rezymë të konkluzioneve të diskutimit.

6. Kushtet kur zbatohet programi i drejtësisë restauruese

Programi i drejtësisë restauruese, mund të zbatohet nëse:

- a) i mituri, mbrojtësi dhe, sipas rastit, përfaqësuesi ligjor, japin lirisht pëlqimin për marrjen e një vendimi të tillë;
- b) çdo marrëveshje për korrigjimin e pasojave të veprës penale të kryer nga i mituri është e arsyeshme;
- c) çdo marrëveshje për korrigjimin e pasojave të veprës penale të kryer nga i mituri është e përshtatshme.

Në rastin e ndjekjes së një procedure ndërmjetësimi, ndërmjetësi duhet të kryejë veprimet si më poshtë:

1. Pranon dhe regjistron elektronikisht të gjitha çështjet që referohen në shërbimin e ndërmjetësimi dhe ruan dokumentet shoqëruese të tyre;
- Bashkëpunon me kancelarin e gjykatës pas referimit të çështjes nga ana e gjyqtarit, si dhe merr informacionin përkatës;
 - Njofton palët e përfshira në çështje dhe i ndihmon ato të zgjedhin ndërmjetësin për çështjen e tyre;
 - Fillon seancat e ndërmjetësimi në një vend të përshtatshëm, për të cilin është rënë dakord me palët. Procedura ligjore për ndërmjetësim fillon në datën për të cilën palët kanë rënë dakord;
 - Në qoftë se njëra nga palët i drejtohet shërbimit të ndërmjetësimi, duke kërkuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes nëpërmjet ndërmjetësimi, ky i fundit i drejton një kërkesë palës tjetër. Nëse pala tjetër nuk i përgjigjet kërkesës brenda 30 ditëve nga data që i është dërguar ftesa, ose brenda afatit kohor të përcaktuar në vetë ftesën, atëherë heshtja do të konsiderohet si mospranim;
 - Kur pala pranon, atëherë ndiqet procedura për caktimin e ndërmjetësit. Palët mund të caktojnë edhe më shumë se një ndërmjetës. Kur zgjidhen dy ndërmjetës, atëherë secila nga palët ka të drejtë të vendosë për njërin prej tyre. Kur ndërmjetësimi do të bëhet nga më shumë se dy ndërmjetës, atëherë secila nga palët zgjedh nga një dhe për të tjerët vendosin bashkërisht;
 - Shërbimi i ndërmjetësimi, do të njoftojë ndërmjetësin dhe do t'i kërkojë atij që të caktojë datën e takimit të parë me palët;

- Pas marrjes së njoftimit për datat e propozuara të takimit të parë, qendra/ ndërmjetësi do t'ua bëjë ato të njohura palëve dhe do t'u kërkojë atyre datën më të përshtatshme për zhvillimin e takimit me ndërmjetësin;
- Në takimin e parë diskutohet për kohëzgjatjen orare dhe kalendarike të procesit, datën e fillimit të tij dhe grafikun e zhvillimit të procesit; për rregullat, procedurat dhe kodet që do të zbatohen nga ndërmjetësi dhe palët gjatë procesit; për shpenzimet shtesë të procesit, në qoftë se ato nuk janë përcaktuar në takimin paraprak me palët;
- Në rast se në takimin e parë të ndërmjetësit me palët, sipas pikës 4.6 të ligjit "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve", nuk arrihet marrëveshje për problemet e diskutuara, procesi nuk zhvillohet dhe ndërmjetësi u ofron palëve përsëritjen e procedurës për caktimin e ndërmjetësit;
- Ndërmjetësi mund ta zhvillojë procesin e ndërmjetësimit duke komunikuar me të dyja palët së bashku në të njëjtën kohë ose veçmas me secilën prej tyre, duke bërë kujdes për të manifestuar një sjellje të paanshme. Në rast të takimeve dhe seancave të ndara, ndërmjetësi mund t'u japë informacion përkatës palëve për bisedat me palën e kundërt me kusht që një gjë e tillë të pranohet prej palëve;
- Çdo e dhënë që del gjatë procesit të ndërmjetësimit mbetet konfidenciale;
- Neni 12 i ligjit "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve" parashikon se prova, të tilla si: ftesa për ndërmjetësim, mendimet e sugjerimet e palëve gjatë procesit, deklaratat dhe pohimet e tyre, propozimet e bëra nga ndërmjetësi, dokumentet e përgatitura vetëm për qëllim ndërmjetësimi nuk mund të përdoren si prova në një proces gjyqësor, që mund të zhvillohet pas atij të ndërmjetësimit. Me përjashtim të tyre, çdo provë tjetër e ndryshme mund të paraqitet në proceset e zgjidhjeve ligjore me anë të alternativave të tjera;
- Procedura e ndërmjetësimit mbaron me arritjen e marrëveshjes për ndërmjetësim ose me deklaratat me shkrim të palëve që pranojnë se procedura e ndërmjetësimit ka mbaruar me ose pa sukses;
- Në përgjigje të referimit të çështjes nga ana e gjykatës, ndërmjetësi përgatit shkresën përcjellëse për gjykatën, duke e informuar për rezultatin e procesit të ndërmjetësit, duke bashkëngjitur dhe dokumentacionin përkatës;
- Informon kryetarin dhe kancelarin e gjykatës, nëse nevojitet, për statistikat e rasteve të referuara nga gjyqtarët, për çështjet e ndërmjetësuara ose për ecurinë e procesit të ndërmjetësimit.

Aktiviteti 10:

Punë e pavarur në grup:

Praktikë gjyqësore. Vendimi nr. 2931, datë 6.11.2018 i GJRRGJ-së Tiranë

- I pandehuri është i mitur në shkollën e mesme, klasa e dhjetë (mosha nën 16 vjeç), ka kryer vjedhje më shumë se një herë dhe është kapur në flagrancë duke vjedhur dy kanoçe "Neskafe" në një supermarket te lagjja "Don Bosko".
- Vepra penale: "Vjedhja më shumë se një herë", neni 134/2 i KP-së".
- Ana subjektive: Vepra penale është kryer me faj. Ai e ka ditur që ky veprim është i paligjshëm dhe ka kryer disa herë vjedhje në supermarkete të ndryshme për sende me natyrë ushqimore, gjatë muajit mars çdo dy-tre ditë.
- Provat: I mituri është filmuar nga kamerat e subjekteve tregtare dhe ka qenë me të njëjtën veshje gjithmonë, (xhup jeshil dhe kapele e zezë);
- Procesverbali i kapjes në flagrancë, (është kapur me vrap nga punonjësi i supermarket pasi ka lënë dyqanin);
- Rrezikshmëria e veprës është e madhe ngaqë konsiderohet krim dhe jo kundravajtje penale;
- Rrethanë lehtësuese se i mituri shfaq pendim të thellë;
- Nga vlerësimi individual rezulton se:
 - a) Sjellja mund të përmirësohet përmes vazhdimit të shkollës;
 - b) Shmangia është më e përshtatshme.
- Gjykata vlerëson:
 - Sipas nenit 104 të KDPM-së vepra ka rrezikshmëri të ulët;
 - Interesi më i lartë i fëmijës vlerësohet që të ketë shmangie;
 - Çmohet që ka shpresa për të rehabilituar të miturin nga pikëpamja sociale;

- Gjykata vendos:

- Deklarimin fajtor;
- Uljen e dënimit të dhënë në 1/3 duke e dënuar përfundimisht me 2 muaj;
- Pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim për një afat prove 4 muaj;
- Të mos shoqërohet me persona të dënuar në zbatim të nenit 102/1 të KDPM-së.

Bëhet ndarja e auditorit në 3-4 grupe në varësi të numrit të pjesëmarrësve, ku në secilin grup janë 4-5 kandidatë për magjistratë.

Çdo grup analizon me kujdes temën e debatit dhe fokusohet në diskutimin nëse ka një ndarje të dukshme midis dënimeve alternative dhe masave të shmangies nga dënimi penal për të miturit.

Kur gjyqtari mbështetet te KDP-ja për shmangien, a mund të japë dënim dhe ta shpallë të pandehurin fajtor? A mund të argumentohet sipas dispozitave të KDPM-së për shmangien dhe pastaj i mituri të deklarohet fajtor?

Pastaj çdo grup përgatit konkluzionet me shkrim.

Grupi zgjedh një prezantues, i cili do të prezantojë përpara auditorit konkluzionin e arritur.

Kufijtë e marrëveshjes për shmangien nga ndjekja penale që bëhet në kuadrin e një programi të drejtësisë restauruese, mund të parashikojë që të miturit t'i kërkohet:

- a) të pranojë dhe të tregojë se e kupton përgjegjësinë për veprën penale dhe të pasojës së ardhur ndaj viktimës;
- b) të kompensojë dëmin e shkaktuar viktimës, komunitetit dhe/ose shoqërisë;
- c) t'i kërkojë falje viktimës; dhe
- ç) të ndërmarrë veprime të pranueshme edhe nga viktimë ose/dhe komuniteti,
- d) të marrë pjesë në një procedurë ndërmjetësimi;
- dh) të kryejë punë me interes publik;
- e) të marrë pjesë në programe rehabilituese lidhur me pasojat e veprës penale.

Kushtëzimi i vendimit të zbatimit të masës së shmangies. Prokurori mund të vendosë pezullimin e hetimit, me qëllim zbatimin me kusht të masës së shmangies nëse i mituri në konflikt me ligjin kërkon dhe garanton përmbushjen e detyrimeve të tilla si:

- a) riparimi ose kompensimi i dëmit të shkaktuar nga vepra penale, sipas aftësive të tij dhe sipas rastit;
- b) përfshirja në programe të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimi;
- c) përfshirja në punët e një organizate humanitare ose në veprimtaritë e komunitetit ose të mbrojtjes së mjedisit;
- ç) trajtimi prej varësisë nga droga ose varësive të tjera.

Përmbushja e masave alternative për shmangien nga ndjekja penale. Në rast se i mituri përmbush detyrimet, prokurori vendos përfundimisht për pushimin e procedimit penal ndaj tij.

Nëse për të miturin që ka kryer një vepër penale, është dhënë një masë alternative për shmangien nga ndjekja penale dhe kjo masë është përmbushur, ndaj tij nuk mund të ngrihet asnjë akuzë në lidhje me po këtë vepër penale. Nëse i mituri i përmbush detyrimet, sipas marrëveshjes së shmangies, prokurori vendos menjëherë pushimin e çështjes.

I mituri që ka përmbushur një masë alternative për shmangien nga ndjekja penale nuk do të konsiderohet si i dënuar për një vepër penale dhe nuk do të trajtohet si person me të kaluar kriminale. Përmbushja e masës së shmangies nga ndjekja penale realizohet dhe mbikëqyret nga Shërbimi i Provës, në bashkëpunim me shërbimin e ndërmjetësimi.

Mospërmbushja e masave alternative për shmangien nga ndjekja penale. Nëse i mituri, me qëllim, nuk e përmbush masën për shmangien e ndjekjes penale, Shërbimi i Provës informon për këtë me shkrim prokurorin, duke shpjeguar në mënyrë të detajuar kohën, vendin, mënyrën dhe rrethanat e mospërmbushjes dhe situatën personale të të miturit. I mituri, prindërit ose, sipas rastit, përfaqësuesi ligjor, informohen nga Shërbimi i Provës lidhur me pasojat e moszbatimit të kushteve dhe detyrimeve të masës së shmangies dhe rregullat e shqyrtimit në rast mospërmbushjeje. Mospërmbushja e kushteve dhe detyrimeve që burojnë prej masës së shmangies nga ndjekja penale nuk përbën vepër penale dhe nuk sjell automatikisht kufizimin ose heqjen e lirisë së të miturit. Edhe në këtë rast, heqja e lirisë, konsiderohet nga organet kompetente si masa e fundit.

Procedura në rast mospërmbushjeje të masave alternative për shmangien nga ndjekja penale

Në rast mospërmbushjeje, prokurori mund të japë një vendim për ndryshimin ose revokimin e pjeshëm ose të plotë të masës së shmangies pasi ka bërë një shqyrtim të detajuar të fakteve të raportuara.

Prokurori, në çdo rast, cakton një seancë të veçantë dëgjimore, merr mendimin e të miturit, i cili paraqet arsyet lidhur me mospërbushjen e masës. Nëse do të jetë e nevojshme, prokurori, mund të kërkojë një vlerësim të ri psikologjik, psikiatrik ose të kërkojë mendim për raportet e mëparshme të ekspertëve. Prokurori pasi e rishqyrton këtë masë, si edhe masa të tjera, kontakton të miturin, përfaqësuesin e tij ligjor dhe dëgjon mendimin e punonjësit të Shërbimit të Provës, dhe mund të vendosë:

- a) revokimin ose lënien në fuqi të vendimit për shmangien nga ndjekja penale;
- b) ndryshimin e llojit të masës së shmangies;
- c) zgjatjen e kohës së marrëveshjes.

Nëse organi procedues vendos që të rifillojë procedimi kundër të miturit, ai merr parasysh pjesën e masës që është përmbushur tashmë nga i mituri gjatë zbatimit të masës alternative të shmangies.

Në rast të revokimit të vendimit për shmangien, prokurori, me vendim të arsyetuar, vendos të shfuqizojë vendimin për mosfillimin e hetimit ose të vendimit të pushimit të çështjes së filluar dhe të vendosë rifillimin e hetimit.

Në rastin e revokimit të vendimit për shmangien, veprimet e kryera nga i mituri për të përmbushur masën e shmangies nga ndjekja penale do të shqyrtohen gjatë gjykimit. Pranimi i përgjegjësisë për një vepër penale, me qëllim që të zbatohet një masë alternative për shmangien nga ndjekja penale, nuk mund të përdoret gjatë gjykimit kundër të miturit.

Nëse i mituri, nuk përmbush detyrimet e veçanta që i janë urdhëruar ose në qoftë se refuzon ose, në mënyra të tjera, ndërhyt në zbatimin e masës së mbikëqyrjes së vazhdueshme, gjykata, nëse është e mundur, mund të vendosë që, për këtë arsye, i mituri të vendoset në një qendër/institucion disiplinor/edukues për qëndrim të pandërprerë për jo më shumë se një muaj.

7. Shmangia nga ndjekja penale përmes ndërmjetësimit familjar dhe ndërmjetësimit në grup

Mund të themi se nga mënyra se si është shprehur ligjvënësi mund të duken si dy lloj ndërmjetësimesh të ndërlidhur me njëri tjetrin, nga elementi familjar, por mund të jetë edhe një lloj ndërmjetësimi i vetëm. Lidhëza “dhe” që i lidh të dy krijon idenë e një përfshirje me karakter kumulativ, në kuptimin se ndërmjetësimi familjar mund të jetë në të njëjtën kohë edhe ndërmjetësim në grup, ku në përbërjen e secilës prej palëve janë dy ose më shumë përfaqësues nga familja e viktimës dhe nga familja e të akuzuarit të mitur. Pika 6, e nenit 63, i referohet më tepër rastit kur nga njëra anë është jo vetëm i akuzuari, por edhe familja e tij. Pra, mjafton që në njërin nga palët të ketë më shumë se dy persona, që atëherë ndërmjetësimi të konsiderohet në grup. Por, termi “**ndërmjetësim në grup**” mund të ndeshet edhe në marrëdhëniet jofamiljare. Për shembull, kur në një konflikt penal janë përfshirë dy ose më shumë të akuzuar dhe/ose dy ose më shumë se dy viktima, të cilët bashkohen të gjithë në të njëjtën procedurë ndërmjetësimi. Ky lloj ndërmjetësimi në grup zakonisht realizohet kur personat kanë më shumë se një lidhje që i sjell bashkë me njëri-tjetrin, të tilla si: mosha, shkolla, e të tjera. Ata mund të jenë shokë klase, banojnë në të njëjtin pallat, luajnë në të njëjtin ekip futbollit e të tjera.

Mundësia e pjesëmarrjes së personave të tjerë përveç palëve në procesin e ndërmjetësimit, parashikohet në pikën 6 të nenit 63, e cila nënvizon se prania e të tjerëve është në diskrecionin e palëve. Pra, ky pëlqim është dytësor kundrejt pëlqimit parësor të vetë palëve për të hyrë në procedurën e ndërmjetësimit. Këto janë negociata të dyta dhe që nuk kanë të bëjnë me thelbin, por me pjesëmarrësit në proces ndaj edhe ndryshon pëlqimi i palëve. Sipas pikës 6 të nenit 63, në procesin e ndërmjetësimit mund të marrin pjesë krahas palëve, edhe persona të tjerë. Këtu listohen: familjarët, mbrojtësit, përfaqësuesi ligjor i të miturit, psikologu, punonjësi i Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, e të tjerë. Dispozita nuk shpjegon rolin e këtyre personave dhe qëllimin e pjesëmarrjes së tyre në procesin e ndërmjetësimit, megjithatë mund të themi se, edhe po t'i analizojmë të gjithë së bashku në grup, ashtu edhe kur i shohim veçmas, secili nga personat e listuar si “të tjerë” është person që ofron dhe siguron mbrojtje sa më të mirë dhe sa më të kujdesshme të interesave të të miturit dhe parandalimin e kryerjes së veprës në të ardhmen si rezultat i hakmarrjes.

Zbatimi i masave alternative për shmangien e ndjekjes penale, mund të shoqërohen rast pas rasti me sesione ndërmjetësimi ku marrin pjesë bashkërisht me viktimën dhe të miturin në konflikt me ligjin, edhe të afërmit e tyre, persona nga rrethi i tyre shoqëror, përfaqësues nga agjenci publike për mbrojtjen e të miturve, mbikëqyrjen e tyre dhe parandalimin e kriminalitetit për të miturit. Në këtë proces i akuzuari dhe familja e tij pritet të arrijnë një **marrëveshje** me viktimën, e cila përfshin kompensimin e dëmit, kryerjen e detyrimeve që janë të pranueshme prej viktimës dhe që pritet të mbajnë të akuzuarin larg situatave konfliktuale të ngjashme në të ardhmen.

Procedura e ndërmjetësimit realizohet jashtë prokurorisë dhe gjykatës dhe ndonëse është më e thjeshtë dhe me më pak solemnitet sesa procedura gjyqësore, përsëri ndjek rregullat e saj. Rregullat që duhen respektuar

në seancën e ndërmjetësimit, janë të tilla si: të mos përcaktohet faji dhe gabimi, por të shihet se si mund të balancohen interesat e palëve, palët të respektojnë njëri-tjetrin; të mos zgjaten shumë në shpjegime e komente dhe të mos dalin jashtë teme; të flasin me radhë dhe të mos ndërpresin njëri-tjetrin; të trajtojnë problemin pa e personalizuar; të mos fyejnë pjesëmarrësit e tjerë; çdo pjesëmarrës të dëgjojë në mënyrë aktive dhe të përpiqet t'i kuptojë të tjerët, të demonstrojë një qëndrim të paanshëm ndaj opinionëve të kundërta; të fokusohet tek interesat, jo te pozicionet; të jetë krijues dhe reflektues; të fokusohet tek e ardhmja, jo tek e shkuara, e të tjera të ngjashme me to.

Modeli i vendimit të ndërmjetëm që përdoret nga gjykata për të referuar çështjet për ndërmjetësim. Ky model përmban emrin e gjyqtarit, të dhënat për palët, referencën ligjore, vendimin për t'i ftuar palët në ndërmjetësim dhe për ta referuar çështjen në zyrën e ndërmjetësimit, si dhe afatin kohor të përcaktuar nga gjyqtari. Vendimi i paraqitur në zyrën e ndërmjetësimit i shërben koordinatorit si referencë, kur ai i raporton gjykatës mbi rezultatet e procesit të ndërmjetësimit.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**

**VENDIM
PËR KALIMIN E ÇËSHTJES TE SHËRBIMI I NDËRMJETËSIMIT**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor _____, e përbërë prej _____, sot më datë _____, pasi informon palët në këtë gjykim penal të filluar me kërkesën e personit të dëmtuar akuzues në çështjen ku përfshihen si më poshtë:

I dëmtuari akuzues:

Personi i akuzuar:

Lloji i veprës/kundërvajtjes penale:

Baza ligjore:

KONSTATON:

Referuar nenit 59/284 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe nenit 2 dhe 13 të ligjit nr. 10385, datë 24.2.2011, “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, çështja e mësipërme e ardhur për gjykim, duke pasur në vëmendje rrethanat dhe palët, ka vend dhe çmohet se mund të zgjidhet me ndërmjetësim, dhe

PËR KËTË ARSYE:

Gjykata, bazuar në nenet 59 dhe 284 të Kodit të Procedurës Penale,

VENDOSI:

- Ta referojë çështjen për zgjidhje me ndërmjetësim.
- Afati për paraqitjen në gjykatë të marrëveshjes për ligjërimin e kësaj zgjidhjeje ose për vazhdimin e gjykimit është:

_____, datë _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR _____

VENDIM

Për kalimin e çështjes te shërbimi i ndërmjetësimit

Gjykata e Rrethit Gjyqësor _____ e përbërë prej _____, sot më datë _____, pasi informon palët në këtë gjykim penal të filluar me kërkesën e personit të dëmtuar akuzues në çështjen ku përfshihen si më poshtë:

I dëmtuari akuzues:

Personi i akuzuar:

Lloji i veprës/kundërvajtjes penale:

Baza Ligjore:

KONSTATON

Referuar nenit 59/284 Kodit të Procedurës Penale, si dhe nenit 2 dhe 13 të ligjit 10 385, datë 24/02/2011, "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve", çështja e mësipërme e ardhur për gjykim, duke pasur në vëmendje rrethanat dhe palët, ka vend dhe çmohet se mund të zgjidhet me ndërmjetësim,

PËR KËTË ARSYE

Gjykata, bazuar në nenet 59 dhe 284 të Kodit të Procedurës Penale,

VENDOSI

- Ta referojë çështjen për zgjidhje me ndërmjetësim.

- Afati për paraqitjen në gjykatë të marrëveshjes për ligjërimin e kësaj zgjidhjeje ose për vazhdimin e gjykimit është:

_____ datë _____

Ndërmjetësimi si procedurë jashtëgjyqësore zhvillohet nga ndërmjetësi sipas dispozitave të KDPM-së dhe të ligjit për ndërmjetësimin. Ndërmjetësimi mund të zhvillohet vetëm nëse ekziston pëlqimi i lirë për ndërmjetësim, i shprehur si nga i mituri i akuzuar për veprën penale dhe nga pala e dëmtuar. Dhënia e pëlqimit duhet të shënohet në procesverbalin e organit procedues. Ndërmjetësimi mund të zhvillohet vetëm me pjesëmarrjen personale të të miturit autor i veprës penale dhe palës së dëmtuar. Në procesin e ndërmjetësimit, me pëlqimin e palëve, mund të marrin pjesë gjithashtu, përfaqësuesi ligjor i të miturit, psikologu, punonjësi i Njesisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, prokurori dhe/ose personat e tjerë të caktuar prej tij. Prokurori mund të marrë pjesë në procesin e ndërmjetësimit nëse ai e çmon këtë.

Ndërmjetësimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, sipas rastit, mund të zbatohet edhe si masë shmangieje, por edhe si një mundësi që çon në përmirësimin e marrëdhënieve midis të miturit autor dhe viktimës së veprës penale. Prokurori gjatë hetimit dhe gjyqtari gjatë gjykimit, sipas rastit, mund të propozojnë ndërmjetësimin nëse vlerësojnë se kjo alternativë është më e përshtatshme, duke pasur parasysh natyrën e veprës penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, historinë e të miturit, mundësinë e kthimit të raporteve normale mes të miturit dhe palës së dëmtuar, mundësinë e zvogëlimit të dëmit të palës së dëmtuar, mundësinë e rehabilitimit të të miturit dhe riintegrimin e tij në shoqëri.

Në rast se propozimi i prokurorit/gjyqtarit për ndërmjetësim pranohet nga palët, atëherë prokurori/gjyqtari vendos pezullimin e procesit penal për një afat jo më shumë se 45 ditë. Nëse marrëveshja e ndërmjetësimit arrihet, prokurori/gjyqtari vendos pushimin e çështjes. Nëse marrëveshja e ndërmjetësimit nuk arrihet me kalimin e 45 ditëve, pezullimi bie dhe vazhdon hetimi/gjykimi i çështjes.

Studime rastesh nga praktika ndërkombëtare

Praktikë ndërkombëtare

- 3 të mitur dhe një 18-vjeçar u arrestuan më 28 shtator në Johnston High School, tre javë pas një incidenti në shtëpinë e një prej të pandehurve, Morgan Hough, në Iowa, SHBA. Një urdhër kërkimi zbuloi një video të regjistruar që tregonte se i dëmtuari 15-vjeçar ishte mbytur dhe goditur me shkelma ndërkohë që ishte pa ndjenja.
- Drejtuesit e shkollës njoftuan policinë pasi morën raporte anonime për rrahjen. Autoritetet pastaj intervistuan viktimën dhe prindërit e tij, të cilët thoshin se e gjetën djalin e tyre pa ndjenja në oborrin e shtëpisë, të veshur me rrobat e dikujt tjetër.
- Viktima i tha policisë se ai piu alkool dhe se ai nuk mbante mend se çfarë ndodhi midis orës 6:30 dhe 7 pasdite. Nxënës të tjerë i kishin thënë se ai ishte rrahur vazhdimisht dhe abuzuar seksualisht. Këtë gjë e treguan edhe provat e depozituara në gjykatë.
- Policia gjithashtu gjeti edhe përdorim të paautorizuar të kartës së kreditit të viktimës për video-lojëra online, si dhe për porosi në McDonald's.
- Mbi adoleshentët rëndonin akuzat e abuzimit seksual të shkallës së dytë, vjedhje e shkallës së parë, rrahje dhe shfrytëzim i të miturit.

Jurisprudencë e GJEDNJ-së

Rasti Lambert dhe të tjerët kundër Francës, 25.6.2015³¹. "161. Gjykata vëren se ligji francez, siç është aktualisht, parashikon që familja të konsultohet (dhe jo të marrë pjesë në marrjen e vendimit), por nuk parashikon ndërmjetësim në rast mosmarrëveshjeje midis anëtarëve të familjes dhe nuk përcakton rendin në të cilin duhet të merren parasysh pikëpamjet e anëtarëve të familjes, ndryshe nga disa vende të tjera".

Neshkov dhe të tjerët kundër Bullgarisë - 36925/10 et al. Vendimi 27.1.2015³². Çështja kishte të bënte me kushtet në mjediset e vuajtjes së dënimit në disa institucione të vuajtjes së dënimit në Bullgari. Kërkuesit pretenduan shkeljen e nenit 3 të Konventës dhe kërkuesi i parë (Z. Neshkov) pretendoi gjithashtu shkeljen e nenit 13 për shkak të mungesës së mjeteve mbrojtëse të efektshme të brendshme. Gjykata i ka shqyrtuar edhe më parë kushtet e vuajtjes së dënimit në Bullgari sipas nenit 3 në më shumë se 20 çështje të tjera. Nga ana e tij, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës kishte theksuar vazhdimisht nevojën e masave shtesë për të përmirësuar kushtet e vuajtjes së dënimit në institucionet e vuajtjes së dënimit në Bullgari, në përputhje

³¹ Lidhja: <http://hudoc.echr.coe.int/eng#w%7Bitemid%7D%3A%28%22001-155352%22%29%7D>

³² Lidhja: <http://hudoc.echr.coe.int/eng#w%7Bfulltext%7D%3A%22ECHR%20decision%20of%2027.1.2015%22%7D>

me standardet e Konventës. GJEDNJ-ja nënvizon se: "... 19. Prokurorët dhe gjyqtarët duhet të përfshihen në procesin e hartimit të politikave penale në lidhje me mbipopullimin e burgjeve dhe inflacionin e popullatës së burgut, me synimin për të shprehur mbështetjen e tyre dhe për të shmangur praktikat kundërproduktive të dënimit. 90. Sa i përket hapave që mund të ndërmerren për të zvogëluar numrin e personave që dërgohen në burg, ... prokurorëve mund t'u jepen kompetenca për të përdorur alternativa ndaj ndjekjes penale, si: paralajmërime formale, ndërmjetësim dhe programet e dëmshpërblimit ose puna në komunitet, në fillim të procesit penal, por me monitorimin e duhur për të zvogëluar rrezikun e korrupsionit. Në vitin 2013, 22 029 persona u mbajtën në paraburgim, duke kaluar mesatarisht dyzet e një ditë në paraburgim. Kjo do të thotë se paraburgimi përdorej në mënyrë rutinë në lidhje me akuza të caktuara dhe se alternativat ndaj paraburgimit mund të përdreshin për të ndikuar në numrin e personave në paraburgim". 70.2. "Nëse ndërmjetësimi duket i përshtatshëm, ai duhet të provohet i pari". 15. Në dhënien e ndëshkimeve dhe masave në komunitet që mund të përdoren në vend të privimit nga liria, duhet të merren në konsideratë si në vijim: ... ndërmjetësimi viktimë - shkelës / kompensimi". 20. Ligjvënësi ose autoritete të tjera kompetente duhet të përcaktojnë parimet e dënimit, me qëllim, ndër të tjera, uljen e përdorimit të burgimit, zgjerimin e përdorimit të sanksioneve dhe masave në komunitet dhe përdorimin e masave të shmangies, të tilla si: ndërmjetësimi ose kompensimi i viktimave".

Praktika kombëtare me shmangie nga ndjekja penale

Auditori ndahet në grupe me 4 – 5 kandidatë për magjistratë, të cilët e studiojnë rastin dhe pastaj bëjnë prezantimin e konkluzioneve të arritura.

Diskutimi shtrihet në këto drejtime:

Plani i parë i diskutimit: Imagjinoni sikur ju jeni prokurori i çështjes.

- 1) A mund të zbatohet shmangia nga ndjekja penale në këtë rast?
- 2) Përgatisni listën e kriterëve të përgjithshme dhe të kriterëve të posaçme që do të shqyrtoni në situatën konkrete. Vendosni nëse do të filloni kryesisht ndërmarrjen e veprimeve për zbatimin e një programi shmangie.
- 3) A është i mundshëm ndërmjetësimi në këtë rast?
- 4) Si do ta ndërgjegjësoni të miturin lidhur me masën e shmangies që do të merrni, nëse ajo lidhet me drejtësinë restauruese dhe ndërmjetësimin?
- 5) A do ta vlerësonit praninë e një psikologu apo punonjësi social, nëse e çmoni të nevojshme për të komunikuar më mirë me të miturin dhe për t'u siguruar që ai e kupton procesin?
- 6) A mendoni se do të ishte e nevojshme që të merrnit pjesë edhe ju vetë në ndërmjetësim? Nëse po, do të qëndroni pasiv apo do të jeni aktiv në proces? Si dhe sa do të përfshihenit në të?

Plani i dytë i diskutimit: Imagjinoni sikur ju jeni ndërmjetësi

1. Si do të ftoni palët që do të përfshihen në procesin e ndërmjetësimit? Cilët do të thërrisni në procesin e ndërmjetësimit?
2. Listoni veprimet që do të kryeni në fazën përgatitore.
3. Ndërtoni hapat që do të ndiqni në procedurën e ndërmjetësimit.
4. Si do t'i organizoni takimet me palët?
5. Çfarë do t'u shpjegoni palëve?
6. Cilat janë avantazhet e ndërmjetësimit?

USHTRIMI 1

Rrethanat e faktit:

- I.S në moshën 17-vjeçare bleu një makinë të re. Ndërsa po kalonte një kryqëzim humbi kontrollin dhe u përplas me një makinë tjetër, shoferi i së cilës ishte po një i ri 21-vjeçar i quajtur A.Z.
- I.S doli nga makina i nxehur dhe filloi të godiste personin tjetër.
- A.Z për t'u mbrojtur kapi një shufër hekuri dhe e goditi I.S-në në krah duke e plagosur.
- Pas kësaj ngjarjeje disa kalimtarë e çuan I.S-në në spital. Pas mjekimit I.S-ja u kthye në vendin e aksidentit për të vazhduar grindjen, por A.Z-ja ishte larguar pasi i kishte sqaruar ngjarjen punonjësve të policisë, të cilët më pas e kishin lënë të lirë.
- Kjo gjë e acaroi edhe më tepër të miturin që filloi të kërkonte A.A-në. Kur u takuan përsëri, situata u tensionua edhe më shumë. Ata filluan të grindeshin dhe u desh ndërhyrja e policisë që i shoqëroi në komisarjat. Çështja iu përcoll prokurorisë që të vijonin hetimet dhe të konstatohej nëse ishte plagosje e rëndë apo e lehtë.
- Prokurori i kërkoi të miturit të merrte në konsideratë edhe mundësinë e gjetjes së një zgjidhjeje paqësore. I mituri i plagosur pranoi të kontaktonte qendrën e ndërmjetësimit.

Vlerësimi individual

Të dhënat mbi personalitetin e të miturit në konflikt me ligjin:

- I mituri në konflikt me ligjin është nxënës shkolle me nivel të kënaqshëm në mësim;
- I padënuar më parë;
- Pranon dhe shpjegon veprën penale në prani të mbrojtësit;
- Familja e tij nuk ka të ardhura të kënaqshme dhe për këtë arsye i mituri punon me kohë të pjesshme në ditët e pushimit;
- Sillet shumë mirë në komunitet dhe familje.

USHTRIMI 2

Rrethanat e faktit

- I mituri në konflikt me ligjin G.LL duke qarkulluar me motorin tip Lifan me targa CAH 728, në Bulevardi Blu me drejtim lëvizjeje nga Tirana për në Kamëz ka aksidentuar duke përplasur shtetaset Q.T dhe A.Q, të cilat po kalonin rrugën nga ana e karburant “Kastratit”.
- Si pasojë e goditjes me mjet, të dyja shtetaset janë rrëzuar në trotuar dhe më pas janë dërguar për ndihmë mjekësore në Spitalin e Traumës.
- Shtetasi i mitur G.LL dispononte një leje drejtimi të kategorisë AM, e cila nuk ishte e përshtatshme për drejtimin e mjetit motor që ai drejtonte.
- Sipas aktit të ekspertimit mjeko-ligjor, A.Q dhe Q.T u janë shkaktuar dëmtime që kategorizohen si plagosje e lehtë pasi ka dëmtime që kanë shkaktuar humbje të aftësisë së përkohshme për punë në masën mbi 9 (nëntë) ditë.
- I mituri në konflikt me ligjin ka kryer veprat penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor” dhe “Drejtimin të automjeteve në mënyrë të parregullt” parashikuar nga nenet 290/1 dhe 291 të Kodit Penal.

Vlerësimi individual

Të dhënat mbi personalitetin e të miturit në konflikt me ligjin:

- I mituri në konflikt me ligjin është nxënës shkolle me nivel të kënaqshëm në mësim;
- I padënuar më parë;
- Pranon dhe shpjegon veprën penale në prani të mbrojtësit;
- Familja e tij nuk ka të ardhura të kënaqshme dhe për këtë arsye i mituri punon me kohë të pjeshme në ditët e pushimit;
- Sillet shumë mirë në komunitet dhe familje.

USHTRIMI 3

Rrethanat e faktit

- Më datë 8.4.2018 në Komisarriatin e Policisë nr. 6 Tiranë ka depozituar një kallëzim penal shtetasja M.I.
- Ajo ka konstatuar se në banesën e prindërve ishte vjedhur një profil hekuri, një lopatë dhe një bel. Ajo gjithashtu, ka konstatuar dy vatra zjarri në të cilat ishin djegur disa pemë që babai i saj i kishte mbjellë para se të vdiste. Ajo shpjegon se dyshimet kryesore i ka mbi nipin e saj R.B, që është nxënës në vitin e parë të shkollës së mesme “Myslym Shima”, Tiranë.
- Është pyetur i mituri R.D, i cili pranoi se materialet e hekurit i ka marrë ai nga banesa e gjyshërve dhe i ka shitur për 3 500 lekë duke menduar që ishin të vjetra dhe të ndryshkura dhe nuk i hynin në punë askujt. Ndërsa në lidhje me pemët e prera e të djegura, ai shpjegon se këtë veprim e ka kryer së bashku me të atin e tij, A.B.
- Është pyetur shtetasi A.B, i cili konfirmoi faktin se i ka prerë e djegur ai pemët e banesës duke konfirmuar edhe faktin se djali i tij kishte marrë disa materiale hekuri duke menduar se ishin sende që nuk përdreshin.
- Akuza është për kryerjen e veprës penale të “Vjedhjes” parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal ndaj të miturit në konflikt me ligjin.
- Gjatë hetimit dhe gjyqimit, i mituri ka mbajtur qëndrim pohues dhe pendues.

- Nga ana subjektive, vepra penale është kryer nga i pandehuri i mitur me faj në formën e dashjes direkte.
- Në seancën gjyqësore të datës 30.1.2019, nga ana e mbrojtjes së të miturit në konflikt me ligjin R.D u kërkua dhe zbatimi i masës së shmangies nga ndjekja penale për të miturin në konflikt me ligjin.

Vlerësimi individual

Të dhënat mbi personalitetin e të miturit në konflikt me ligjin:

- I mituri në konflikt me ligjin është nxënës shkolle me nivel të dobët në mësimet dhe shpeshherë bën mungesa në shkollë;
- Është i padënuar më parë;
- Pranon dhe shpjegon veprën penale në prani të mbrojtësit;
- Është i gatshëm të kërkojë falje;
- Sillet mirë në komunitet dhe familje.

USHTRIMI 4

Rrethanat e faktit

- Më datë 24.5.2018, rreth orës 12:57:47 dhe 12:59:41 është telefonuar nga një numër i fshehtë, ku në anën tjetër të telefonit është përgjigjur një zë femre. Ajo fillimisht i ka thënë: “Kur do më japësh ato provimet që kam ngel për vjeshtë?”.
- Pedagogia denoncuese i ka thënë: “E di se me kë je duke folur, se mos ke ngatërruar numër?”, por personi në anën tjetër të telefonit në këtë kohë e ka mbyllur telefonin.
- Pas rreth 2 minutash e kanë telefonuar përsëri me numër të fshehur, konkretisht në orën 12:59:41 sekonda, sipas orës së celularit “Blacberry” që Esmeralda përdor dhe i thotë: “Ti je zysh Esmeralda?”.
- Esmeralda i është përgjigjur: “Po urdhëro, ti kush je?”. Personi i ka thënë: “Kjo s’ka rëndësi se kush jam, po a do më japësh ato provime që unë kam të mbartura për vjeshtë?”. Esmeralda i ka thënë, se nuk mund të komunikonte në këtë mënyrë, por të paraqitej në shkollë, duke i parashtruar kërkesat verbalisht. Femra në krahun tjetër të telefonin i është përgjigjur: “Mir mir se do vij nesër”.
- Kallëzuesja ka theksuar se këto thirrje telefonike e kanë shqetësuar dhe lodhur psikologjikisht. Për

këtë arsye kërkon ndjekje penale, për cilindo person që ka marrë iniciativën për ta shqetësuar në këtë lloj mënyre.

- Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan mbi bazën e materialit kallëzues të referuar nga oficeri i policisë gjyqësore, ka regjistruar procedimin penal nr. 982 në ngarkim të K.B-së për veprën penale të “Përdorimit me keqdashje të thirrjeve telefonike”, parashikuar nga neni 275 i Kodit Penal. Gjatë hetimit të këtij procedimi penal, në prani të mbrojtësit të caktuar kryesisht dhe psikologut, në praninë e prindit pasi në kohën e lidhjes së marrëveshjes e mitura në konflikt me ligjin K.B nuk e kishte mbushur moshën 18 vjeç, është realizuar marrëveshja për aplikimin e masës së shmangies nga ndjekja penale.

Vlerësimi individual

Të dhënat mbi personalitetin e të miturit në konflikt me ligjin:

- E mitura në konflikt me ligjin është nxënëse shkolle me nivel të kënaqshëm në mësim;
- E padënuar më parë;
- Pranon dhe shpjegon veprën penale në prani të mbrojtësit;
- Është me natyrë dhe temperament të qetë dhe nuk shkakton konflikte;
- Është e gatshme t’i kërkojë falje pedagoges;
- Sillet mirë në komunitet dhe familje.

BIBLIOGRAFI

Legjislacion

- Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës.
- Pakti ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike.
- Konventa kundër torturës dhe vuajtjeve të tjera ose trajtimit mizor, jonjerëzor a degradues (ligji nr. 7727, datë 30.6.1993).
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut.
- Karta e të Drejtave Themelore të BE-së, EU (2012), Charter of Fundamental Rights of the European Union, OJ 2012 C 326.
- Direktiva (BE) 2016/800 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 maj 2016 mbi siguritë procedurale për fëmijët që janë të dyshuar ose të akuzuar në procedimet penale.
- Direktiva 2012/29/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 25 tetor 2012 që përcakton standardet minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit.
- Direktiva 2011/93/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 dhjetor 2011 për luftën kundër abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë me fëmijë.
- Direktiva 2011/36/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 5 prill 2011 për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij, ku trajtohen nevojat specifike të fëmijëve viktimë.
- Direktiva 2010/64/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 tetor 2010 mbi të drejtën e përkthimit me shkrim dhe me gojë në procedimet penale.
- Direktive 2012/13/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 22 maj 2012 mbi të drejtën e informimit në procedimet penale.
- Direktiva 2013/48/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 22 tetor 2013, e cila ka hyrë në fuqi më 27 nëntor 2016, mbi të drejtën e aksesit në një avokat në procedimet penale dhe në procedimet e Urdhrit Evropian të Arrestit dhe mbi të drejtën për të informuar palët e treta gjatë privimit të lirisë dhe për të komunikuar me palët e treta dhe me autoritetet konsullore gjatë privimit të lirisë, OJ L 294, 6.11.2013.
- Komenti i përgjithshëm nr. 10 (2007) i Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve.
- Komenti i përgjithshëm nr. 12 (2009) i Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve.
- Komenti i përgjithshëm nr. 9 (2006) i Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve.
- Ligji nr. 37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.
- Ligji nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji nr.7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 10385, datë 24.2.2011, “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.
- Ligji nr. 10279/20.05.2010, “Për kundravajtjet administrative”.

- Ligji nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.
- Kodi i Familjes i vitit 2003.
- Ligji nr. 9669/18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 10221/2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
- Vjetari Statistikor i Ministrisë së Drejtësisë (2005-2015).
- “Rregullorja për bashkëpunimin e Shërbimit të Provës me OJF-të dhe Shërbimin e Ndërmjetësimit”, nr. 302, datë 25.3.2009.
- Rregullat standarde minimale të Kombeve të Bashkuara për administrimin e drejtësisë për të mitur (Rregullat e Pekinit, 1985).
- Rregullat e Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e të rinjve të cilëve u është hequr liria (Rregullat e Havanës, 1990).
- Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për parandalimin e kriminalitetit të të rinjve- (Udhëzimet e Riadit, 1990).
- Rregullat standarde minimale të Kombeve të Bashkuara për masat alternative të dënimit me burgim (Rregullat e Tokios, 1990).
- Udhëzimet e Vjenës për veprimin për fëmijët në sistemin e drejtësisë penale dhe mbi administrimin e drejtësisë për të rinjtë.
- Rec. (99) nr. 19 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për ndërmjetësimin në çështjet penale.
- Guidelines of the Committee of Ministers of the Council of Europe on child-friendly justice adopted by the Committee of Ministers of the Council of Europe on 17 November 2010 and explanatory memorandum.

Vendime gjyqësore të GJED-së dhe GJEDNJ-së

- Vendimi C-105/03 i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë.
- *T kundër Mbretërisë së Bashkuar [GC], nr. 24724/94, 1999, GJEDNJ.*
- *Panovits kundër Qipros, nr. 4268/04, 2008, GJEDNJ.*
- *Nortier kundër Holandës, nr. 13924/88, 24 gusht 1993; GJEDNJ.*
- *Adamkiewicz kundër Polonisë, nr. 54729/00, 2 mars 2010, GJEDNJ.*
- *Salduz kundër Turqisë, [GC], nr. 36391/02, 27 nëntor 2008, GJEDNJ.*
- *Neshkov dhe të tjerët kundër Bullgarisë - 36925/10 et al, vendimi 27.1.2015, GJEDNJ.*
- *Rasti Lambert dhe të tjerët kundër Francës, 25.6.2015, GJEDNJ.*

Vendime gjyqësore nga gjykatat shqiptare

- *Vendimi nr. 2931, datë 6.11.2018 i GjRREGJ-së Tiranë.*
- *Vendimi nr. 2628, datë 10.10.2018 i GjRREGJ-së Tiranë.*

Literaturë

- Filbert, J., Milne, A. "The psychological Dimension of Divorce Mediation".
- Christie, Nils. "Crime Control as Industry", publikuar nga Oslo University, Routledge, Tayler & Francis Group 1993, faqe 163-164.
- Christie, Nils. "Limits to pain", publikuar nga Oslo University, Routledge, Tayler & Francis Group, faqe 5-6.
- UMBERT, Mark. S. "Victim meets offender", The impact of Restorative Justice and Mediation, faqe 2, botuar nga Criminal Justice Press, Willow Tree Press, Inc., Monsey, New York, 1994.
- UNICEF "Children's Equitable Access to Justice: Central and Eastern Europe and Central Asia Albania Georgia Kyrgyzstan Montenegro", 2015.
- The impact of Restorative Justice and Mediation, botuar nga Criminal Justice Press, Willow Tree Press, Inc., Monsey, New York, 1994.

Referenca në internet

- [http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/childjustice/Guidelines on child-friendly justice and their explanatory memorandum _4_.pdf](http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/childjustice/Guidelines%20on%20child-friendly%20justice%20and%20their%20explanatory%20memorandum%20_4_.pdf)
- Lidhja: [http://hudoc.echr.coe.int/eng#w:itemid:\("001-155352"\)](http://hudoc.echr.coe.int/eng#w:itemid:()
- Lidhja: [http://hudoc.echr.coe.int/eng#w:fulltext:w"ECHR decision of 27.1.2015"](http://hudoc.echr.coe.int/eng#w:fulltext:w)
- Lidhja: [http://hudoc.echr.coe.int/eng#w:itemid:\("001-155352"\)](http://hudoc.echr.coe.int/eng#w:itemid:()
- Lidhja: [http://hudoc.echr.coe.int/eng#w:fulltext:w"ECHR decision of 27.1.2015"](http://hudoc.echr.coe.int/eng#w:fulltext:w),
- http://www.drejtesia.gov.al/files/userfiles/Komisioni_i_licensimit/Ligji_nr_10385_dt_24.02.2011.pdf



Programet e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimi në Kodin e Drejtësisë për të Mitur

Prof. dr. Mariana (TUTULANI) SEMINI




Parimet e drejtësisë penale për të mitur si një drejtësi miqësore

- Prezumimi i pafajësisë;
- Drejtësia miqësore;
- Parimi i mbrojtjes nga diskriminimi;
- E drejta për zhvillim harmonik të të miturit;
- Dënimi me burg – alternativa e fundit. Kufizimi ose heqja e lirisë si masë e fundit;
- Parimi i interesit më të lartë të fëmijës;
- Shmangia nga ndjekja penale dhe dënimi penal;
- Parimi i proporcionalitetit;
- Shqyrtimi pa vonesë dhe me përparësi.

Shmangia alternativa e parë, burgimi alternativa e fundit. (Faktori Miller)


- Më 2003, Evan Miller 14 goditi fqinjën e tij për vdekje me një shkop bejsbolli dhe më pas e vendosi në rimorkionin e tij e i vuri zjarrin. Ai hodhi një fletë mbi kokën e tij dhe bërtiti: "Unë jam Zoti! Unë kam ardhur për të marrë jetën tuaj." Viktima vdiq nga goditjet e asfiksimit.
- Deri në 14 vjeç, Miller-i kishte tentuar të vriste veten katër herë, (e para kur ishte 6 vjeç). Ai kishte qenë në kujdestari, se njerku i tij e rrihte dhe nëna e tij abuzonte me drogë dhe alkool.
- Miller-i u dënua në 2006-ën me burgim të përjetshëm, pa pasur mundësinë e liritimit me kusht.
- Në moshën 28-vjeçare, paraqitet para një gjykatësi të qarkut të Alabamës për një seancë dëgjimore për rigjykimin në të cilën pretendohet të merret parasysh "fajësia e zvogëluar e fëmijëve dhe rritja e ndryshimi i kapaciteteve".
- Udhëzimet vijnë nga Gjykata Supreme, që në 2012-ën, vendosi, në rastin *Miller kundër Alabamas* se skemat e dënimit që cenojnë të drejtën për jetën pa mundësi lirimi me kusht për të miturit janë jokushtetuese. Vendimi Miller ka vendosur se fëmijët duhet të kenë një standard tjetër nga të rriturit. Në rastin Miller Gjykata pushoi së vepruari. Një gjykatës "mund të hasë një shkelës të rrallë midis të miturve, që bën një shkelje të përvokueshme dhe rehabilitimi është i pamundur dhe burgimi është i justifikuar". Por, dënimi duhet të jetë "i pazakontë", duhet të bëhet në një seancë për të peshuar atë që është bërë e njohur si faktori Miller: "perspektivat e personit për rehabilitim dhe faktin se moshë mund të ketë ndikuar në këtë krim.

Të mitur të dënuar për kategorinë krime dhe kundravajtje penale 2005-2015




Të mitur të dënuar për vepra penale 2005-2015 (Vjetari Statistikor i MD-së)


Të mitur të dënuar për vepra penale 2005-2015



Vjedhja dhe vjedhja ne bashkëpunim 2005-2015



Ashpërsia në Masa te dënimit për të miturit 2005-2015



Zhvillimi psikik i të miturit

- **A mund të çojë një lojë video në vrasje?**
- Më 31 maj 2014, dy 12-vjeçare joshën shoqen e klasës, 12-vjeçaren Payton Leutner, për të shkuar në pyll. Anissa Weier e vuri poshtë Leutner-in dhe i kërkoi Morgan Geysler-it që ta godiste me thikën e saj. Geysler-i e goditi 9 herë.
- Ato e braktisën shoqen që ishte gati për të vdekur. Megjithatë, ajo u tërhoq përmes pyllit të izoluar dhe u ndihmua nga një çiklist që po kalonte aty pranë.
- Pasi e goditën me thikë shoqen e tyre, vajzat kërkuan në pyll për Slender Man-in, një personazh imagjinar që besonin se ishte i vërtetë. Kur u arrestuan, të dyja vajzat pretendonin se e kryen sulmin e tyre për t'u bërë ndihmëset e Slender Man-it dhe për t'i pëlqyer atij.
- Slender Man-i është një videolojë e bazuar në një legjendë urbane.

Shmangia dhe rregullat e zbatimit të saj

- “Shmangie” është masa alternative për mosfillimin, pezullimin ose pushimin e ndjekjes penale ndaj të miturit në konflikt me ligjin, sipas parashikimeve të këtij Kodi.
- **Pyetje për diskutim:**
- *A ka rregulla që duhet të ndiqen para dhe gjatë zbatimit të masës së shmangies nga ndjekja penale apo do të vlerësohet rast pas rasti?*
- *Nëse po, këto rregulla kanë karakter të përgjithshëm që duhen ndjekur njëjloj për çdo rast?*
- *Nëse po, a ka rregulla që ndiqen në mënyrë të specifikuar rast pas rasti?*
- *Në konkluzion, cilat janë rregullat që duhen ndjekur në nivel makro dhe cilat në nivel mikro?*

Kriteret dhe kushtet për zbatimin e masës së shmangies nga ndjekja penale

Organi kompetent në çdo rast vlerëson paraprakisht në nivel makro:

- mundësinë e marrjes së masës së shmangies,
- interesin më të lartë të të miturit,
- rëndësinë e veprës penale të kryer dhe rrezikshmërinë e saj;
- dënimin e parashikuar për atë vepër,
- moshën e të miturit,
- shkallën e fajësisë,
- dëmin e shkaktuar,
- efektin frikësues të ndjekjes penale,
- sjelljen e të miturit pas kryerjes së veprës penale, në raport me shkallën e rrezikshmërisë së të miturit, si dhe
- raportin e vlerësimit individual.

Rregullat në nivel makro të pasqyruara grafikisht



Kur zbatohet masa e shmangies në nivel mikro

- Në mënyrë të veçantë masa e shmangies nga organi kompetent zbatohet nëse:
 - a) ka prova të mjaftueshme për një dyshim të arsyeshëm se i mituri ka kryer një veprë penale, për të cilën parashikohet dënim me burgim deri në 5 vjet në maksimum ose me gjobë;
 - b) i mituri pranon dhe shpjegon veprën penale në prani të mbrojtësit;
 - c) i mituri nuk është kallëzuar për kryerjen e një vepre penale ose nuk është përsëritës;
 - d) i mituri dhe, sipas rastit, përfaqësuesi i tij ligjor ose procedural japin pëlqimin me shkrim për zbatimin e shmangies;
 - e) i mituri nuk ka marrë pjesë më parë në një program ku të jetë zbatuar masa e shmangies nga ndjekja penale dhe/ose e ndërmjetësimit;
 - f) dënimi i të miturit për ato vepra nuk i shërben korrigjimit të sjelljes së tij;
 - g) nuk ka një interes publik për fillimin e ndjekjes penale ose vazhdimin e ndjekjes penale të filluar.

Rregullat që vlerësohen rast pas rasti (niveli mikro), paraqitur grafikisht



Vendimi nr. 2628, datë 10.10.2018 i GJRRGJ-së Tiranë

- I pandehuri i mitur nën 16 vjeç me një makinë tip YINGANG pa targa po kryente manovra të rrezikshme para shkollës së mesme “P.B” Burrel.
- **Vepra penale:** “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” në gjendje të dehur dhe nën efektin e lëndëve narkotike;
- **Ana subjektive:** VP është kryer me faj, ai e ka ditur që duhej leje qarkullimi dhe nuk e kishte një të tillë për shkak të moshës;
- Rrezikshmëria e veprës është e madhe ngaqë konsiderohet krim dhe jo kundërvajtje penale;
- I mituri shfaq pendim të thellë;
- Nga vlerësimi individual rezulton se:
 - a) Sjellja mund të përmirësohet;
 - b) I mituri nuk shfaq rrezik për përsëritje;
 - c) Shmangia është më e përshtatshme.

Vendimi nr. 2628, datë 10.10.2018 i GJRRGJ-së Tiranë (vijon)

Gjykata vendos:

- Deklarimin fajtor;
- Uljen e dënimit me 1/3 e dënimit;
- Dënimin me gjobë me 50,000 lekë.

Çështje për diskutim

1. A duhet të vendoste prokurori vlerësimin e masës së shmangies?
2. Kur gjyqtari mbështetet te KDP-ja për shmangien, a mund të japë dënim dhe ta shpallë të pandehurin fajtor?
3. Nëse jepet shmangia nga ndjekja penale, a shmangen edhe rekordet kriminale për të miturin?

Vendimi nr. 2931, datë 6.11.2018 i GJRRGJ-së Tiranë

- I pandehuri është i mitur në shkollën e mesme, klasa e dhjetë (mosha nën 16 vjeç), ka kryer vjedhje më shumë se një herë dhe është kapur në flagrancë duke vjedhur dy kanoçe "Neskafë" në një supermarket te lagjja "Don Bosko".
- Vepra penale: "Vjedhja më shumë se një herë", neni 134/2 i KP-së".
- Ana subjektive: Vepra penale është kryer me faj. Ai e ka ditur që ky veprim është i paligjshëm dhe ka kryer disa herë vjedhje në supermarkete të ndryshme për sende me natyrë ushqimore, gjatë muajit mars çdo dy-tre ditë.
- Provat: I mituri është filmuar nga kamerat e subjekteve tregtare dhe ka qenë me të njëjtën veshje gjithmonë, (xhup jeshil dhe kapele e zezë);
- Procesverbali I kapjes në flagrancë, (është kapur me vrap nga punonjësi I supermarket pasi ka lënë dyqanin);
- Rrezikshmëria e veprës është e madhe ngaqë konsiderohet krim dhe jo kundravajtje penale;
- Rrethanë lehtësuese se i mituri shfaq pendim të thellë;
- Nga vlerësimi individual rezulton se:
 - a) Sjellja mund të përmirësohet përmes vazhdimit të shkollës;
 - b) Shmangia është më e përshtatshme.

Vendimi nr. 2931, datë 6.11.2018 i GjRRGJ-së Tiranë (vijon)

Gjykata vlerëson:

- Sipas nenit 104 të KDPM-së vepra ka rrezikshmëri të ulët;
- Interesi më i lartë i fëmijës vlerësohet që të ketë shmangie;
- Çmohet që ka shpresa për të rehabilituar të miturin nga pikëpamja sociale;

Gjykata vendos:

- Deklarimin fajtor;
- Uljen e dënimit të dhënë në 1/3 duke e dënuar përfundimisht me 2 muaj;
- Pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim për një afat prove 4 muaj;
- Të mos shoqërohet me persona të dënuar në zbatim të nenit 102/1 të KDPM-së.

Çështje për diskutim

- A ka një ndarje të dukshme midis dënimeve alternative dhe masave të shmangies nga dënimi penal për të miturit?
- Kur gjyqtari mbështetet te KDP-ja për shmangien, a mund të japë dënim dhe ta shpallë të pandehurin fajtor?
- A mund të argumentohet sipas dispozitave të KDPM-së për shmangien dhe pastaj i mituri të deklarohet fajtor?

Provat e mjaftueshme dhe dyshimi i arsyeshëm

- Cilat do të konsiderohen prova të mjaftueshme për të ngritur një akuzë?
- Cili do të klasifikohet si dyshim i arsyeshëm?

Provat dhe dyshimi i arsyeshëm Rast nga praktika ndërkombëtare

- 3 të mitur dhe një 18-vjeçar u arrestuan më 28 shtator në Johnston High School, tre javë pas një incidenti në shtëpinë e një prej të pandehurve, Morgan Hough, në Iowa, SHBA. Një urdhër kërkimi zbuloi një video të regjistruar që tregonte se i dëmtuari 15-vjeçar ishte mbytur dhe goditur me shkelma ndërkohë që ishte pa ndjenja.
- Drejtuesit e shkollës njoftuan policinë pasi morën raporte anonime për rrahjen. Autoritetet pastaj intervistuan viktimën dhe prindërit e tij, të cilët thoshin se e gjetën djalin e tyre pa ndjenja në oborrin e shtëpisë, të veshur me rrobat e dikujt tjetër.
- Viktima i tha policisë se ai piu alkool dhe se ai nuk mbante mend se çfarë ndodhi midis orës 6:30 dhe 7 pasdite. Nxënës të tjerë i kishin thënë se ai ishte rrahur vazhdimisht dhe abuzuar seksualisht. Këtë gjë e treguan edhe provat e depozituara në gjykatë.
- Policia gjithashtu gjeti edhe përdorim të paautorizuar të kartës së kreditit të viktimës për video-lojëra online, si dhe për porosi në McDonald's.
- Mbi adoleshentët rëndonin akuzat e abuzimit seksual të shkallës së dytë, vjedhje e shkallës së parë, rrahje dhe shfrytëzim i të miturit.

Rregullat/parimet e zbatimit të shmangies

- Përparësia e masave alternative të shmangies në raport me ndjekjen penale
- Masat alternative që synojnë shmangien e të miturit nga procedimi penal, ose zbatimi i masave të drejtësisë restauruese vlerësohen si mundësia e parë.
- Masa alternative e shmangies i shërben më mirë qëllimeve të **rishoqërimit**, **rehabilitimit** të të miturit dhe **parandalimit** të shkeljeve të ligjit, përkundrajt vendosjes së tij nën përgjegjësinë penale dhe zbatimit të dënimit penal.
- Masa alternative duhet të jetë:
 - përshtatshme,
 - e mundshme dhe
 - e nevojshme.

Si vlerësohet përshtatshmëria e dhënies së masës së shmangies?

- Gjyqtari dha dënimin alternativ për A.M-në me punë në shërbim të komunitetit, duke specifikuar se i mituri duhet të shkonte për dy muaj të kujdesej 4 orë në ditë për pastrimin e lulishtes së Spitalit Rajonal;
- Pas dy javëve nga fillimi i ekzekutimit të masës alternative të shmangies, i mituri refuzon përmbushjen e masës;
- Pasi prokurori merr shpjegim nga i mituri për arsyet, ky i thotë: “Më tallin shokët pse merrem me pastrim e mbaj fshesë në dorë si gratë”;
- Për këtë arsye i mituri shprehet: “Dua dënim me burg, se burgu është për burrat.”.
- Nëse do të jeni në rolin e prokurorit apo të gjyqtarit në një situatë të ngjashme, sa aktiv mund të jeni për të bindur të miturin për dobishmërinë e dhënies së masës së shmangies?

Si vlerësohet përshtatshmëria e dhënies së masës së shmangies?

- Këshilla praktike që e ndihmojnë gjyqtarin/prokurorin të vlerësojë me objektivitet se cila është mënyra e vlerësimit të rrezikshmërisë të të miturit dhe të veprës penale.
- Duke interpretuar nga e kundërta themi se prokurori nuk vendos zbatimin e shmangies nga ndjekja penale në raport me dënimin me burgim kur:
 - a) I pandehuri nuk është i gatshëm apo në gjendje të kryejë një dënim të ndryshëm nga burgimi, ose
 - b) Dënimi me burgim është i nevojshëm për mbrojtjen e publikut, ose
 - c) Vepra penale është aq e rëndë, sa që një dënim jo me burgim nuk mund të justifikohet.

Rast praktik

- I mituri SH.R 12-vjeç ka vrarë mësuesen e tij. Gjykata e Rrethit gjyqësor Berat, konstaton se i mituri paraqet rrezikshmëri të lartë shoqërore për t'u lënë në gjendje të lirë.
- Gjatë pyetjes së tij dhe të familjarëve gjyqtari çmon se i mituri nuk shfaq shenja pendese, vrasja është përjetuar prej tij me kënaqësi fizike, madje ka kryer edhe marrëdhënie seksuale me kufomën, shprehet se është i gatshëm të kryejë vepra të tilla në të ardhmen dhe nuk e sheh si një gjë negative këtë sjellje.
- Familjarët shprehen se e kanë të pamundur që të kujdesen për mirërritjen e të miturit. Që i vogël fare ka vrarë kafshët e fqinjëve në lagje pasi i ka torturuar ato, shfaq shenja dhune dhe agresiviteti.
- Ndërkohë i mituri qëndron i izoluar në mjediset e policisë për ditë të tëra.

Çështje për diskutim

- Çfarë veprimesh do të kryejë gjykata/prokuroria?
- Ndërkohë që përgjegjësia penale nuk e përfshin moshën 12-vjeç, a është një masë e përshtatshme mbajtja e të miturit në izolim në mjediset e policisë?
- A mund të shprehet gjykata/prokuroria për marrjen e masave për edukimin, rehabilitimin, mjekimin (masa shëndetësore) etj., për rastet kur i mituri është nën 14 vjeç?
- Nëse gjykata dhe prokuroria e lënë menjëherë të lirë të miturin për shkak se nuk ka përgjegjësi penale, a ka ndonjë përgjegjësi organet e drejtësisë nëse i mituri kryen një veprë penale tjetër në një kohë të shkurtër nga e para? Po në këtë rast, a ka ndonjë shkak të arsyeshëm për të marrë masa detyruese ndaj të miturit?

Burgimi si alternativa e fundit dhe teoritë bashkëkohore që lidhen me të

- Një sërë konkluzionesh të nxjerra nga studimet bashkëkohore ndërkombëtare formuan besimin që të përforcohet dhe të evidentohet nevoja e zbatimit të programeve rehabilituese dhe integruese me ndihmën e punonjësve socialë për të miturit që kryenin vepra penale.
- **Teoria e realitetit të parëndësishëm** – që udhëhiqet nga pohimi se shumica e veprave penale të kryera nga të miturit janë të parëndësishme dhe si të tilla duhet që të shmangim dënimin me burgim;
 - **Teoria e zhvillimit të arsytimit të krimit** – që udhëhiqet nga pohimi se shumica e të miturve kryejnë vepra penale gjatë adoleshencës dhe se pjesa më e madhe nuk do të kryejnë më vepra penale, për shkak se në mënyrë natyrore do të rriten/ do të arrijnë pjekurinë, prandaj mbështetet shmangia nga ndjekja penale;
 - **Teoria e etiketimit** – që udhëhiqet nga pohimi se përfshirja zyrtare në sistemin e drejtësisë penale sjell pasoja negative ku të miturit etiketohen si kriminelë;
 - **Teoria që nis nga efekti i kostos në rritje** – nëse sillen para drejtësisë penale që në moshë fare të re, do të shpejtohet dënimi me burgim në të ardhmen;
 - **Teoria e shkollave të krimit** – që udhëhiqet nga arsyetimi se burgimi është një shkollë edukimi negative që i ekspozon të rinjtë ndaj shkelësve më të mëdhenj në moshë;
 - **Teoria e zgjerimit të rrjetit** – që rrethi i të miturve që përfshihen në drejtësinë penale për të mitur vjen duke u zgjeruar, sepse grupmoshat e reja mësojnë më shpejt nga shembulli negativ. Kjo teori pranon se programet që mbështeten në ndihmën sociale mund të sjellin më shumë të rinj para sistemit të drejtësisë penale dhe për rrjedhojë burgimi duhet të jetë alternativa e fundit;
 - **Teza radikale e mosdërhurjes** – e cila propagandon që drejtësia të merret sa më pak me të miturit, sepse më e mira është që të shmangim dëmin e mundshëm që mund të shkaktohet nga sistemi i drejtësisë penale.

Praktikë e GJEDNJ-së: Ceka kundër Shqipërisë

- Dy të mitur kanë vjedhur në një kishë. Për këtë akt arrestohen nga policia.
- Njëri prej tyre vdiq në polici për shkak të keqtrajtimit.
- Institucionet shqiptare dështojnë në krijimin e kushteve dhe marrjen e masave për një proces të rregullt dhe për respektimin e të drejtave të të miturve për t'u pyetur dhe për të përfituar dëshmitë në favor të tyre.

Çështje për diskutim:

- Arresti me burg a është një masë e përshtatshme për një të mitur që akuzohet për një vjedhje (celulari sende ushqimore etj.) në vlera jo të mëdha dhe që e kryen për herë të parë këtë veprim?
- A është e justifikuar kjo masë kur i mituri është një nxënës që ndjek shkollën?
- A e lehtëson përgjegjësinë e institucioneve apo e rëndon atë lidhur me dhënien e masave të arrestit në shtëpi apo detyrim për paraqitje etj.?

Rregulla që mund të ndiqen rast pas rasti

Organi kompetent, para marrjes së vendimit për zbatimin e masës së shmangies, **mund të kërkojë informacion** nga:

- prindërit;
- kujdestarët ligjorë;
- institucionet që kanë dijeni për veprimtarinë e të miturit;
- Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës;
- eksperti, sipas nevojave të të miturit dhe të procesit.

Procedura për zbatimin e masës së shmangies me iniciativë nga prokurori

Prokurori mund të vendosë zbatimin e masës së shmangies deri në momentin para se të ketë filluar shqyrtimi gjyqësor i çështjes:

- me iniciativën e tij ose
- me kërkesë të të miturit në konflikt me ligjin ose përfaqësuesit të tij.

Rast për diskutim:

Prokurori çmon nëse konkurrojnë disa kushte, si mosha e re e të miturit, rrezikshmëria e ulët e veprës penale, kryerja e veprës penale për herë të parë, mundësitë e rehabilitimit të të miturit, që të zbatohet shmangia nga ndjekja penale. Prokurori me iniciativën e tij vlerëson nëse është në interes të të miturit që ai të ndjekë një proces ndërmjetësimi për zgjidhjen e konfliktit me qëllim shmangien nga ndjekja penale.

- Çfarë ndodh nëse i mituri e kundërshton në mënyrë kategorike masën e propozuar dhe thotë se refuzon të ulet në një tavolinë me viktimën që ka plagosur, sepse veprimi ndodhi për shkak se viktima e diskriminonte në shkollë dhe e fyente para shokëve?

Procedura për zbatimin e masës së shmangies me iniciativë nga prokurori

- Në rastet kur masa e shmangies merret me iniciativën e prokurorit, ai i propozon të miturit në konflikt me ligjin, masën e shmangies nga ndjekja penale dhe në rast se i mituri jep pëlqimin, prokurori vendos përfundimisht zbatimin e saj.
- Në rast se propozimi i prokurorit për shmangien nuk pranohet nga i mituri, mbahet një procesverbal, në të cilin pasqyrohen arsyet e mospranimit të saj nga i mituri.
- Procesverbali nënshkruhet nga prokurori dhe i mituri ose, sipas rastit, përfaqësuesi i tij ligjor ose procedural.

Procedura për zbatimin e masës së shmangies me kërkesën e të miturit

- I mituri në konflikt me ligjin ose përfaqësuesi i tij, me kërkesë të arsyetuar, i kërkon prokurorit zbatimin e masës së shmangies.
- Prokurori vendos për zbatimin ose jo të masës së shmangies me vendim të arsyetuar.
- Në rast se prokurori refuzon kërkesën, i mituri ose përfaqësuesi i tij ka të drejtë që të kërkojë në gjykatë brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit për vendimin e refuzimit, zbatimin e masës së shmangies nga ndjekja penale.

Procedura dhe zbatimi i masës së shmangies nga gjykata

Zbatimi i masës së shmangies mund të vendoset, sipas rastit, edhe nga gjykata:

- kryesisht ose
- me kërkesë të arsyetuar të palëve, punonjësit social ose psikologut.

Gjykata mund të vendosë:

- kthimin e çështjes prokurorit për të proceduar me zbatimin e masës së shmangies. Para marrjes së këtij vendimi, gjykata dëgjon të miturin dhe merr pëlqimin e tij, ose,
- zbatimin e masës së shmangies në fazën e gjykimit deri para marrjes së vendimit përfundimtar.

Pasoja t e zbatimit të masës së shmangies

- Zbatimi i masës së shmangies nga prokurori është rrethanë për mosfillimin e procedimit penal, nëse procedimi penal nuk ka filluar, dhe pushimin e tij nëse procedimi penal ka filluar;
- Ky vendim i njoftohet drejtuesit të prokurorisë dhe viktimës, me qëllim që ky i fundit, sipas rastit, të ketë mundësi të kërkojë dëmshpërblim;
- Ky vendim i njoftohet edhe mbrojtësit të të miturit, përfaqësuesit ligjor dhe/ose procedural të tij;
- Në rastin e vendosjes së masës së shmangies, prokurori merr vendimin për mosfillimin e çështjes penale ose pushimin e saj dhe lidh një marrëveshje me të miturin për llojin e masës së shmangies dhe/ ose ndërmjetësimin;

Pasoja t e zbatimit të masës së shmangies

- Marrja e masës së shmangies nga ndjekja penale bëhet vetëm me pëlqimin me shkrim të të miturit dhe, kur është e përshtatshme, edhe nga përfaqësuesi i tij ligjor;
- Organi kompetent mund të caktojë një përfaqësues procedural, i cili mund të japë pëlqimin për masën e shmangies;
- Para marrjes së pëlqimit, të miturit i sigurohet mundësia e këshillimit dhe ndihmës ligjore;
- Gjatë negociimit të marrëveshjes për marrjen e masës së shmangies, i mituri ndihmohet nga mbrojtësi;
- Marrëveshja, nënshkruhet nga i mituri dhe nga mbrojtësi i tij.

Rast praktik

- I.S në moshën 17-vjeçare bleu një makinë të re. Ndërsa po kalonte një kryqëzim humbi kontrollin dhe u përplas me një makinë tjetër, shoferi i së cilës ishte po një i ri 21-vjeçar i quajtur A.Z.
- I.S doli nga makina i nxehur dhe filloi të godiste personin tjetër.
- A.Z për t'u mbrojtur kapi një shufër hekuri dhe e goditi I.S-në në krah duke e plagosur.
- Pas kësaj ngjarjeje disa kalimtarë e çuan I.S-në në spital. Pas mjekimit I.S-ja u kthye në vendin e aksidentit për të vazhduar grindjen, por A.Z-ja ishte larguar pasi i kishte sqaruar ngjarjen punonjësve të policisë, të cilët më pas e kishin lënë të lirë.
- Kjo gjë e acaroi edhe më tepër të miturin që filloi të kërkonte A.A-në. Kur u takuan përsëri, situata u tensionua edhe më shumë. Ata filluan të grindeshin dhe u desh ndërhyrja e policisë që i shoqëroi në komisariat. Çështja iu përcoll prokurorisë që të vijonin hetimet dhe të konstatohet nëse ishte plagosje e rëndë apo e lehtë.
- Prokurori i kërkoi të miturit të merrte në konsideratë edhe mundësinë e gjetjes së një zgjidhjeje paqësore. I mituri i plagosur pranoi të kontaktonte qendrën e ndërmjetësimit.

Garancitë e të miturit për zbatimin e masës së shmangies

- Para zbatimit të vendimit për masën e shmangies nga ndjekja penale, i mituri, mbrojtësi i tij kanë të drejtë të kenë informacion të detajuar mbi thelbin e masës së shmangies nga ndjekja penale, kohëzgjatjen e saj, kushtet dhe mënyrën e zbatimit, si dhe pasojat për mospërmbushjen e masave të shmangies.
- Të miturit i shpjegohet gojarisht dhe me shkrim, ose në format e duhura të komunikimit, sipas aftësive të veçanta të të miturit, se pranimi i masës së shmangies nga ndjekja penale është vullnetar dhe se i mituri ka të drejtë të heqë dorë prej masës në çdo fazë.
- Nëse i mituri nuk ka mbrojtës, ai dhe përfaqësuesi ligjor i tij informohen lidhur me të drejtën për të pasur një mbrojtës.
- Pranimi i veprës penale nga i mituri dhe informacioni i mbledhur rreth tij gjatë procesit të shmangies nuk mund të përdoren në gjykatë kundër tij.

Kushtëzimi i vendimit të zbatimit të masës së shmangies

- Prokurori mund të vendosë pezullimin e hetimit, me qëllim zbatimin me kusht të masës së shmangies nëse i mituri në konflikt me ligjin kërkon dhe garanton përmbushjen e detyrimeve të tilla si:
 - a) riparimi ose kompensimi i dëmit të shkaktuar nga vepra penale, sipas aftësive të tij dhe sipas rastit;
 - b) përfshirja në programe të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit;
 - c) përfshirja në punët e një organizate humanitare ose në veprimtaritë e komunitetit ose të mbrojtjes së mjedisit;
 - ç) trajtimi prej varësisë nga droga ose varësive të tjera.
- Në rast se i mituri përmbush detyrimet e marra përsipër prokurori vendos përfundimisht për pushimin e procedimit penal ndaj tij.

Masat alternative të mundshme për shmangien nga ndjekja penale

- Masat alternative të mundshme për shmangien nga ndjekja penale
- Masat alternative të shmangies jepen, sipas rastit, nga prokuroria ose gjykata.
- Masat alternative për shmangien nga ndjekja penale mund të përfshijnë:
 - a) programet e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit;
 - b) këshillimin për të miturin dhe familjen;
 - c) paralajmërimin me gojë;
 - ç) paralajmërimin me shkrim;
 - d) masat detyruese;
 - dh) vendosjen nën kujdes.
- Ndaj të miturit mund të zbatohen në të njëjtën kohë disa masa.
- Masat e shmangies duhet të jenë të arsyeshme dhe në përputhje me nevojat e të miturit në konflikt me ligjin dhe të viktimës.
- Asnjë detyrim nuk mund t'i imponohet të miturit në procesin e vendosjes së masës së shmangies, e cila mund t'i shkaktojë poshtërim, degradim, përjashtim nga procesi normal edukativ dhe/ose punësimi kryesor, si dhe dëmtim të shëndetit fizik ose/dhe mendor.
- Ndalohet vendosja e një mase shmangieje më të ashpër sesa sanksioni minimal ligjor i parashikuar për veprën penale të kryer.

Masat alternative për shmangien nga ndjekja penale

- Programet e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit;
- “Masë e drejtësisë restauruese” është çdo masë, e cila lejon një të mitur në konflikt me ligjin të kuptojë përgjegjësinë dhe të korrigjojë pasojat e një vepre penale, të kompensojë dëmet dhe/ose të pajtohet me viktimën/palën e dëmtuar dhe persona të tjerë të prekur nga vepra penale, ku i mituri që ka kryer veprën penale dhe pala e dëmtuar marrin pjesë së bashku në mënyrë aktive për të zgjidhur pasojat e një vepre penale, zakonisht me ndihmën e një pale të tretë të pavarur.
- “Ndërmjetësim” është procesi i zgjidhjes jashtëgjyqësisht dhe përmes dialogut mes një të mituri që ka kryer veprën penale dhe viktimës, i cili realizohet nga ndërmjetësi dhe synon të zgjidhë mosmarrëveshjen mes tyre dhe pasojat që vijnë nga vepra penale, si dhe të përmirësojë marrëdhëniet midis tyre, pavarësisht nëse zbatohet ose jo si masë shmangieje.

Masat e drejtësisë restauruese

- Organi kompetent **informon të miturin** në konflikt me ligjin dhe viktimën, përfaqësuesin ligjor ose procedural dhe, sipas rastit, mbrojtësin e të miturit, **për programet e drejtësisë restauruese.**
- Organi kompetent informon të miturin në konflikt me ligjin, përfaqësuesin ligjor ose procedural dhe, sipas rastit, mbrojtësin e të miturit, për mundësinë për të kërkuar kthimin dhe kompensimin e dëmit në gjykatë në qoftë se zbatimi i programit të drejtësisë restauruese nuk realizohet.

Programet e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimi

- Organi procedues vendos për zbatimin e programit të drejtësisë restauruese, në përputhje me legjislacionin për ndërmjetësimin, me qëllim krijimin e mundësive për të miturin që të korrigojë pasojat e veprës penale të kryer prej tij, ndaj viktimës, komunitetit dhe/ose shoqërisë.
- Për zbatimin e një programi të shmangies nga ndjekja penale dhe të drejtësisë restauruese, është i nevojshëm pëlqimi nga i mituri dhe/ose prindi i tij.
- Kur i mituri nuk ka prindër, ose ekziston një konflikt interesi ndërmjet prindërve dhe të miturit, pëlqimin, sipas pikës 2, germa “a”, e këtij neni, mund ta japë një prej përfaqësuesve proceduralë, sipas parashikimeve të nenit 3, pika 17, të këtij Kodi.

Zbatimi i drejtësisë restauruese

- Programi i drejtësisë restauruese, mund të zbatohet nëse:
 - a) i mituri, mbrojtësi dhe, sipas rastit, përfaqësuesi ligjor, japin lirisht pëlqimin për marrjen e një vendimi të tillë;
 - b) çdo marrëveshje për korrigjimin e pasojave të veprës penale të kryer nga i mituri është e arsyeshme;
 - c) çdo marrëveshje për korrigjimin e pasojave të veprës penale të kryer nga i mituri është e përshtatshme.



Kufijtë e marrëveshjes për shmangien nga ndjekja penale

- Programi i drejtësisë restauruese mund të parashikojë që të miturit t'i kërkohet:
 - a) të pranojë dhe të tregojë se e kupton përgjegjësinë për veprën penale dhe të pasojës së ardhur ndaj viktimës;
 - b) të kompensojë dëmin e shkaktuar viktimës, komunitetit dhe/ose shoqërisë;
 - c) t'i kërkojë falje viktimës; dhe
 - ç) të ndër marrë veprime të pranueshme edhe nga viktima ose/dhe komuniteti,
 - d) të marrë pjesë në një procedurë ndërmjetësimi;
 - dh) të kryejë punë me interes publik;
 - e) të marrë pjesë në programe rehabilituese lidhur me pasojat e veprës penale.

Ndërmjetësimi familjar dhe në grup

- Ndërmjetësimi familjar;
- Ndërmjetësimi në grup.
- Zbatimi i masave alternative për shmangien e ndjekjes penale, mund të shoqërohen rast pas rasti me sesione ndërmjetësimi ku marrin pjesë bashkërisht me viktimën dhe të miturin në konflikt me ligjin, edhe të afërmit e tyre, persona nga rrethi i tyre shoqëror, përfaqësues nga agjenci publike për mbrojtjen e të miturve, mbikëqyrjen e tyre dhe parandalimin e kriminalitetit për të miturit.
- Në këtë proces i akuzuari dhe familja e tij pritet të arrijnë një **marrëveshje** me viktimën, e cila përfshin kompensimin e dëmit, kryerjen e detyrimeve që janë të pranueshme prej viktimës dhe që pritet të mbajnë të akuzuarin larg situatave konfliktuale të ngjashme në të ardhmen.

Procedura e ndërmjetësimit

- Ndërmjetësimi si procedurë jashtëgjyqësore zhvillohet nga ndërmjetësi sipas dispozitave të KDPM-së dhe të ligjit për ndërmjetësimin.
- Ndërmjetësimi mund të zhvillohet vetëm nëse ekziston pëlqimi i lirë për ndërmjetësim, i shprehur si nga i mituri i akuzuar për veprën penale dhe nga pala e dëmtuar. Dhënia e pëlqimit duhet të shënohet në procesverbalin e organit procedues.
- Ndërmjetësimi mund të zhvillohet vetëm me pjesëmarrjen personale të të miturit autor i veprës penale dhe palës së dëmtuar.
- Në procesin e ndërmjetësimit, me pëlqimin e palëve, mund të marrin pjesë gjithashtu, përfaqësuesi ligjor i të miturit, psikologu, punonjësi i Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, prokurori dhe/ose personat e tjerë të caktuar prej tij.
- Prokurori mund të marrë pjesë në procesin e ndërmjetësimit nëse ai e çmon këtë.

Procedura e ndërmjetësimit

- Ndërmjetësimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, sipas rastit, mund të zbatohet edhe si **masë shmangieje**, por edhe si një **mundësi** që çon në përmirësimin e marrëdhënieve midis të miturit autor dhe viktimës së veprës penale.
- **Prokurori gjatë hetimit dhe gjyqtari gjatë gjykimit**, sipas rastit, mund të propozojnë **ndërmjetësimin** nëse vlerësojnë se kjo alternativë është më e përshtatshme, duke pasur parasysh natyrën e veprës penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, historinë e të miturit, mundësinë e kthimit të raporteve normale mes të miturit dhe palës së dëmtuar, mundësinë e zvogëlimit të dëmit të palës së dëmtuar, mundësinë e rehabilitimit të të miturit dhe riintegrimin e tij në shoqëri.
- Në rast se propozimi i prokurorit/gjyqtarit për ndërmjetësim pranohet nga palët, atëherë prokurori/gjyqtari vendos pezullimin e procesit penal për një afat jo **më shumë se 45 ditë**.
- Nëse marrëveshja e ndërmjetësimit arrihet, prokurori/gjyqtari vendos pushimin e çështjes. Nëse marrëveshja e ndërmjetësimit nuk arrihet me kalimin e 45 ditëve, pezullimi bie dhe vazhdon hetimi/gjykimi i çështjes.

Kushtëzimi i vendimit të zbatimit të masës së shmangies

- Prokurori mund të vendosë pezullimin e hetimit, me qëllim zbatimin me kusht të masës së shmangies nëse i mituri në konflikt me ligjin kërkon dhe garanton përmbushjen e detyrimeve të tilla si:
 - a) riparimi ose kompensimi i dëmit të shkaktuar nga vepra penale, sipas aftësive të tij dhe sipas rastit;
 - b) përfshirja në programe të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit;
 - c) përfshirja në punët e një organizate humanitare ose në veprimtaritë e komunitetit ose të mbrojtjes së mjedisit;
 - ç) trajtimi prej varësisë nga droga ose varësive të tjera.
- Në rast se i mituri përmbush detyrimet, prokurori vendos përfundimisht për pushimin e procedimit penal ndaj tij.

Përmbushja e masave alternative për shmangien nga ndjekja penale

- Nëse për të miturin që ka kryer një vepër penale, është dhënë një masë alternative për shmangien nga ndjekja penale dhe kjo masë është përmbushur, ndaj tij nuk mund të ngrihet asnjë akuzë në lidhje me po këtë vepër penale.
- Nëse i mituri i përmbush detyrimet, sipas marrëveshjes së shmangies, prokurori vendos menjëherë pushimin e çështjes.
- I mituri që ka përmbushur një masë alternative për shmangien nga ndjekja penale nuk do të konsiderohet si i dënuar për një vepër penale dhe nuk do të trajtohet si person me të kaluar kriminale.
- Përmbushja e masës së shmangies nga ndjekja penale realizohet dhe mbikëqyret nga Shërbimi i Provës, në bashkëpunim me shërbimin e ndërmjetësimit.

Mospërbushja e masave alternative për shmangien nga ndjekja penale

- Nëse i mituri, me qëllim, nuk e përbush masën për shmangien e ndjekjes penale, Shërbimi i Provës informon për këtë me shkrim prokurorin, duke shpjeguar në mënyrë të detajuar kohën, vendin, mënyrën dhe rrethanat e mospërbushjes dhe situatën personale të të miturit.
- I mituri, prindërit ose, sipas rastit, përfaqësuesi ligjor, informohen nga Shërbimi i Provës lidhur me pasojat e moszbatimit të kushteve dhe detyrimeve të masës së shmangies dhe rregullat e shqyrtimit në rast mospërbushjeje.
- Mospërbushja e kushteve dhe detyrimeve që burojnë prej masës së shmangies nga ndjekja penale nuk përbën vepër penale dhe nuk sjell automatikisht kufizimin ose heqjen e lirisë së të miturit. Edhe në këtë rast, heqja e lirisë, konsiderohet nga organet kompetente si masa e fundit.

Procedura në rast mospërbushjeje të masave alternative për shmangien nga ndjekja penale

- Në rast mospërbushjeje, prokurori mund të japë një vendim për ndryshimin ose revokimin e pjesshëm ose të plotë të masës së shmangies pasi ka bërë një shqyrtim të detajuar të fakteve të raportuara.
- Prokurori, në çdo rast, cakton një seancë të veçantë dëgjimore, merr mendimin e të miturit, i cili paraqet arsyet lidhur me mospërbushjen e masës.
- Nëse do të jetë e nevojshme, prokurori, mund të kërkojë një vlerësim të ri psikologjik, psikiatrik ose të kërkojë mendim për raportet e mëparshme të ekspertëve.
- Prokurori pasi e rishqyrton këtë masë, si edhe masa të tjera, kontakton të miturin, përfaqësuesin e tij ligjor dhe dëgjon mendimin e punonjësit të Shërbimit të Provës, dhe mund të vendosë:
 - a) revokimin ose lënien në fuqi të vendimit për shmangien nga ndjekja penale;
 - b) ndryshimin e llojit të masës së shmangies;
 - c) zgjatjen e kohës së marrëveshjes.

Procedura në rast mospërbushjeje të masave alternative për shmangien nga ndjekja penale

- Nëse organi procedues vendos që të rifillojë procedimi kundër të miturit, ai merr parasysh pjesën e masës që është përmbushur tashmë nga i mituri gjatë zbatimit të masës alternative të shmangies.
- Në rast të revokimit të vendimit për shmangien, prokurori, me vendim të arsyetuar, vendos të shfuqizojë vendimin për mosfillimin e hetimit ose të vendimit të pushimit të çështjes së filluar dhe të vendosë rifillimin e hetimit.
- Në rastin e revokimit të vendimit për shmangien, veprimet e kryera nga i mituri për të përmbushur masën e shmangies nga ndjekja penale do të shqyrtohen gjatë gjykimit. Pranimi i përgjegjësisë për një vepër penale, me qëllim që të zbatohet një masë alternative për shmangien nga ndjekja penale, nuk mund të përdoret gjatë gjykimit kundër të miturit.
- Nëse i mituri, nuk përmbush detyrimet e veçanta që i janë urdhëruar ose në qoftë se refuzon ose, në mënyra të tjera, ndërhyr në zbatimin e masës së mbikëqyrjes së vazhdueshme, gjykata, nëse është e mundur, mund të vendosë që, për këtë arsye, i mituri të vendoset në një qendër/institucion disiplinor/edukues për qëndrim të pandërprerë për jo më shumë se një muaj.

Trajnim dhe ndërgjegjësim online

https://www.youtube.com/watch?v=GJEdBRNJ91c&feature=emb_logo&fbclid=IwAR3yvlA1oPj3Ve_XQ5yfZhZ8S59askBrQlkIMdndEQ2WStmoVEQGMovN9jE

